
EC
MA NDRYSHE



BRENDA MUREVE, PËRTEJ BREZAVE

Kullat tradicionale në rajonin e Gjakovës dhe Prizrenit

nëntor 2026

"Brenda Mureve, përtej brezave" - Kullat tradicionale në rajonin e Gjakovës dhe Prizrenit"

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci 67, Prizren &
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 049 714 024

Hulumtimi "Brenda Mureve, përtej brezave" - Kullat tradicionale në rajonin e Gjakovës dhe Prizrenit" është realizuar nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Trashëgimia kulturore për të gjithë: Ruajtja, edukimi, zhvillimi dhe inovacioni" përkrahur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (Ministria e Kulturës dhe Turizmit).

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të donatorit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS
DHE TURIZMIT

Përmbajtja:

Tabela e figurave: 6
HYRJE 9
2. Historiku i Kullave në Kosovë dhe rëndësia e tyre 11
2.1 Zanafilla dhe zhvillimi historik 11
2.1.1 Funksioni i kullave 12
2.2 Materialet dhe teknikat e ndërtimit 13
3. Tipologjia, organizmi dhe elementet mbrojtëse të kullave 14
3.1 Forma dhe vendosja 14
3.2 Organizimi vertikal dhe horizontal 15
3.3 Oda, Dyshekllëku dhe Divanhanja 15
3.4 Elementet mbrojtëse 17
4. Kullat në rajonin e Gjakovës 18
4.1 Gjakovë 20
Kulla e Abdullah Pashë Drenit, Gjakovë 20
Kulla e Sylejman Vokshit, Gjakovë 22
Kulla e Ibrahim Dylës, Gjakovë 23
Kulla e Currit, Gjakovë 24
Kulla e Koshit / Hysni Koshit, Gjakovë 26
Kulla e Xheladin/Astrit Kryeziut, Gjakovë 28
Kulla e Shahin Dulës, Gjakovë 29
Kulla e Hysen Hajdarit, Nivokaz 30
Kulla e Adem Ademajt 31
Kulla e Brahim Metës, Botushë 33
Kulla e Ethem Godenit, Rogovë 35
Kulla e Isa Zymber Binakajt, Devë 36
Kulla e Kaqel Ramës, Gërçinë 37
Kulla e Drane Bojaxhiut, Novosellë e Epërme 38
Kulla e Osman Bajramit, Firajë 40
Kulla e Osman Jakupit, Skivjan 41
Kulla e Sahit Avdylit, Dujakë 42
Kulla e Sylë (Arif) Aliajt, Palabardhë 43
Kulla e Tal Belit / Idriz Hereqit, Kralan 44

Kulla e Zeqë Ramë Sadrisë, Brovinë 45
Kulla e Agës, Cërmjan, Gjakovë 46
..... 46
Kulla e Ymer Pogës (Ymer Pogë Latifit), Rogovë e Hasit 47
Kulla-teqe e familjes Nivokazi, Nivokaz 48
Kulla e Isuf Sadikut / Rexhep Shaban Sadikut, Nivokaz 49
Kulla e Isa Zymer Binakaj 50
Kulla e Rexhep Hasanit, Rogovë e Hasit, Gjakovë 51
4.2 Kullat e Junikut 52
Kulla e Brahim Hoxhës, Junik 52
Kulla e Sadik Shehut, Junik 53
Kulla e Jah Imerit, Junik 54
Kulla e Tafë Hoxhës, Junik 55
Kulla e Ramë Zyber Krasniqit, Junik 56
Kulla e Sadik Shehu, Junik 57
Kulla e Rrustë Zeqirit, Junik 58
Kulla e Osmon Llollunit, Junik 60
Kulla e Kukajve, Junik 61
Kulla e Nur Shalës, Junik 62
..... 63
5. Kullat në rajonin e Prizrenit 63
5.1 Prizreni dhe rrethina 65
Kulla e Pjetër Prenkpalajt, Zym 65
Kulla e Tahir Reshitit/Ryshitit, Kojushë 67
Kulla e Zaptijve, Zym 68
Kulla e familjes Cikaj, Gjonaj, Prizren 69
Shtëpia e gurit e familjes Hoxhaj, Zhur, Prizren 70
5.2 Rahoveci 71
Kulla e Ismet Çemegës, Rahovev 71
Kulla e Hajrulla Qantës, Rahovec 73
Kulla e Mahmud Pashës, Opterushë 75
Kulla-shtëpi e Qamil Vuçitërnës, Rahovec 76
5.3 Suhareka dhe Malisheva 77
Kulla e Jonuz Hasan Tafollit , Çadrak, Suharekë 77

Kulla e Ramë Bllacës, Bllacë, Suharekë 78
Kulla e Shaqir Hazrollit, Banjë, Malishevë 79
6. Kullat e rrënuara 80
Kulla e Musë Rexhepajt, Hereq (e rrënuar në vitin 2025) 80
..... 81
Kulla e Ismail Hodaj Pogaj, Krajk, Prizren (e rrënuar në vitin 2012) 82
..... 82
Kulla e Ahmet Asllanit, Devë 83
..... 84
6.3.7 Kulla e Lush Uk Isufajt, Junik 84
Kulla e Pepshve, Junik 84
Kulla e Arif Musës, Gjakovë 85
Kulla e Hazir Sadikut, Nivokaz, Gjakovë 85
Kulla e Haxhi Mustafës, Gjakovë 85
9. Përfundime dhe rekomandime 86
Përfundime 86
Rekomandime 87
Bibliografia dhe burimet 89
Libra dhe studime 89
Dokumentacion institucional dhe arkivor 89
Raporte, plane dhe publikime të organizatave 90
Burime mediatike dhe audiovizuale 90
Për EC: 91
Deklarata e vizionit 91
Deklarata e misionit 91

Tabela e figurave:

Figura 1 Organizimi vertikal tipik i kullave në rrafshin e Dukagjinit sipas funksionit dhe elementeve te zakonshme 15
Figura 2 Dyshekllëku nga materiali i gurit 16
Figura 3 Dyshekllëku nga druri 16
Figura 4 Pozita e vendosjes seë dyshekllëkut në rrafshin e Dukagjinit (burimi: F. Doli) 16
Figura 5 Kulla e Abdullah Pashë Drenit, pamja ballore (burimi: DTKK) 20
Figura 6 Kulla e Avdullah Pashe Drenit 21
Figura 7 Kulla e Abdullah Pashë Drenit (para restaurimit burimi:DTKK) 21
Figura 8 Kulla e Sylejman Vokshit, pamja anësore (burimi: DTKK) 22
Figura 9 Kulla e Sylejman Vokshit, pamja ballore (burimi:: DTKK) 22
Figura 10 Pamja e kullës së Ibrahim Dylës nga rruga (Burimi: QRTK- Gjakovë) 23
Figura 11 Pamja e kullës së Ibrahim Dylës nga oborri (Burimi: QRTK- Gjakovë) 23
Figura 12Pamje e Kullës së Currit (Burimi: QRTK-Gjakovë) 24
Figura 13 12 Pamje e pjesës së intervenuar të Kullës së Currit (burimi : QRTK- Gjakovë) 24
Figura 14 Pamje të përpunimeve të enterierit të Kullës së Currit (Burimi: QRTK- Gjakovë) 25
Figura 15 Kulla e Hysni Koshit, pamja ballore (Burimi DTTK- Kulla e Hysni Koshit) 26
Figura 16 Fotografi e vjetër e kullës së Hysni Koshit, detaje të përpunimit të dyshekllëkut (burimi: DTKK) 26
Figura 17 Pamje të kullës së Koshit nga rruga (burimi: QRTK- Gjakovë) 27
Figura 18 Pamje e kullës gjatë restaurimit (Burimi: Ministria e Kulturës dhe Turizmit, Nentor 2025) 28
Figura 19 Pamje e kullës gjatë restaurimit (Burimi: Ministria e Kulturës dhe Turizmit, Nentor 2025) 28
Figura 20 Kulla e Shahin Dulës në lagjën e Kusarëve (Burimi: QRTK- Gjakovë) 29
Figura 21 Kulla e Shahin Dulës në lagjën e Kusarëve (Burimi: QRTK- Gjakovë) 29
Figura 22 Pamje e kullës Hysen Hajdari gjatë restaurimit (burimi: CHwB) 30
Figura 23 Pamje e kullës Hysen Hajdari (burimi: CHwB) 30
Figura 24 Pamje e kullës Adem Ademajt dhe shkallët që të shpiejn ne odën e burrave (Burimi: QRTK-Gjakove) 31
Figura 25 Pushimorja e kullës e mbyllur me tulla të pjekura (burimi: QRTK- Gjakovë) 31
Figura 26 Pamje e dyshekllëkut (Burimi: QRTK- Gjakovë) 32
Figura 27 Detaje nga dritaret harkore të kullës (Burimi: QRTK- Gjakovë) 32
Figura 28 Pamje e kullës së Brahim Metës nga rruga (Burimi: QRTK- Gjakovë) 33
Figura 29 Pamje e kullës së Brahim Metës nga oborri i brendshëm (Burimi: QRTK- Gjakovë) 33
Figura 30 Pamje e kullës së Brahim Metës nga oborri (Burimi: QRTK- Gjakovë) 34
Figura 31 Pamje e odës së burrave të kullës së Brahim Metës (Burimi: QRTK- Gjakovë) 34
Figura 32 Përpunimi me gurë të latuar të kullës së Ethem Godenit (burimi: QRTK- Gjakovë) 35
Figura 33 Detaje të dyerve të kullës së Ethem Goden-it (burimi: QRTK- Gjakove) 35
Figura 34 Pamje e kullës së Isa Zymber Binakaj”, (Burimi: QRTK- Gjakove) 36
Figura 35 Detaje të përpunimit të muraturës prej gurit të kullës së Isa Zymber Binakaj”, (Burimi: QRTK Gjakove) 36
Figura 36 Pamje e Kullës e Kaqel Ramës,(Burimi: QRTK - Gjakovë, 2024) 37

Figura 37 Pamje e Kullës e Kaqel Ramës,(Burimi: QRTK - Gjakovë, 2024) 37
Figura 38 Pamja e kullës pas restaurimit (burimi: QRTK- Gjakove) 38
Figura 39 Pamja e kullës para restaurimit (burimi: QRTK- Gjakove)..... 38
Figura 40 Pamje e brendshme e kullës në përdhesë (burimi: QRTK- Gjakove)..... 39
Figura 41 Detaji i hapjeve të dyshekllëkut të kullës (burimi: QRTK- Gjakovë) 40
Figura 42 Pamje e pjesës së dëmtuar të kullës (burimi QRTK- Gjakovë) 40
Figura 43 Pamja ballore e kullës (burimi: QRTK- Gjakovë) 40
Figura 44 Pamje e kullës së Osman Bajramit- Firajë (burmi: QRTK- Gjakovë) 40
Figura 45 Detaje të përpunimit të dyshekllëkut të kullës së Osman Jakupit (Burmi: QRTK- Gjakove)41
Figura 46 Pamje të kullës së Osman Jakupit(burimi: QRTK- Gjakove) 41
Figura 47 Detaje të hapjeve të kullës së Sahit Avdylit (Burimi: QRTK- Gjakovë)..... 42
Figura 48 Pamje nga rruga të kullës së Sahit Avdylit (Burimi: QRTK- Gjakovë)..... 42
Figura 49 Kulla e Sylë Aliajt (Burimi: QRTK- Gjakovë) 43
Figura 50 Detaje të derës të kornizuar me gurë të latuar (burimi: QRTK- Gjakovë) 43
Figura 51 Kulla e Tal Belit / Idriz Hereqit në Kralan, pamja ballore e kullës(Burimi: QRTK Gjakovë) . 44
Figura 52 Detaje të derës me material të drurit (Burimi: QRTK- Gjakovë) 44
Figura 53Kulla e Tal Belit / Idriz Hereqit në Kralan, para ndërhyrjes së raportuar më 2024. (Burimi: QRTK Gjakovë) 44
Figura 54Kulla e Zeqë Ramë Sadrisë në Brovinë, pamja e kullës me dyshekllëk në poziten në qendër të fasadës kryesore (Burimi: QRTK Gjakovë) 45
Figura 55 Detaje te hapjeve të dritareve (burimi: QRTK- Gjakovë..... 45
Figura 56 Pamje të kullës së Agës në Cërmjan me dyshekllëkun në Përgjatë fasadës kryesore dhe pjesërisht në anën e majtë (Burimi: QRTK- Gjakovë) 46
Figura 57 Pamje të kullës së Agës Cërmjan (burimi: QRTK- Gjakovë)..... 46
Figura 58 Pamje nga njëra prej hapjeve të Kullës së Ymer Pogës (Burimi: MKRS)..... 47
Figura 59 Pamje e Kullës nga sipër, pas fazës së parë të restaurimit (Burimi: MKRS, janar 2026) 47
Figura 60 Kulla në fazën restauruese (Burimi: MKRS, tetor 2026)..... 47
Figura 61 Kulla e Sadik Nivokazit (Burimi: DTTK- Gjakovë)..... 48
Figura 62 Kulla e Sadik Nivokazit (Burimi: DTTK- Gjakovë)..... 48
Figura 63 Pamja ballore e kullës së Isuf Sadikut (Burimi: DTKK)..... 49
Figura 64 Pamje të enterierit të kullës së Isuf Sadikut (burimi: DTKK) 49
Figura 65 Detajet e muratures së kullës së Isa Zymer Binakaj (burimi: QRTK- Gjakove) 50
Figura 66 Pamje e kullës së Isa Zymer Binakaj (Burimi: QRTK- Gjakovë) 50
Figura 67 Përpunimi i dyshekllëkut të kullës së Rexhep Hasanit (burimi: QRTK- Gjakovë)..... 51
Figura 67 Pamje të kullës së Brahim Hoxhës/ Odës së Junikut (burimi: DTKK)..... 52
Figura 68 Pamje e enterierit të kullës së Brahim Hoxhës (Burimi: DTKK)..... 52
Figura 69 Kulla e Sadik Shehut (burimi: QRTK- Gjakove)..... 53
Figura 70 Detaj i hapjeve në kullën e Jah Imerit në Junik. (Burimi: QRTK Gjakovë)..... 54
Figura 71 Pamja nga rruga e kullës së Jah Imerit në Junik. Burimi: QRTK Gjakovë; 54
Figura 72 Pamja anësore nga rruga e Kullës së Tafë Hoxhës në Junik (Burimi: QRTK Gjakovë)..... 55
Figura 73 Pamja ballore e Kullës së Tafë Hoxhës në Junik (Burimi: QRTK Gjakovë)..... 55
Figura 74 Kulla e Ramë Zyber Krasniqit në Junik. (Burimi: QRTK Gjakovë) 56
Figura 75 Kulla e Sadik Shehut (burimi: QRTK – Gjakovë) 57
Figura 76 Pamja e oborrit të kullës së Sadik Shehut (burimi: QRTK – Gjakovë)..... 57

Figura 77 Pamja e kullës së Rrustë Zeqirit, pas restaurimit (Burimi: QRTK- Gjakovë) 58
Figura 78 Pamja e kullës së Rrustë Zeqirit, pas restaurimit (Burimi: QRTK- Gjakovë) 58
Figura 79 Pamja e pjesës së oborrit (Burimi: QRTK- Gjakovë) 58
Figura 80 Shkallët e kullë sës Osmon Llollunit që të shpiejnë në odë të burrave (burimi: QRTK – Gjakovë) 60
Figura 81 Pamja e kullës së Osmon Llollunit nga oborri (Burimi: QRTK - Gjakovë) 60
Figura 82 Kulla e Kukajve me dyshekllëkun në tri fasada(Burimi: QRTK - Gjakovë) 61
Figura 83 Pamja e kullës së Nur Shalës nga rruga (burimi: QRTK- Gjakovë) 62
Figura 85 Pamje e Kullës së Pjetër Prenkplalajt para restauirmit (Burimi: QRTK – Prizren) 65
Figura 86 Kulla e Pjetër Prenkpalajt pamja pas restaurimit (burimi: MKRS) 65
Figura 86 Kulla e Pjetër Prenkpalajt pamja pas restaurimit (burimi: MKRS) 66
Figura 88 Kulla e Tahir Reshitit, pamja ballore (burimi: QRTK Prizren) 67
Figura 89 Pamja e ahurit në përdhesë (burimi: QRTK-Prizren) 67
Figura 90 Pamje të kullës së Zaptijve me murë të dëmtuar (QRTK- Prizren, shkurt 2025) 68
Figura 91 Detaje e shkallëve në kullën e Zaptive (QRTK- Prizren, shkurt 2025) 68
Figura 92 Pamja ballore e Kullës së Familjes Cikaj, Gjonaj, Prizren (QRTK Prizren, 2023) 69
Figura 93 Konstruksioni mes-katësh pothuajse i shkatërruar i Kullës së Familjes Cikaj, Gjonaj, Prizren (QRTK Prizren, 2023) 69
Figura 94 Pamje Verilindore e kullës së familjes Hoxhaj (Burimi : QRTK- Prizren) 70
Figura 95 Parahyjra në dhomën kryesore - hamamgjiku dhe qymlekllëku (burmi: QRTK- Prizren) 70
Figura 96 Kulla e Ismet Çemegës para restaurimit 2013 (Burimi: DDTK) 71
Figura 97 Kulla e Ismet Çemegës pas restaurimit 2015 (Burimi: DDTK) 71
Figura 98 Kulla e Hajrulla Qantës, (Burimi: QRTK- Prizren, Mars 2025) 73
Figura 99 Kulla e Hajrulla Qantës, porta kryesore (Burimi: QRTK- Prizren, Mars 2025) 73
Figura 100 Pamja e kullës kah rruga kryesore (Burimi: QRTK- Prizren, Mars 2025) 74
Figura 101 Kulla e Mahmud Pashës, pamja Jug-lindore (burimi: DTKK) 75
Figura 102 Kulla e Mahmud Pashës, (burimi: DTKK) 75
Figura 103 Fasada veriore e kullës (burimi: QRKT – Prizren) 76
Figura 104 Mutfaku në përdhesë (burimi: QRTK- Prizren) 76
Figura 105 Kulla e Jonuz Hasan Tafollit, Fasada Jug-perëndimore (Burimi: DDTK) 77
Figura 106 Kulla e Jonuz Hasan Tafollit, Fasada verilindore (Burimi: DDTK) 77
Figura 107 Kulla e Ramë Bllacës, Fasada lindore (burimi: QRTK- Prizren) 78
Figura 108 Pamja ballore e kullës së Shaqir Hazrollit 79
Figura 108 Pamje të përpunimit të murit dhe hapjeve të Kullës së Shaqir Hazrollit 79
Figura 110 Pamja ballore e kullës së Musë Rexhepajt (Burimi: QRTK- Gjakovë) 80
Figura 111 Dëmtimet kyçe të kullës së Musë Rexhepajt (Burimi: QRTK- Gjakovë) 81
Figura 112 Fasada ballore me çardak, më 2002 (QRTK- Prizren) 82
Figura 113 Kulla sot e rrënuar tërësisht (QRTK- Prizren) 82
Figura 114 Gjendja e kullës në vitin 2012 (QRTK- Prizren) 82
Figura 115 Pamje e kullës në gjendjen e saj të shkatërruar (burimi: QRTK- Gjakovë) 83
Figura 115 Pamje e kullës në gjendjen e saj të shkatërruar (burimi: QRTK- Gjakovë) 83
Figura 116 Pamje e kullës së Arif Musës para rrënimit (burimi: QRTK- Gjakovë) 85
Figura 117Pamje e Kullës së rrënuar të Hazir Sadikut (Burimi: QRTK- Gjakovë) 85
Figura 118 Pamje e kullës së Haxhi Mustafës (burimi: QRTK- Gjakovë) 85

HYRJE

Kullat përbëjnë një nga shprehjet më të dallueshme të arkitekturës tradicionale shqiptare në Kosovë. Të ndërtuara për banim dhe mbrojtje, ato shërbyen njëkohësisht si hapësira të mikpritjes, kuvendimit dhe organizimit të jetës familjare e shoqërore. Nëpërmjet formës, materialeve dhe ndarjes së hapësirave, kullat pasqyrojnë mënyrën se si popullata iu përgjigjën nevojave të jetesës, pasigurisë dhe marrëdhënieve me rrethinën. Rëndësia e tyre qëndron si në mjeshtërinë ndërtimore, ashtu edhe në historitë, traditat dhe kujtesën që lidhen me to.


Rajoni i Gjakovës dhe Prizrenit ruajnë një trashëgimi të pasur të këtyre ndërtimeve, të pranishme në qytete, fshatra dhe lagje të formuara nga familje me lidhje farefisnore. Kullat e Junikut, të fshatrave të Gjakovës, të Hasit dhe të vendbanimeve të tjera të përfshira në këtë hulumtim dëshmojnë zgjidhje të ndryshme të banimit tradicional. Në mjediset rurale, ato shpesh ishin pjesë e kompleksëve me oborre, hambarë, kosha dhe ndërtesa ndihmëse, ndërsa në qytete lidheshin me rrugët, çarshitë dhe jetën tregtare e zejtare. Kjo shtrirje e bën kullën pjesë të rëndësishme të peizazhit kulturor dhe të historisë së vendbanimeve.

Ndërtimi i kullave mori përhapje të gjerë gjatë shekujve XVIII-XIX, ndonëse burimet përmendin edhe shembuj më të hershëm dhe vazhdimësi të këtij tipi në shekullin XX. Guri, druri dhe llaçet tradicionale, të plotësuara në disa raste me tulla e qerpiç, e dëshmojnë përdorimin e burimeve vendore dhe njohuritë e mjeshtërve. Muret masive, hyrjet e kontrolluara dhe frëngjitë shprehnin nevojën për siguri, ndërsa dyshekllëku, divanhanja dhe oda krijonin hapësira për qëndrim e pritje. Ndryshimet në përmasa, numër katesh dhe përpunim dekorativ tregojnë se kjo traditë përfshinte një larmi formash, të përshtatura me kushtet dhe mundësitë e secilës familje.

Një vend të veçantë në jetën e kullës e zinte oda, ku priteshin mysafirët, zhvilloheshin biseda, përcilleshin rrëfime dhe trajtoheshin çështje të komunitetit. Në raste të caktuara, kullat u bënë vende pajtimi, kuvendesh dhe veprimtarish me rëndësi historike. Përmes këtyre funksioneve, ato ruajtën lidhjen ndërmjet shtëpisë private dhe jetës publike. Edhe kullat që nuk lidhen me figura ose ngjarje të njohura mbartin dëshmi të vlefshme për jetën e përditshme, ekonominë familjare dhe marrëdhëniet shoqërore të kohës.

Kjo trashëgimi ka pësuar humbje të konsiderueshme. Luftërat, veçanërisht ajo e viteve 1998-1999, shkaktuan djegien dhe shkatërrimin e shumë kullave, bashkë me enterierët dhe sendet e trashëguara familjare. Braktisja, mungesa e mirëmbajtjes, ndërtimet e reja dhe ndërhyrjet e papërshtatshme kanë ndikuar gjithashtu në dëmtimin ose ndryshimin e karakterit të tyre. Krahas ndërtesave që ruhen, shumë kulla njihen përmes rrënojave, dokumenteve, fotografive dhe kujtimeve të banorëve. Dokumentimi i tyre është i rëndësishëm për të kuptuar edhe pjesën e humbur të kësaj trashëgimie.


EC Ma Ndryshe, përmes këtij hulumtimi, synon të kontribuojë në njohjen, dokumentimin dhe promovimin e kullave në rajonin e Prizrenit dhe të Gjakovës. Duke u mbështetur në literaturë, formularë inventarizimi, dokumentacion institucional dhe burime të tjera për rastet individuale, hulumtimi trajton



zhvillimin historik, funksionet, tipologjinë, materialet dhe teknikat e ndërtimit, si dhe transformimet e gjendjen e dokumentuar të ruajtjes.

Rastet e trajtuara përfaqësojnë vetëm një pjesë të trashëgimisë së kullave në këto rajone. Jashtë kësaj përmbledhjeje mbeten edhe shumë kulla të tjera, mospërfshirja e të cilave nuk nënkupton rëndësi më të vogël historike, arkitekturore apo shoqërore. Një pjesë e kësaj trashëgimie është shkatërruar gjatë luftërave ose është rrënuar me kalimin e kohës, për shkak të braktisjes, mungesës së mirëmbajtjes dhe transformimeve të vendbanimeve. Edhe kur ndërtesat nuk ekzistojnë më, dokumentet, fotografitë dhe kujtesa e komunitetit mbeten dëshmi të vlefshme për historinë e tyre dhe të banimit tradicional.

Ruajtja e kullave kërkon kujdes për objektin, brendësinë dhe marrëdhënien e saj me oborrin e vendbanimin. Restaurimi, mirëmbajtja dhe përdorimet e përshtatshme mund të mbështesin vazhdimësinë e tyre si hapësira banimi, edukimi, kulture dhe mikpritjeje. Ky hulumtim synon të nxisë vëmendjen ndaj këtyre vlerave dhe përgjegjësinë për mbrojtjen e tyre, në mënyrë që kullat dhe historitë që ato mbartin të mbeten të kuptueshme e të pranishme për brezat e ardhshëm.



2. Historiku i Kullave në Kosovë dhe rëndësia e tyre

2.1 Zanafilla dhe zhvillimi historik

Kulla tradicionale në Kosovë përfaqëson një tipologji të shtëpisë së fortifikuar, ku ndërthuren nevojat e jetesës familjare, mbrojtjes dhe mikpritjes. Vëllimi kompakt, zhvillimi në lartësi, muret masive dhe hapjet e kufizuara pasqyrojnë kushtet në të cilat është formësuar kjo arkitekturë. Krahas funksionit praktik, kulla shprehte pozitën ekonomike të familjes dhe mënyrën e organizimit të marrëdhënieve shoqërore.[1]


Prejardhja e kullës është trajtuar në raport me zhvillimin e shtëpisë tradicionale shqiptare dhe me traditat e ndërtimeve të fortifikuara në Ballkan e në hapësirën mesdhetare. Megjithëse ekzistojnë ngjashmëri në formë dhe funksion, zhvillimi i saj në Kosovë lidhet me përshtatjen ndaj kushteve vendore, materialeve të disponueshme dhe praktikave të mjeshtërve. Për këtë arsye, duhen dalluar shembujt e hershëm të kullave nga periudha kur kjo tipologji u përhap më gjerësisht.[2]

Në Rrafshin e Dukagjinit, ndërtimi i kullave u zgjerua veçanërisht gjatë shekujve XVIII dhe XIX. Pasiguria lokale, konfliktet, gjakmarrja dhe ndryshimet në marrëdhëniet e pushtetit gjatë periudhës osmane nxitën nevojën për ndërtesa që garantonin edhe mbrojtjen e familjes e të pasurisë. Megjithatë, përhapja e tyre lidhej gjithashtu me fuqizimin ekonomik të familjeve të caktuara. Të ardhurat nga bujqësia, blegtoria dhe tregtia krijuan mundësi për ndërtime më të qëndrueshme dhe më përfaqësuese.[3]

Organizimi i familjes së zgjeruar dhe rëndësia e normave zakonore ndikuan në ndarjen e hapësirave dhe në marrëdhënien ndërmjet kullës, oborrit dhe ndërtesave ndihmëse. Mikpritja mori shprehje të veçantë në odën e burrave, ndërsa nevojat ekonomike dhe familjare përcaktuan përdorimin e pjesëve të tjera të kompleksit. Ndryshimet në përmasa, numër katesh dhe përpunim arkitektonik dëshmojnë se kullat nuk ndiqnin një model të vetëm, por përshtateshin me mundësitë dhe kërkesat e pronarëve por përshtateshin me mundësitë dhe kërkesat e pronarëve.[4]

Me kalimin e kohës, disa kulla u lidhën me tubime, strehim dhe veprimtari politike, duke marrë rëndësi në historinë lokale dhe kombëtare. Lufta e viteve 1998-1999 shkaktoi dëmtime dhe shkatërrime të shumta të këtij fondi ndërtimor. Humbjet përfshinë jo vetëm ndërtesat, por edhe enterierët, pajisjet dhe gjërat familjare të trashëguara. Kullat e ruajtura përbëjnë kështu dëshmi të arkitekturës tradicionale, të jetës shoqërore dhe të transformimeve historike të vendbanimeve ku ndodhen. [5]

[1] Sahar Rassam, "Kulla: A Traditional Albanian House Type in Kosovo"
[2] Caroline Jaeger-Klein, "The Traditional Tower Houses of Kosovo and Albania-Origin, Development and Influences," *UBT International Conference* (2018). Caroline Jaeger-Klein, "The Traditional Tower Houses of Kosovo and Albania-Origin, Development and Influences," *UBT International Conference* (2018).
[3] Lumnije Kadriu dhe Tahir Latifi, "Kullat në Rrafshin e Dukagjinit - hambar kujtese dhe identiteti kulturor"
[4] Kadriu dhe Latifi, "Kullat në Rrafshin e Dukagjinit," ; Flamur Doli, *Vernacular Architecture of Kosova*
[5] Kadriu dhe Latifi, "Kullat në Rrafshin e Dukagjinit,", Doli, *Vernacular Architecture of Kosova*



2.1.1 Funksioni i kullave

Kulla bashkonte funksionet e banimit, mbrojtjes, mikpritjes dhe ekonomisë familjare. Organizimi i tyre ndryshonte sipas madhësisë së ndërtesës, numrit të niveleve dhe pranisë së objekteve ndihmëse. Në kullat trekatëshe, një skemë e përhapur përfshinte përdhesën për bagëtitë dhe depot, katin e ndërmjetëm për jetën familjare dhe katin e sipërm për odën e pritjes. Megjithatë, kjo ndarje nuk ishte e njëjtë në të gjitha rastet.[6]


Përdhesa shërbente shpesh si ahur ose si vend për ruajtjen e produkteve dhe mjeteve të punës. Qasja nga oborri lehtësonte veprimtaritë e përditshme, ndërsa muret masive dhe hapjet e kufizuara ndihmonin në mbrojtjen e pasurisë. Hapësirat familjare përfshinin vendet për përgatitjen e ushqimit, qëndrimin dhe fjetjen. Në përshkrimet etnografike, "shtëpia e zjarrit" dhe qilarët paraqiten si pjesë të rëndësishme të këtij organizimi, të lidhura me jetesën e familjes së zgjeruar.[7]

Oda e burrave ishte hapësira kryesore e mikpritjes dhe e përfaqësimit të familjes. Aty priteshin mysafirët, zhvilloheshin biseda, tubime dhe, në raste të caktuara, ndërmjetësime konfliktesh. Rendi i uljes dhe mënyra e komunikimit pasqyronin respektin ndaj mysafirëve e të moshuarve, por edhe hierarkinë patriarkale. Oda kishte gjithashtu rol kulturor, ku përmes rrëfimeve, këngëve dhe bisedave përcilleshin kujtesa familjare dhe traditat ndërmjet brezave. Përpunimi i saj arkitektonik shprehte rëndësinë e mikpritjes dhe mundësitë ekonomike të shtëpisë.[8]

Funksioni mbrojtës realizohej përmes formës kompakte, muraturës masive, frëngjive dhe kontrollit të hyrjeve. Hapësirat e sipërme mundësonin vështrim drejt oborrit dhe rrethinës. Në disa variante, organizimi i hyrjeve dhe i shkallëve lejonte qasjen e mysafirëve në odë duke kufizuar kalimin nëpër hapësiratfamiljare. Kështu, qarkullimi ndërthurte nevojat e sigurisë me ruajtjen e privatësisë.[9]

Kulla funksiononte në lidhje me oborrin, hambarin, koshin, ahurin dhe hapësirat e tjera të punës. Ky kompleks mbështeste ekonominë bujqësore e blegtorale dhe veprimtaritë shtëpiake. Me ndryshimin e mënyrës së jetesës, disa kulla kanë humbur funksionet fillestare, ndërsa të tjera janë përshtatur për përdorime muzeale, kulturore ose turistike. Këto përdorime mund të mbështesin mirëmbajtjen dhe vazhdimësinë e tyre, kur respektojnë organizimin dhe karakterin historik të ndërtesës.[10]

[6] Florina Jerliu dhe Kaltrina Thaçi, "Building Typology of Albanian Kulla Stone Houses in the Balkans," *Built Heritage* 8, artikulli 5 (2024)
[7] Rassam, "Kulla: A Traditional Albanian House Type in Kosovo."; Kadriu dhe Latifi, "Kullat në Rrafshin e Dukagjinit"
[8] Kadriu dhe Latifi, "Kullat në Rrafshin e Dukagjinit"
[9] Jaeger-Klein, "The Traditional Tower Houses of Kosovo and Albania"; Rassam, "Kulla: A Traditional Albanian House Type in Kosovo"
[10] Kadriu dhe Latifi, "Kullat në Rrafshin e Dukagjinit"



2.2 Materialet dhe teknikat e ndërtimit

Materialet kryesore të kullave ishin guri, druri, dhe llaçet tradicionale, të plotësuara sipas rastit me tulla dhe materiale të ndryshme mbulimi. Zgjedhja e tyre varej nga burimet vendore, mundësitë ekonomike dhe mjeshtëria ndërtimore. Guri formonte pjesën kryesore të strukturës mbajtëse dhe të mbështjellësit të jashtëm, ndërsa druri përdorej në konstruksionet ndërkatëshe, çati dhe pajisjet e brendshme.[11]

Muratura realizohej me gurë të madhësive dhe formave të ndryshme, të lidhur me llaç, shpesh me bazë gëlqereje, në disa raste përmendet edhe përdorimi i baltës. Qoshet, portalet dhe kornizimet e hapjeve trajtoheshin zakonisht me gurë më të përpunuar. Muret kishin trashësi të konsiderueshme, në disa shembuj afërsisht një metër në përdhesë, dhe holloheshin drejt kateve të sipërme. Trashësia dhe cilësia e muraturës lidhen me kërkesat mbajtëse dhe mbrojtëse të ndërtesës.[12]

Konstruksionet ndërkatëshe përbëheshin zakonisht nga trarë druri dhe dysheme dërrasash. Druri përdorej edhe për shkallët, dyert, dritaret, dollapët dhe tavanet. Në odat me trajtim më të pasur, tavanet përmbanin ndarje gjeometrike, rozeta dhe elemente të gdhendura. Këto punime dëshmojnë aftësinë e mjeshtërve dhe rëndësinë përfaqësuese të hapësirës së pritjes. Ndërkaq, hapësirat e sipërme të qëndrimit, të përshkruara në literaturë me termat *dyshekllëk* dhe *divanhane*, realizoheshin në variante prej druri, murature ose me kombinime materialesh.[13]

Dritaret, frëngjitë dhe hyrjet pasqyronin marrëdhënien ndërmjet ndriçimit, ajrosjes dhe sigurisë. Katet e poshtme shpesh kishin hapje më të kufizuara, ndërsa hapësirat e sipërme të banimit e të pritjes mund të pajiseshin me dritare më të zhvilluara. Harqet dhe kornizimet prej guri të latuar ose tullash përbënin njëkohësisht zgjidhje konstruktive dhe elemente të kompozimit të fasadës. Në disa kulla, kombinimi i gurit me tullën krijonte ndryshime të dallueshme në teksturë dhe ngjyrë.[14]

Çatia kishte zakonisht konstruksion druri dhe mbulohej me tjegulla argjile ose, në shembuj të caktuar, me rrasa guri. Përpunimi i strehëve, portaleve dhe detajeve të brendshme plotësonte karakterin arkitektonik të ndërtesës. Dekorimet në gur e dru përfshinin motive gjeometrike, floreale dhe shenja të tjera, kuptimi i të cilave ndryshonte sipas kontekstit. Ruajtja e këtyre materialeve dhe punimeve ka rëndësi për autenticitetin e kullës dhe për vazhdimësinë e mjeshtërive tradicionale që lidhen me të.[15]

[11] Rassam, "Kulla: A Traditional Albanian House Type in Kosovo"; Doli, *Vernacular Architecture of Kosova*

[12] Rassam, "Kulla: A Traditional Albanian House Type in Kosovo"Kadriu dhe Latifi, "Kullat në Rrafshin e Dukagjinit"

[13] Doli, *Vernacular Architecture of Kosova*; Ilir Muharremi, "Architectural, Artistic, and Interior Design Characteristics of Albanian Towers in the Dukagjini Plain: A Structural, Cultural, and Aesthetic Analysis"

[14] Rassam, "Kulla: A Traditional Albanian House Type in Kosovo"; Muharremi, "Architectural, Artistic, and Interior Design Characteristics"

[15] Doli, *Vernacular Architecture of Kosova*; Kadriu dhe Latifi, "Kullat në Rrafshin e Dukagjinit"



3. Tipologjia, organizmi dhe elementet mbrojtëse të kullave

Kulla e banimit në Kosovë ndërthur hapësirat e jetës familjare, ekonomisë shtëpiake dhe mikpritjes me kërkesat për mbrojtje. Forma e saj kompakte dhe organizimi në lartësi krijojnë një ndarje të qartë të funksioneve, ndërsa ndryshimet në dyshekllëk, hyrje dhe marrëdhënien me oborrin përcaktojnë variante të ndryshme arkitektonike. Megjithëse kullat ndajnë karakteristika të përbashkëta, organizimi i tyre përshtatet me terrenin, madhësinë e familjes, mundësitë ekonomike dhe fazat e ndërhyrjeve.

3.1 Forma dhe vendosja

Kullat zakonisht kanë planimetri katrore ose afërsisht drejtkëndëshe dhe zhvillohen në përdhesë e një ose dy kate, ndërsa rastet me më shumë nivele janë më të rralla. Pamja e jashtme karakterizohet nga mure masive, hapje të kufizuara në nivelet e poshtme dhe një trajtim më i hapur në katin e sipërm. Përmasat ndryshojnë ndërmjet rasteve, për këtë arsye, kulla përcaktohet më shumë nga marrëdhënia ndërmjet vëllimit, funksioneve dhe elementeve arkitektonike sesa nga një madhësi e vetme.[16]


Në vendbanimet rurale, kulla shpesh ishte pjesë e një kompleksi familjar me oborr, pus, hambar, kosh dhe ndërtesa të tjera ndihmëse. Vendosja e këtyre objekteve ndiqte konfiguracionin e terrenit dhe kufijtë e pronës. Në lagjet e formuara nga familje me lidhje farefisnore, kullat mund të grupoheshin përgjatë rrugës dhe të lidheshin me muret rrethuese, duke krijuar një tërësi me karakter mbrojtës. Kështu, funksionimi i kullës lidhej edhe me organizimin e oborrit dhe të lagjes përreth[17]

Flamur Doli e trajton kullën, oborrin dhe rrugën si sistem të koordinuar, pozicioni i dyshekllëkut lidhej me hyrjen, lëvizjen dhe fushëpamjen, ndërsa ndërtesat ndihmëse plotësonin ekonominë familjare. Ndërsa Mark Krasniqi përshkruan porta oborri me hyrje të madhe për kafshë e qerre dhe hyrje më të vogël për këmbësorë.[18]

[16] Florina Jerliu dhe Kaltrina Thaçi, "Building Typology of Albanian Kulla Stone Houses in the Balkans," *Built Heritage*, artikulli 5 (2024); Sahar Rassam, "Kulla: A Traditional Albanian House Type in Kosovo"

[17] Po aty

[18] Doli, Vernacular Architecture of Kosovo; Krasniqi, "Mikpritja në traditën shqiptare"



3.2 Organizimi vertikal dhe horizontal

Në kullën me tri nivele, përdhesa zakonisht shërbente si ahur dhe hapësirë për ruajtjen e ushqimit të bagëtive. Kati i parë përmbante hapësirat familjare, ndërsa kati më i lartë i kushtohej odës së burrave dhe pritjes së mysafirëve. Kjo renditje përfaqëson një skemë të përhapur, me variante ku një pjesë e funksioneve familjare vendosej në anekse ose ndërtesa të bashkëngjitura.[19]




Figura 1 Organizimi vertikal tipik i kullave në rrafshin e Dukagjinit sipas funksionit dhe elementeve te zakonshme

Organizimi horizontal bëhej më i ndarë në katet e banimit. Përkundrejt përdhesës, që shpesh mbetej një hapësirë e vetme, kati parë ndahej në dhomën e zjarrit, dhomat e fjetjes ose qilarët dhe hapësirat e ruajtjes. Shtëpia e zjarrit ishte qendra e gatimit, ushqimit dhe qëndrimit të përditshëm. Dhomat e fjetjes ishin më të vogla dhe ndaheshin shpesh me mure të lehta prej druri. Një korridor ose divanhane e vogël lidhte kthinat dhe shkallët, duke ndërmjetësuar kalimin drejt katit të pritjes.[20]

Qarkullimi mund të organizohej përmes hyrjeve dhe shkallëve të veçanta për familjen dhe mysafirët. Kjo u mundësonte të ardhurve të arrinin në odë pa kaluar nëpër hapësirat private të banimit. Shkallët e jashtme dhe të brendshme, prej guri ose druri, ndryshonin sipas kullës dhe marrëdhënies së saj me oborrin.[21]

3.3 Oda, Dyshekllëku dhe Divanhanja

Oda e burrave ishte hapësira më përfaqësuese e kullës. Ajo shërbente për pritje, biseda, kuvende dhe ceremoni familjare, ndërsa natën mund të përdorej për fjetjen e mysafirëve. Organizimi rreth oxhakut shprehte edhe hierarkinë shoqërore, çerga e madhe u kushtohej mysafirëve të nderuar, ndërsa çerga e vogël familjarëve dhe të afërmve. Tavani i punuar, dera e gdhendur, dollapët dhe raftet bashkonin përdorimin praktik me përpunimin artistik të brendësisë. [22] Divanhanja ishte hapësira ndërmjetëse përpara odës, me funksione qarkullimi dhe qëndrimi. Me të lidhej dyshekllëku, një pjesë e ngritur për ndejë ose pushim, e cila në shumë kulla shfaqej jashtë si galeri e dalë prej druri ose guri.

[19] Rassam, "Kulla: A Traditional Albanian House Type in Kosovo"; Jerliu dhe Thaçi, "Building typology of Albanian *kulla* stone houses in the Balkans"

[20] Jerliu dhe Thaçi, "Building typology of Albanian *kulla* stone houses in the Balkans"

[21] Rassam, "Kulla: A Traditional Albanian House Type in Kosovo"; Jerliu dhe Thaçi, "Building typology of Albanian *kulla* stone houses in the Balkans"

[22] Lumnije Kadriu dhe Tahir Latifi, "Kullat në Rrafshin e Dukagjinit - hambar kujtese dhe identiteti kulturor"; Jerliu dhe Thaçi, "Building typology of Albanian *kulla* stone houses in the Balkans"

Dritaret e shumta siguronin ndriçim, ajrosje dhe pamje drejt rrethinës. Këto hapësira përdoreshin edhe gjatë stinës së ngrohtë, duke i dhënë katit të sipërm një karakter më të hapur.[23]

Në studimet për Kosovën, një kriter kryesor i klasifikimit është materiali dhe pozita e dyshekllëkut. Dallohen kullat me dyshekllëk druri dhe ato me dyshekllëk guri. Varianti prej druri lidhet përgjithësisht me forma më të hershme, kurse prej materialit të gurit është paraqitur më vonë.




Figura 3 Dyshekllëku nga druri




Figura 2 Dyshekllëku nga materiali i gurit

Klasifikimi i Flamur Dolit, i dallon shtatë variante sipas shtrirjes së dyshekllëkut në rrafshin e Dukagjinit: në pjesën qendrore të ballinës; përgjatë tërë ballinës; në ballinë dhe pjesërisht në të dy anët; në ballinë dhe në anën e majtë; në ballinë dhe në anën e djathtë; në këndin e majtë; dhe në këndin e djathtë

Tipi	Pozita e dyshekllëkut
I	Në qendër të fasadës kryesore.
II	Përgjatë tërë fasadës kryesore.
III	Përgjatë fasadës kryesore dhe pjesërisht në të dy fasadat anësore.
IV	Përgjatë fasadës kryesore dhe pjesërisht në anën e majtë.
V	Përgjatë fasadës kryesore dhe pjesërisht në anën e djathtë.
VI	Në qoshen e majtë të fasadës kryesore, me vazhdim të pjesshëm anash.
VII	Në qoshen e djathtë të fasadës kryesore, me vazhdim të pjesshëm anash.

Tabela 1 Pozicionimi i dyshekllëkut sipas Dolit




Figura 4 Pozita e vendosjes seë dyshekllëkut në rrafshin e Dukagjinit (burimi: F. Doli)

[23] Jerliu dhe Thaçi, "Building typology of Albanian *kulla* stone houses in the Balkans"

3.4 Elementet mbrojtëse

Karakteri mbrojtës i kullës mbështetej te bashkëveprimi i mureve të trasha, lartësisë, hyrjeve të kontrolluara dhe hapjeve të vogla si dhe frëngjive. Muret mund të arrinin rreth një metër në nivelin e poshtëm dhe të ngushtoheshin drejt kateve të sipërme. Frëngjitë krijonin mundësi vrojtimi dhe përdorimi të armëve duke kufizuar ekspozimin e mbrojtësit. Ato duhen dalluar nga dritaret e vogla të banimit dhe të dyshekllëkut, të cilat shërbenin edhe për dritë, ajrim dhe privatësi.[24]

Mbrojtja shtrihej edhe në oborr, përmes mureve rrethuese dhe portave të forta. Në disa variante, shkallët e jashtme prej druri mund të asgjësoheshin gjatë sulmit për të ndërprerë qasjen në katet e sipërme. Këto zgjidhje e bënin kullën një ndertesë të organizuar për të përballuar rrezikun, ndërkohë që ruante hapësirat e nevojshme për jetesë dhe mikpritje[25]

[24] Rassam, "Kulla: A Traditional Albanian House Type in Kosovo"; Caroline Jaeger-Klein, "The Traditional Tower Houses of Kosovo and Albania-Origin, Development and Influences," *UBT International Conference* (2018)
[25] Po aty



4. Kullat në rajonin e Gjakovës

Kullat në rajonin e Gjakovës përbëjnë një trashëgimi ku arkitektura e banimit lidhet ngushtë me historinë e familjes, jetën e komunitetit dhe zhvillimet shoqërore e politike të vendit. Në këtë kapitull, ato trajtohen përmes shembujve nga qyteti i Gjakovës, fshatrat përreth dhe Juniku, duke vënë në pah marrëdhënien ndërmjet baneses qytetare dhe kullës së mjedisit rural. Përzgjedhja përqendrohet te kullat e përfshira në kuadrin e mbrojtjes së përkohshme dhe plotësohet me dëshmi për ndërtesa të dëmtuara ose të rrënuara. Ajo përfaqëson vetëm një pjesë të trashëgimisë së rajonit, kullat e tjera që nuk përfshihen këtu kanë gjithashtu rëndësi për historinë vendore, ndërsa humbja e shumë prej tyre ka lënë boshllëqe në peizazhin e ndërtuar dhe në dokumentimin e mënyrave të mëparshme të jetesës.

Një nga veçoritë që del nga shqyrtimi i këtyre ndërtesave është bashkëjetesa e karakterit mbrojtës me hapjen ndaj jetës shoqërore. Muret masive, frëngjitë dhe hyrjet e kontrolluara bashkëjetojnë me odat, çardakët dhe hapësirat e pritjes. Kulla siguronte privatësinë e familjes, por njëkohësisht krijonte vend për mysafirë, kuvende dhe veprimtari që përfshinin bashkësinë më të gjerë. Kjo marrëdhënie ndërmjet sigurisë dhe mikpritjes ndihmon të kuptohet organizimi i saj, qasjet e veçanta dhe ndarja e hapësirave lejonin zhvillimin e jetës familjare krahas përdorimit shoqëror të odës.

Në qytetin e Gjakovës, afërsia me Çarshinë e Madhe dhe lagjet historike i lidh kullat me tregtinë, zejtarinë dhe jetën publike. Ato marrin pjesë në formësimin e rrugëve dhe të oborreve, ndërsa disa ruhen si fragmente të kompleksëve familjare dikur më të mëdha. Përdorimi i tullës së pjekur, shpesh mbi një bazë prej guri, çardakët e hapur ose të mbyllur dhe përpunimi i brendësive krijojnë një shprehje të dallueshme qytetare. Megjithatë, prania e kullave tërësisht prej guri brenda çarshisë tregon se kufiri ndërmjet tipit qytetar dhe atij rural mbetet i përshkueshëm. Traditat ndërtimore ndërthuren dhe përshtaten me pozitën, funksionin dhe historinë e secilës familje.

Në fshatrat përreth dhe në Junik, kulla lidhet më drejtpërdrejt me ekonominë bujqësore, oborrin dhe organizimin farefisnor të vendbanimit. Hambarët, koshat, muret rrethuese dhe ndërtesat ndihmëse e plotësonin si pjesë të një tërësie banimi. Rrëfimet për familjet e mëdha duhen kuptuar brenda këtij kompleksi, ku jeta shpërndahej në disa ndërtesa dhe hapësira të përbashkëta. Vendosja pranë rrugëve, në qendrat e fshatrave ose në terrene me pamje të hapura krijonte marrëdhënie të ndryshme me kalimtarët dhe rrethinën. Në Junik, grupimet e kullave brenda lagjeve familjare e bëjnë këtë arkitekturë pjesë të strukturës së vendbanimit, me vlerë përtej ndërtesës së veçuar.

Organizimi vertikal është një tipar i përsëritur, veçanërisht në kullat me përdhesë dhe dy kate: hapësirat ekonomike vendoseshin poshtë, banimi familjar në nivelin e ndërmjetëm dhe oda e mysafirëve sipër. Kjo skemë i jepte pritjes një vend të dallueshëm brenda shtëpisë, të shprehur edhe në fasadë përmes dyshekllëkut. Ndryshimet në materialin, shtrirjen dhe daljen e tij nga rrafshi i murit krijojnë një larmi të konsiderueshme



arkitektonike. Krahas këtyre shembujve, kullat dykatëshe dhe ato me trajtim më të përmbajtur dëshmojnë zgjidhje më të thjeshta, por po aq të rëndësishme për njohjen e banimit tradicional.

Individualiteti i kullave shprehet përmes mënyrës së punimit të materialeve. Muratura me gurë lumi ose gurë të parregullt shpesh plotësohet me qoshe, portale dhe korniza të latuara, ku ndryshimet e ngjyrës theksojnë pjesë të caktuara të fasadës. Druri shërben njëkohësisht si material konstruktiv dhe dekorativ, nga trarët ndërkatësh deri te tavanet, dyert dhe dollapët. Dëshmitë për mjeshtrit dibranë dhe vendas tregojnë qarkullimin e njohurive ndërtimore dhe bashkëpunimin në realizimin e strukturës e të brendësisë.

Pesha shoqërore e odës është veçanërisht e dukshme, ajo është si vend mikpritjeje, pajtimi dhe përcjelljeje të memories ndërmjet brezave. Rendi i qëndrimit pranë vatrës, hapësirat e caktuara për të rinjtë dhe mënyra e pritjes tregojnë se marrëdhëniet shoqërore kishin një shprehje konkrete hapësinore. Në raste të caktuara, kullat morën edhe funksione arsimore, administrative ose fetare. Lidhjet me figura dhe ngjarje historike u shtojnë një dimension tjetër, ndërsa shtëpitë pa emra të njohur ruajnë dëshmi po aq të vlefshme për jetën e përditshme dhe organizimin e komunitetit.

Gjendja e kësaj trashëgimie pasqyron pasojat e luftërave, ndarjen e familjeve të mëdha, zhvendosjen e banimit dhe ndryshimet në vendbanime. Humbja e kateve, e odave dhe e ndërtesave ndihmëse ka ndryshuar si siluetën e kullave, ashtu edhe kuptimin e tyre funksional. Restaurimet dhe përshtatjet për muze, bujtina ose veprimtari kulturore krijojnë mundësi për vazhdimësinë e përdorimit, por kërkojnë ruajtjen e materialit historik dhe të organizimit karakteristik. Vlera e kullave të Gjakovës qëndron pikërisht në lidhjen ndërmjet ndërtesës, mjedisit dhe jetës që është zhvilluar brenda saj. Ruajtja e kësaj lidhjeje e mban trashëgiminë të kuptueshme edhe për brezat që nuk e kanë përjetuar mënyrën tradicionale të banimit.



4.1 Gjakovë

Kulla e Abdullah Pashë Drenit, Gjakovë



Figura 5 Kulla e Abdullah Pashë Drenit, pamja ballore (burimi: DTKK)

Në hyrje të Çarshisë së Madhe të Gjakovës, Kulla e Avdullah Pashë Drenit bashkon tiparet e shtëpisë qytetare të fortifikuar me memorien e ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ndërtimi i saj supozohet se daton rreth vitit 1790. Pranë Teqesë së Sheh Eminit, Shtëpisë së Sylejman Vokshit dhe Kullës së Koshit, ajo është pjesë e një tërësie të rëndësishme të trashëgimisë së qytetit.[26]

Kulla e ruajtur përfaqëson vetëm një pjesë të sarajeve të dikurshme të familjes Dreni. Sipas historianit Masar Rizvanolli, kjo pjesë shërbente për pritjen e mysafirëve, ndërsa banimi i familjes zhvillohej në ndërtesa të tjera të kompleksit. Kjo lidhje me një pronë më të gjerë ndihmon për të kuptuar funksionin dhe vendin e kullës në jetën qytetare të kohës.[27]

Ndërtesa zhvillohet në tri nivele, me përdhesën prej guri dhe dy katet e sipërme prej tullash të pjekura. Një nga veçoritë e saj është çardaku i mbyllur, i vendosur në njërin skaj, me dritare në disa faqe. Hapjet gjysmëharkore, portat dhe ndërthurja e gurit me tullën i japin fasadave një pamje të dallueshme. Krahas dritareve, muret përmbajnë frëngji në të tria nivelet, duke dëshmuar funksionin mbrojtës të ndërtesës. Në përshkrimin e Muzeut të Historisë së Gjakovës përmenden gjithsej 58 frëngji.[28]

Në shtator të vitit 1878, prona e Drenit u bë vendi i përplasjes ndërmjet forcave të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të dërguarit osman Mehmed Ali Pasha, i njohur si Maxharr Pasha. Ai ishte strehuar te Avdullah Pashë Dreni gjatë misionit për zbatimin e vendimeve të Traktatit të Berlinit. Dreni refuzoi kërkesën për dorëzimin e tij, duke iu përmbajtur detyrimit zakonor për mbrojtjen e mikut. Përleshjet përfunduan me vrasjen e të dy pashallarëve. Kjo ngjarje shënoi një kthesë në marrëdhëniet e Lidhjes me pushtetin osman dhe e lidhi kullën me historinë e qëndresës ndaj lëshimit të territoreve shqiptare.[29]

[26] Databaza e Trashëgimisë Kulturore, "Kulla e Avdullah Pashë Drenit"

[27] Artan Krasniqi, *Monument*, vëll. V, "Kulla e Gjakovës ku ruhet një rrëfim për Lidhjen e Prizrenit".

[28] Muzeu i Historisë Gjakovë, historiku i muzeut dhe informacioni për ekspozitat dhe përdorimin e hapësirave, , Databaza e Trashëgimisë Kulturore, "Kulla e Avdullah Pashë Drenit, Artan Krasniqi, *Monument*, vëll. V, "Kulla e Gjakovës ku ruhet një rrëfim për Lidhjen e Prizrenit

[29] Daut Dauti, *Britain, the Albanian Question and the Demise of the Ottoman Empire 1876-1914*, disertacion doktoral, University of Leeds, 2018,

Gjatë shekullit XX, kulla mori funksion muzeal. Muzeu Rajonal i Gjakovës filloi punën e rregullt më 3 mars 1973, me qëllim mbledhjen, ruajtjen dhe ekspozimin e trashëgimisë së rajonit. Në përdorimin e mëvonshëm si Muze i Historisë, hapësirat e kullës iu kushtuan veçanërisht Rilindjes Kombëtare dhe Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, përmes dokumenteve, fotografive, armëve dhe veshjeve të kohës. Përshkrimi i muzeut e ndan përdorimin e ndërtesës ndërmjet informimit turistik në përdhesë, ekspozitës historike në katin e parë dhe aktiviteteve kulturore e artistike në katin e sipërm.[30]



Figura 7 Kulla e Abdullah Pashë Drenit (para restaurimit burimi:DTKK)



Figura 6 Fotografi e vjetër Kulla e Avdullah Pashe Drenit (burimi: QRTK-Gjakovë)

[30] Muzeu i Historisë Gjakovë, historiku i muzeut dhe informacioni për ekspozitat dhe përdorimin e hapësirave.

Kulla e Sylejman Vokshit, Gjakovë



Figura 8 Kulla e Sylejman Vokshit, pamja anësore (burimi: DTKK)

Pranë hyrjes së Çarshisë së Vjetër të Gjakovës, në vendin e njohur si Mejtepi Ruzhdije, Kulla e Sylejman Vokshit ndërthur arkitekturën e banimit qytetar me kujtesën e një prej figurave kryesore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. E datuar në fillim të shekullit XVIII dhe e njohur si vendlindja e tij, ajo mbart historinë e familjes Vokshi dhe lidhjen e saj me qytetin.[31]

Historia familjare njeh edhe një kullë tjetër, të ndërtuar nga Sylejmani pas ndarjes nga vëllezërit, e cila trashëgoi po të njëjtin emër.[32] Kështu, pas emërtimit të kullës qëndrojnë dy ndërtesa dhe dy etapa të jetës së tij, të cilat duhen dalluar nga njëra-tjetra.

Guri natyror dhe tullat e pjekura, të lidhura me llaç gëlqereje, ndërthuren me drurin dhe mbulesën prej qeramidheve tradicionale. Ndërtesa zhvillohet në dy etazhe, me orientim nga jugperëndimi dhe dritare katërkëndëshe. Niveli i poshtëm, i njohur si bodrum megjithëse ndodhet mbi tokë, shërbente për ruajtjen e ushqimeve, duke dëshmuar lidhjen e organizimit të shtëpisë me nevojat e përditshme të familjes. Përdorimi ndër vite ka sjellë ndryshime të vogla në brendësi, si dhe në dyer e dritare.[33]

Me kullën e ndërtuar më vonë nga Sylejmani lidhet edhe një rrëfim për mungesën e frëngjive. Sipas kujtesës familjare të përcjellë nga Shefqet Vokshi, ai mendonte se qëndresa duhej zhvilluar jashtë oborrit të shtëpisë.[34] Kjo hollësi, e ruajtur në traditën gojore, e lidh kullën me personalitetin e të zotit dhe e pasuron historinë e saj përtej gurit dhe mureve.



Figura 9 Kulla e Sylejman Vokshit, pamja ballore (burimi:: DTKK)

[31] Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, përshkrimi i Kullës së Sylejman Vokshit, Gjakovë

[32] Artan Krasniqi, "Kulla e luftëtarëve të përjetshëm," në *Monument*, vëll. V

[33] Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, përshkrimi i Kullës së Sylejman Vokshit, Gjakovë

[34] Artan Krasniqi, "Kulla e luftëtarëve të përjetshëm," në *Monument*, vëll. V

Kulla e Ibrahim Dylës, Gjakovë



Figura 10 Pamja e kullës së Ibrahim Dylës nga rruga (Burimi: QRTK-Gjakovë)

E ndërtuar rreth viteve 1802-1807 në Gjakovë, Kulla e Ibrahim Dylës ndërthur historinë e banimit qytetar me jetën zejtare dhe tregtare të qytetit. Krahas përdorimit për banim, ajo njihej si vend tubimi për zejtarët dhe tregtarët gjakovarë, duke mbartur edhe një rol shoqëror në komunitet.[35]

Kulla i përket tipologjisë së kullave qytetare me tulla të pjekura dhe zhvillohet në përdhesë e kat, mbi një plan drejtkëndësh. Fillimisht, përdhesa shërbente për strehimin e kafshëve, ndërsa kati për banim. Pasazhi që lidh rrugën me oborrin përbën një element të rëndësishëm të organizimit të saj. Guri, tullat e pjekura dhe druri, të ndërthurura me llaç gëlqereje, formojnë strukturën e ndërtesës. Fasada kryesore dallohet për hapjet me harqe gjysmërrethore, ndërsa hyrja theksohet nga një hark guri. Në brendësi, tavanet dhe dyert prej druri të gdhendur, oda e burrave dhe shqolli, një element për larjen e duarve në kat, dëshmojnë kujdesin për përpunimin e kullës dhe zakonet e jetesës.

Përdorimi dhe ndërhyrjet ndër vite kanë ndryshuar disa hapje dhe formën e kulmit, nga katërujor në tri pjerrësi. Restaurimi i pjesshëm emergjent më 2010, në murin e jashtëm dhe kulm, ndihmoi në shmangien e rrënimit. Megjithatë, lagështia, ngricat dhe dëmtuesit biologjikë kanë shkaktuar erozion të tullave e llaçit, degradim të gurit dhe kalbje të elementeve prej druri. Veçanërisht e dëmtuar paraqitet pjesa e pabanueshme, ku në disa kthina mungon dyshemeja dhe kanë mbetur trarët e dëmtuar të konstruksionit ndërkatësh.

Vlera e ruajtjes së kullës qëndron te bashkimi i arkitekturës qytetare, mjeshtërisë tradicionale dhe kujtesës së jetës tregtare të Gjakovës. Konservimi i saj do të mbronte këto dëshmi, ndërsa përforcimi i strukturës dhe trajtimi i shkaqeve të degradimit janë thelbësore për vazhdimësinë e përdorimit dhe sigurinë e banorëve.[36]



Figura 11 Pamja e kullës së Ibrahim Dylës nga oborri (Burimi: QRTK-Gjakovë)

[35] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë "Kulla e Ibrahim Dylës"

Kulla e Currit, Gjakovë



Figura 12Pamje e Kullës së Currit (Burimi: QRTK-Gjakovë)

Në Mahallën Honkë, pranë Çarshisë së Madhe të Gjakovës, Kulla e Currit e shfaq karakterin qytetar të kullës, ku muret masive ndërthuren me çardakun e hapur dhe hollësitë dekorative të drurit. E ndërtuar në shekullin XIX, ajo ruan në oborrin, hapësirat dhe punimet e brendshme gjurmët e mënyrës tradicionale të jetesës gjakovare.[37] Historia e familjes Curri i shton kësaj shtëpie një dimension tjetër, duke e lidhur jetën e përditshme me kujtesën historike të qytetit.[38]

Afërsia e kullës me Xhaminë e Gërçarëve, Kullën e Dylave dhe Xhaminë e Hankës e vendos brenda një mjedisi të pasur me trashëgimi kulturore. Ajo i përket tipologjisë së banesave qytetare në formë kulle, të ndërtuara nga bejlerët dhe shtresat e mesme të kohës, dhe ka shërbyer për banim.[39] Historia e saj lidhet me familjen Curri dhe kujtesën e figurave të Bajram e Qazim Currit, ndërsa vazhdimësia e banimit familjar e mban të lidhur me jetën e përditshme të qytetit. [40]

Ndërtesa zhvillohet në përdhesë dhe kat, me themele prej guri, mure prej qerpiçi e tullash të pjekura dhe konstruksione ndërkatëshe e kulmore prej druri. Kulmi mbulohet me tjegulla tradicionale. Fasada jugore, ku ndodhet hyrja kryesore, dallohet nga çardaku i katit, i mbështetur në dy shtylla. Një hollësi karakteristike është streha e profiluar në katër shkallëzime, me dalje rreth 30 centimetra nga muri. Qasja përmes oborrit në anën jugore dhe lindore krijon lidhjen ndërmjet kullës dhe hapësirës së saj të jashtme, ndërsa në veri dhe perëndim objekti kufizohet me rrugë.[41]

Në brendësi, tavanet, dollapët e integruar, shkallët dhe dyert prej druri të punuar dëshmojnë mjeshtërinë dekorative të banesës qytetare. Krahas dhomave të qëndrimit dhe fjetjes, hamamxhiku dhe votra ruajnë gjurmë të organizimit tradicional të jetës familjare. Me kalimin e kohës, ndërtesa ka pësuar ndryshime në fasada, veçanërisht në dyer e dritare, ndërsa kulmi dhe dritaret kanë kërkuar mirëmbajtje të vazhdueshme.[42]



Figura 13 12 Pamje e pjesës së intervenuar të Kullës së Currit (burimi : QRTK- Gjakovë)

[37] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material përshkrues për Kullën e Currit
[38] TV Syri Vision, "Kulla e Currit, një monument i gjallë i historisë kombëtare," Mars, 2025
[39] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material përshkrues për Kullën e Currit
[40] TV Syri Vision, "Kulla e Currit, një monument i gjallë i historisë kombëtare," Mars 2025
[41] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material përshkrues për Kullën e Currit
[42] Po aty

Ruajtja e Kullës së Currit ka rëndësi për arkitekturën dhe punimet e saj artizanale, për historinë familjare që mbart dhe për rolin në tërësinë historike të lagjes. Këto vlera krijojnë mundësi edhe për një interpretim muzeal të historisë së saj, duke respektuar karakterin e kullës dhe vazhdimësinë e përdorimit familjar.



Figura 14 Pamje të përpunimeve të enterierit të Kullës së Currit (Burimi: QRTK- Gjakovë)

Kulla e Koshit / Hysni Koshit, Gjakovë



Figura 15 Kulla e Hysni Koshit, pamja ballore (Burimi DTTK- Kulla e Hysni Koshit)

Në hyrje të Çarshisë së Madhe të Gjakovës, vëllimi trekatësh prej guri i Kullës së Hysni Koshit dallohet mes dyqaneve dhe ndërtesave tregtare. Pamja e mbyllur dhe karakteri fortifikues sjellin në qendër të qytetit tipare të kullave të Rrafshit të Dukagjinit, duke i shtuar larmi arkitekturës së çarshisë. E datuar më 1870, ajo ndodhet pranë Teqesë së Sheh Ruzhdisë dhe kullave të Sylejman Vokshit e Avdullah Pashë Drenit, brenda një mjedisi me rëndësi historike.[43] Fillimisht e lidhur me agët e Batushës, kulla më vonë u ble nga familja Koshi, e cila e trashëgoi dhe u kujdes për ruajtjen e saj.[44]

Muratura është ndërtuar me gurë natyrorë të përmasave të ndryshme, pak të punuar, ndërsa qoshet, hyrja dhe kornizat e dritareve theksohen nga gurët e latuar. [45] Dritaret gjysmëharkore të katit të sipërm dallojnë nga hapjet katërkëndëshe të përdhesës dhe katit të parë, duke i dhënë fasadës një ritëm të veçantë.[46] Në brendësi, dekorimet prej druri dhe organizimi me magazina, qilarë e odë mysafirësh ndërthurnin nevojat ekonomike të familjes me banimin dhe mikpritjen.[47]

Me kalimin e kohës, kulla ka pësuar ndryshime kryesisht në brendësi, ndërsa pamja e jashtme është transformuar më pak. [48] Përpjekjeve familjare për mirëmbajtje iu shtua përshtatja e përdhesës në restorant dhe galeri, duke krijuar hapësirë për gastronominë vendore dhe veprat e artistëve gjakovarë. Megjithatë, nevojat për përforcimin dhe pastrimin e muraturës, përmirësimin e ndërhyrjeve të mëparshme dhe riparimin e shkallëve dëshmojnë se përdorimi i ri duhet të shoqërohet me kujdes të vazhdueshëm konservues.[49]



Figura 16 Fotografi e vjetër e kullës së Hysni Koshit, detaje të përpunimit të dyshekllëkut (burimi: DTKK)

[43] Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, "Kulla e Hysni Koshit"
[44] Artan Krasniqi, *Monumentet*, vëll. V, reportazh për Kullën e Koshit
[45] Fejaz Drançolli, "*Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998/99*"
[46] Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, "Kulla e Hysni Koshit"
[47] Fejaz Drançolli, "*Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998/99*"
[48] Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës,
[49] Artan Krasniqi, *Monumentet*, vëll. V, reportazh për Kullën e Koshit

Vlera e ruajtjes së Kullës së Hysni Koshit qëndron te prania e veçantë e një shtëpie të fortifikuar brenda çarshisë, mjeshtëria e punimit të gurit dhe historia familjare që mbart. Ajo ruan një shtresë të rëndësishme të identitetit të Gjakovës, ku banimi, tregtia dhe mikpritja kanë bashkëjetuar në të njëjtin mjedis urban.



Figura 17 Pamje të kullës së Koshit nga rruga (burimi: QRTK- Gjakovë)

Kulla e Xheladin/Astrit Kryeziut, Gjakovë



Figura 18 Pamje e kullës gjatë restaurimit (Burimi: Ministria e Kulturës dhe Turizmit, Nentor 2025)

Në zonën e njohur si Fusha e Sahatit pranë Çarshisë së Madhe, Kulla e Xheladin Bej Kryeziut dallohet për tullat e kuqe dhe dy çardakët e mbyllur që dalin nga vëllimi i saj. E ndërtuar rreth vitit 1890, sipas kujtesës familjare, ajo ruan gjurmët e banimit të familjes Kryeziu dhe të një mjedisi historik që është ndryshuar nga ndërtimet e reja.[50]

Ndërtesa zhvillohet në tri nivele, me pjesën e poshtme prej guri dhe dy katet e sipërme prej tullash të pjekura. Muret arrijnë trashësi deri në 80 centimetra, ndërsa dritaret e shumta, të radhitura në mënyrë simetrike dhe të përfunduara me gjysmëhark, i japin fasadës një ritëm të rregullt. Portat e harkuara, streha e shkurtër dhe çardakët e mbyllur plotësojnë karakterin e saj përfaqësues si banesë qytetare.[51]

Pas fasadave ruhen punime të pasura prej druri: shkallë me parmakë dekorativë, tavane me rozeta, dyer të gdhendura me motive gjeometrike dhe dollapë të integruar në mure.

Korridoret e gjera dhe çardaku shërbejnë edhe si hapësira qëndrimi, ndërsa dhoma e pritjes me minderë në tri anë na tregon rëndësinë e mikpritjes në jetën familjare. Oborri dhe bunari kishin lidhje edhe me përditshmërinë e lagjes, duke pritur lojërat e fëmijëve dhe zejtarët e çarshisë që vinin për t'u furnizuar me ujë. Krahas banimit, një pjesë e ndërtesës shërbeu si postë gjatë viteve 40-ta dhe, për një periudhë, si mësonjëtore.[52]

Një ndërhyrje emergjente në kulm ndihmoi në ruajtjen e ndërtesës dhe të hollësive të saj arkitektonike. Megjithatë, shqetësimi kryesor lidhet me ngjeshjen e rrethinës dhe pasigurinë e qasjes, e cila kalonte përmes një parcele private. Ruajtja e kullës kërkon kështu kujdes edhe për oborrin, hyrjet dhe marrëdhënien e saj me çarshinë. Arkitektura, enterieri i pasur dhe kujtesa familjare e bëjnë atë një dëshmi të rëndësishme të kulturës së banimit dhe historisë qytetare të Gjakovës.[53]



Figura 19 Pamje e kullës gjatë restaurimit (Burimi: Ministria e Kulturës dhe Turizmit, Nentor 2025)

[50] Artan Krasniqi, *Monumentet*, vëll. V, "Kulla e Xheladin Bej Kryeziut - Shtëpia bërthamë e namit të Kryezinjve të Gjakovës"
[51] Po aty
[52] Po aty
[53] Po aty

Kulla e Shahin Dulës, Gjakovë

Kulla e Shahin Dulës dallohet për fasadat prej tullash të kuqe dhe dyshekllëkun e vogël të orientuar nga rruga në lagjën e Kusarëve. Afërsia me Parkun dhe Xhaminë e Kusarëve e lidh me jetën dhe trashëgiminë e lagjes, ndërsa hapësira e lirë në tri anë e bën praninë e saj të dukshme në mjedisin përreth. E ndërtuar në shekullin XIX, ajo i përket kullave qytetare të shtresës së pasur të kohës. Sipas kujtesës së banorëve, kulla u dogj në fund të atij shekulli dhe më pas u rindërtua nga Murteza Dula.[54]

Ndërtesa zhvillohet në përdhesë dhe kat, me themele prej guri, mure prej tullash të pjekura dhe kulm me konstruksion druri, të mbuluar me qeramidhe tradicionale. Hyrja përmes oborrit te shpie në hapësirat e jetës së përditshme në përdhesë, ndërsa kati përmban dhomën e mysafirëve dhe dhomën e gjumit. Dyshekllëku prej tullash në fasadën jugore i jep ndërtesës një theks karakteristik. Në brendësi, tavani dekorativ i dhomës së mysafirëve, dollapët, raftet dhe shkallët origjinale prej druri ruajnë mjeshtërinë e punimit dhe karakterin tradicional të kullës.[55]

Një veçori e kullës është marrëdhënia me dy rrugët që e kufizojnë. Hyrja nga oborri dhe dyshekllëku i orientuar drejt udhëkryqit krijojnë dy lidhje të ndryshme me hapësirën përreth, qasjen në kullë përmes oborrit dhe vështrimin nga kati drejt jetës së lagjes. Përmasat e vogla dhe realizimi me tulla të pjekura e bëjnë dyshekllëkun një shprehje të përmbajtur të këtij elementi tradicional në mjedisin qytetar.

Ndërhyrjet ndër vite kanë ndryshuar sidomos fasadën veriore, ku dritaret gjysmëharkore janë zëvendësuar me hapje drejtkëndëshe. Hapja e dritareve të tjera në fasadat jugore dhe lindore ka ndryshuar gjithashtu kompozimin e jashtëm. Megjithatë, kulla ka ruajtur funksionin e banimit, ndërsa përshtatja e një pjese në bujtinë e ka hapur atë edhe për vizitorët. Vlera e ruajtjes së saj qëndron te elementet origjinale arkitektonike, pasuria e punimeve të drurit dhe vazhdimësia e jetës brenda një kulle historike të Gjakovës.[56]



Figura 21 Kulla e Shahin Dulës në lagjën e Kusarëve (Burimi: QRTK-Gjakovë)



Figura 20 Kulla e Shahin Dulës në lagjën e Kusarëve (Burimi: QRTK-Gjakovë)

[54] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material përshkrues për Kullën e Shahin Dulës, 20 tetor 2023.

[55] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material përshkrues për Kullën e Shahin Dulës, 20 tetor 2023

[56] Po aty

Kulla e Hysen Hajdarit, Nivokaz



Figura 22 Pamje e kullës Hysen Hajdari gjatë restaurimit (burimi: CHwB)

Në Nivokaz, dikur i njohur për kullat e tij tradicionale, Kulla e Hysen Hajdarit është një nga dëshmitë e pakta të trashëgimisë arkitekturore që kanë mbijetuar pas shkatërrimeve të mëdha të luftës së fundit në Kosovë. Mes humbjes së dhjetëra kullave, mbijetesa e saj ruan një pjesë të identitetit arkitektonik dhe kujtesës së fshatit. Mendohet të jetë ndërtuar në fillim të shekullit XIX dhe i përket tipologjisë së kullave me dyshekllëk prej guri.[57]

Kulla shërbeu për banim deri më 1999, kur familja u zhvendos në një shtëpi të re brenda oborrit. Mbetja pa banorë dhe pa përkujdesje u pasua nga degradimi i ndërtesës, me çarje në fasada, dëmtime të fugave dhe të konstruksionit të kulmit, si dhe prani të vegjetacionit e kolonizimit biologjik.[58]

Ndërhyrjet konservuese përfshinë pastrimin e ndërtesës dhe rrethinës, trajtimin e çarjeve me llaç gëlqeror dhe riparimin e fugave. Në kulm u ruajtën trarët e padëmtuar, ndërsa pjesët e degraduara u plotësuan me elemente të reja prej druri të ngjashme me ekzistueset. Hidroizolimi dhe mbulesa e re me tjegulla synuan mbrojtjen e ndërtesës nga depërtimi i ujit.[59]

Vlera e ruajtjes së kullës lidhet me tipologjinë e saj dhe me rrallësinë e kullave të mbijetuara në Nivokaz. Ajo dëshmon mënyrën tradicionale të banimit dhe marrëdhënien e familjes me oborrin, duke mbajtur të lexueshme një pjesë të historisë së fshatit që shkatërrimet e luftës e kanë zbehur ndjeshëm.



Figura 23 Pamje e kullës Hysen Hajdari (burimi: CHwB)

[57] Cultural Heritage without Borders Kosova, "Përfundojnë punimet në dy monumente të Komunës së Gjakovës"

[58] Po aty

[59] Po aty

Kulla e Adem Ademajt



Figura 24 Pamje e kullës Adem Ademajt dhe shkallët që të shpiejn ne odën e burrave (Burimi: QRTK- Gjakove)

Kulla e Adem Ademajt gjendet në terrenin e pjerrët të Zylfajt, pranë kufirit me Shqipërinë, ka një pamje të hapur drejt rrethinës. Muret prej guri, streha e drurit dhe dyshekllëku i dekoruar i japin një karakter ku ndërthuren masiviteti i kullës dhe hollësitë e shtëpisë tradicionale. E ndërtuar në shekullin XIX, ajo u dëmtua disa herë gjatë Luftërave Ballkanike dhe u rindërtua, duke ruajtur funksionin e banimit. [60] Ndërtimi i saj u atribuohet mjeshtërve dibranë, ndërsa kujtimi i bashkëjetesës së 50-60 anëtarëve të familjes gjatë viteve 1960 dëshmon përmasën e jetës familjare që zhvillohej brenda saj.[61]

Kulla ka plan drejtkëndësh me përmasa rreth 14 × 10 metra dhe zhvillohet në përdhesë e kat. Përdhesa si në shumicën e rasteve përmbante ahurin dhe qilarët, ndërsa shkallët e jashtme siguronin lidhjen e drejtpërdrejtë me odën e burrave. Divanhanja dhe korridori e plotësonin organizimin e katit, ku pritja dhe nevojat e përditshme bashkëjetonin brenda së njëjtës shtëpi.[62]

Muratura përbëhet nga gurë të çrregullt, ndërsa qoshet dhe kornizat e dyerve e dritareve janë punuar me gurë të latuar. Hapjet përfundojnë me hark, kurse konstruksionet ndërkatëshe dhe të kulmit janë realizuar me trarë prej druri të bungut. Mbulesa me qeramidhe tradicionale përfundon me një strehë druri, element dallues i kësaj kulle. Dyshekllëku anësor, rreth tre metra i gjatë, tavani dekorativ i odës dhe dera e bungut me shulin karakteristik ruajnë mjeshtërinë e punimit të drurit.[63]



Figura 25 Pushimorja e kullës e mbyllur me tulla të pjekura (burimi: QRTK-Gjakovë)

[60] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material përshkrues për kullën në Zylfaj, 2002-2024
[61] Klan Kosova, video për Kullën e Adem Ademajt në Zylfaj, Prill 2021; "Kulla 200 vjeçare në Zylfaj të Gjakovës kërkon dorën e shtetit"
[62] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material përshkrues për kullën në Zylfaj, 2002-2024
[63] Po aty

Ndryshimi më i dukshëm është zëvendësimi i shkallëve origjinale prej druri me shkallë betonarmeje dhe mbyllja e pushimores me tulla të pjekura. Prania e mbeturinave dhe barishteve përgjatë njërës anë tregon nevojën për mirëmbajtjen e rrethinës. Ruajtja e kullës ka rëndësi për ndërthurjen e teknikave tradicionale, elementet dekorative dhe historinë e banimit të një familjeje të madhe, që e bën ndërtesën dëshmi të organizimit shoqëror të zonës.[64]



Figura 26 Pamje e dyshekllëkut (Burimi: QRTK- Gjakovë)



Figura 27 Detaje nga dritaret harkore të kullës (Burimi: QRTK- Gjakovë)

[64] Po aty

Kulla e Brahim Metës, Botushë



Figura 28 Pamje e kullës së Brahim Metës nga rruga (Burimi: QRTK- Gjakovë)

Në mes të fshatit Botushë, Kulla e Brahim Metës ruan lidhjen ndërmjet kullës së fortifikuar dhe ekonomisë familjare. Oborri, muri rrethues prej guri dhe hambari i drithërave prej druri formojnë mjedisin e saj tradicional. Kulla është ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XIX, e cila shërbeu fillimisht për banim dhe mbrojtje, ndërsa për një periudhë u përdor për ruajtjen e ushqimit të kafshëve dhe pajisjeve bujqësore.[65]

Objekti zhvillohet në përdhesë dhe dy kate, të lidhura me shkallë të brendshme prej druri. Në katin e parë organizohen dhomat e qëndrimit ditor dhe fjetjes, ndërsa niveli i sipërm përmban odën e burrave, hajatin me dyshekllëk dhe nyjat sanitare. Një derë në kat, e orientuar nga oborri, sugjeron praninë e dikurshme të shkallëve të jashtme, të cilat nuk ruhen më. Oda e burrave përbën një nga hapësirat më të çmuara të kullës, me tavanin dekorativ, votrat, raftet dhe qilimat e vjetër që dëshmojnë traditën e pritjes dhe kujdesin për brendësinë e kullës.[66]

Themelet dhe muret janë ndërtuar me gurë të përmasave të ndryshme, me trashësi të mureve të jashtme deri në 70 centimetra. Gurët e latuar me nuancë të kuqërremtë theksojnë qoshet, strehën dhe kornizat e dritareve, duke krijuar dallim me muraturën e zakonshme në ngjyrë hiri. Ky trajtim i jep fasadës një shprehje të veçantë, ku masiviteti ndërthuret me përpunimin e kujdesshëm të detajeve.[67]

Ndërhyrjet e CHwB-së dhe të pronarit kanë kontribuar në ruajtjen e kullës, ndërsa mbulesat e reja pranë hyrjes dhe murit rrethues kanë ndryshuar pjesërisht marrëdhënien me oborrin dhe rrugën. Vlera e saj qëndron te arkitektura prej guri, ruajtja e odës me elementet tradicionale dhe tërësia që krijon me hambarin e oborrin, si dëshmi e mënyrës së banimit dhe jetës rurale të Botushës.[68]



Figura 29 Pamje e kullës së Brahim Metës nga oborri i brendshëm (Burimi: QRTK- Gjakovë)

[65] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, "Kulla e Brahim Metës", 2002-2024
[66] Po aty
[67] Po aty
[68] Po aty



Figura 30 Pamje e kullës së Brahim Metës nga oborri (Burimi: QRTK- Gjakovë)



Figura 31 Pamje e odës së burrave të kullës së Brahim Metës (Burimi: QRTK- Gjakovë)

Kulla e Ethem Godenit, Rogovë



Figura 32 Përpunimi me gurë të latuar të kullës së Ethem Godenit (burimi: QRTK- Gjakovë)

Në qendër të Rogovës së Hasit, Kulla e Ethem Godenit tërheq vëmendjen me gurët e latuar, portën e zbukuruar dhe vargun e hapjeve të vogla harkore të dyshekllëkut. E ndërtuar në shekullin XIX, ajo shërbeu për banim dhe mbrojtje, ndërsa në kujtesën e banorëve ruhet edhe si vend kuvendesh dhe strehimi për udhëtarët. Një rrëfim vendor përmend përdorimin e një pasqyre si shenjë mikpritjeje, për t'u treguar kalimtarëve se aty mund të gjenin ushqim dhe strehë.[69]

Kulla zhvillohet në përdhesë dhe kat. Përdhesa ishte e dedikuar për kafshët dhe ushqimin e tyre, ndërsa shkallët prej druri çonin në katin e banimit, ku oda e burrave zinte vendin qendror. Themelet dhe muret janë prej guri, kurse konstruksionet ndërkatëshe dhe të kulmit prej druri të bungut, me dysheme dërrasash dhe mbulesë me qeramidhe tradicionale. Dy fasadat nga rruga dallohen për gurët masivë të latuar në nuancë hiri të çelët, ndërsa pjesët e tjera janë punuar me gurë lumi.[70]

Dyshekllëku shtrihet përgjatë fasadës kryesore dhe vazhdon në gjysmën e fasadës anësore, me njëmbëdhjetë hapje të vogla harkore nga rruga dhe pesë anash. Porta kryesore theksohet nga harku i dekoruar dhe pllaka me mbishkrim në osmanishte. Në brendësi, votra, dhe raftet plotësohen nga tavani i punuar me dorë, realizimi i të cilit, sipas pronarit, i kishte marrë mjeshtrit rreth katër muaj. Një veçori tjetër janë elementet e quajtura "thjerrëza" në mure, të lidhura në përshkrimin e kullës me përcaktimin e kohës përmes rrezeve të diellit.[71]

Vlera e kullës qëndron te mjeshtëria e gurit dhe drurit, organizimi tradicional i banimit dhe kujtesa e mikpritjes e kuvendeve, të cilat e lidhin ndërtesën me historinë shoqërore të Rogovës.



Figura 33 Detaje të dyerve të kullës së Ethem Goden-it (burimi: QRTK-Gjakove)

[69] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, "Kulla e Ethem Godenit", 2002-2024, TV Syri Vision, "Kulla e Ethem Godenit në fshatin Rogovë do të renovohet këtë vit nga MKRS", janar 2022.

[70] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, "Kulla e Ethem Godenit", 2002-2024

[71] Po aty

Kulla e Isa Zymber Binakajt, Devë



Figura 34 Pamje e kullës së Isa Zymber Binakaj", (Burimi: QRTK-Gjakove)

Kulla e Isa Zymber Binakajt në afërsi Kullës së Ahmet Asllanit, gjendet në fshatin Devë, e cila dallohet për numrin e vogël të hapjeve, dhe muraturë guri të theksuar nga fugat e trasha të llaçit. Kulla u ndërtua në fund të shekullit XIX për banim, ajo është një variant më i thjeshtë i kullës, ku karakteri arkitektonik shprehet kryesisht përmes materialeve dhe teknikës së ndërtimit.[72]

Objekti ka plan drejtkëndësh dhe zhvillohet në përdhesë e kat. Muret janë punuar me gurë të madhësive dhe formave të ndryshme, të lidhur me llaç gëlqeror, ndërsa qoshet theksohen nga gurët e latuar me nuanca të ndryshme. Konstruksioni ndërkatësh përbëhet nga trarë masivë druri dhe dysheme dërrasash, edhe kulmi ka konstruksion druri, të mbuluar me qeramidhe tradicionale. Numri i kufizuar i hapjeve përforcon pamjen e mbyllur të ndërtesës, ndërsa përpunimi dekorativ mbetet modest.[73]

Ndërhyrjet e mëvonshme përfshijnë shkallët prej betonarmeje për ngjitjen në kat. Dy ndërtime të reja, të bashkëngjitura në fasadat anësore, kanë ndryshuar marrëdhënien e kullës me rrethinën dhe kanë kufizuar dukshmërinë e saj. Vlera e ruajtjes qëndron te dëshmia e një forme më të thjeshtë të banimit tradicional dhe te teknikat e muraturës së gurit, që plotësojnë larminë arkitektonike të kullave të zonës.[74]



Figura 35 Detaje të përpunimit të muraturës prej gurit të kullës së Isa Zymber Binakaj", (Burimi: QRTK Gjakove)

[72] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, "Kulla e Isa Zymber Binakaj", 2002-2024

[73] Po aty

[74] Po aty

Kulla e Kaqel Ramës, Gërçinë



Figura 36 Pamje e Kullës e Kaqel Ramës,(Burimi: QRTK - Gjakovë, 2024)

Kulla e Kaqel Ramës gjendet në një terren të pjerrët në fshatin Gërqin. Ajo është e rrethuar nga gjelbërimi dhe me hapësirë të lirë në të gjitha anët. Kulla e ruan lidhjen me peizazhin rural dhe ekonominë familjare. Koshi i vjetër i misrit në anën jugore plotëson këtë mjedis tradicional. E ndërtuar më 1933 nga mjeshtër dibranë, kulla dëshmon vazhdimësinë e kësaj forme banimi në shekullin XX. Krahas strehimit të familjes dhe bagëtive, ajo njihet si vend tubimi i parisë së fshatit, veçanërisht gjatë periudhës së faljes së gjaqeve.[75]

Objekti zhvillohet në përdhesë e kat, mbi një plan drejtkëndësh. Muratura prej guri plotësohet nga qoshet, kornizat e dyerve e dritareve dhe streha e dalë, të punuara me gurë të latuar. Konstruksionet ndërkatëshe dhe të kulmit janë prej druri të bungut, ndërsa mbulesa është me qeramidhe tradicionale. Dy hyrje të veçanta në përdhesë pasqyrojnë ndarjen e përdorimit, hapja drejtkëndëshe në fasadën ballore shërbente për bagëtitë, ndërsa dera harkore në fasadën anësore përdorej nga banorët.[76]

Karakterin e kullës e theksojnë katër oxhaqet prej guri dhe larmia e dritareve katrore, drejtkëndëshe e harkore. Në katin e sipërm, dyshekllëku prej gurësh të mëdhenj të latuar përmban një rend me tetë dritare të vogla harkore. Ai qëndron në të njëjtin rrafsh me murin, duke u dalluar për përpunimin e gurit dhe ritmin e hapjeve.[77]

Vlera e ruajtjes së kullës lidhet me mjeshtërinë ndërtimore dibrane, elementet karakteristike prej guri dhe rolin e saj në jetën shoqërore të Gërqinit. Kujtesa e tubimeve për faljen e gjaqeve i shton kullës një domethënie të veçantë si hapësirë dialogu dhe pajtimi.[78]



Figura 37 Pamje e Kullës e Kaqel Ramës,(Burimi: QRTK - Gjakovë, 2024)

[75] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, "Kulla e Kaqel Ramës", 2002-2024
[76] Po aty
[77] Po aty
[78] Po aty

Kulla e Drane Bojaxhiut, Novosellë e Epërme



Figura 38 Pamja e kullës pas restaurimit (burimi: QRTK- Gjakove)

Në qendër të Novosellës së Epërme, pranë kishës katolike, kulla e njohur me emrin e Drane Bojaxhiut ruan gjurmë të banimit, mikpritjes dhe jetës shoqërore të fshatit. Memoria familjare e lidh me nënën e Nënë Terezës, megjithëse hollësitë e kësaj lidhjeje dhe vendlindja e Dranes mbeten të pasqaruara plotësisht.[79] Familjarët i japin ndërtesës një moshë rreth 150-200-vjeçare dhe tregojnë se familja Belaj e bleu rreth viteve 1909-1910, duke e banuar deri më 1993.[80]

Kulla është ndërtuar me gurë natyrorë, me qoshe të latuara dhe breza horizontalë druri që përforcojnë muraturën. Hyrja harkore çon në hapësirat e përdhesës, ndërsa shkallët prej druri lidhin katin me divanhanen dhe odën e burrave. Tavani me dërrasa të profiluara, dollapët, oxhaku i odës dhe dyshekllëku prej guri tregojnë përpunimin tradicional të enterierit.[81] Në rrëfimin familjar, lartësia e ulët e hyrjes si në shumë kulla të tjera merr edhe një kuptim simbolik, përkulja e mysafirit gjatë hyrjes shihet si shenjë respekti ndaj familjes pritëse.[82]

Me kullën lidhet edhe kujtimi i një shkolle shqipe të hapur më 1909 nga paraardhësi i familjes Belaj, Mark Adip Prilepi. Sipas këtij rrëfimi, mësimi vazhdoi rreth tre muaj, përpara se shkolla të mbyllej nga autoritetet osmane dhe përfaqësuesit vendorë. Kjo histori



Figura 39 Pamja e kullës para restaurimit (burimi: QRTK- Gjakove)

[79] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material për Kullën e "Drane Bojaxhiut", Novosellë e Epërme, 2002-2024

[80] Klan Kosova, "Kulla e Drane Bojaxhiu - gruaja që lindi Nënë Terezën, Novosellë e Epërme - Gjakovë", reportazh, janar 2026

[81] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material për Kullën e "Drane Bojaxhiut", Novosellë e Epërme, 2002-2024

[82] Klan Kosova, "Kulla e Drane Bojaxhiu - gruaja që lindi Nënë Terezën, Novosellë e Epërme - Gjakovë", reportazh, janar 2026

e përcjellë ndër breza i shton kullës një dimension arsimor, krahas funksionit familjar dhe shoqëror.[83]

Dëmtimet nga bora më 2012 u pasuan nga restaurimi, ndërsa më vonë ka pasur ndërhyrje gjatë viteve 2021-2023 me përfshirjen e UNDP-së dhe CHwB-së.[84] Përkujdesja e familjes vazhdon përmes mbledhjes së objekteve të vjetra, ruajtjes së veshjeve tradicionale dhe pritjes së vizitorëve. Këto veprimtari krijojnë bazën për përdorimin muzeal të kullës, ku arkitektura dhe gjerat e jetës së përditshme mund të përcjellin së bashku historinë e komunitetit.[85]



Figura 40 Pamje e brendshme e kullës në përdhesë (burimi: QRTK- Gjakove)

[83] Po aty

[84] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material për Kullën e "Drane Bojaxhiut", Novosellë e Epërme, 2002-2024, Klan Kosova, "Kulla e Drane Bojaxhiu - gruaja që lindi Nënë Terezën, Novosellë e Epërme - Gjakovë", reportazh, janar 2026

[85] Klan Kosova, "Kulla e Drane Bojaxhiu - gruaja që lindi Nënë Terezën, Novosellë e Epërme - Gjakovë", reportazh, janar 2026

Kulla e Osman Bajramit, Firajë



Figura 41 Detaji i hapjeve të dyshekllëkut të kullës (burimi: QRTK- Gjakovë)



Figura 43 Pamja ballore e kullës (burimi: QRTK- Gjakovë)



Figura 42 Pamje e pjesës së dëmtuar të kullës (burimi QRTK- Gjakovë)

Në fshatin Firajë, Kulla e Osman Bajramit dallohet për vëllimin trekatësh dhe muraturën me gurë të nuancës së errët. E vetmja kullë e evidentuar në këtë fshat, ajo ruan gjurmët e një shtëpie ku jeta familjare ndërthurej me nevojën për mbrojtje. U ndërtua në shekullin XIX dhe, falë pozitës strategjike, shërbeu si strehë për pjesëtarë të Lëvizjes Kaçake, ndër ta Zef Gjidoda dhe Ukë Sadiku, e më vonë si bazë partizane gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.[86]

Kulla ka përmasa mesatare dhe është e organizuar në përdhesë e dy kate. Përdhesa përmbante ahurin dhe një hapësirë për ushqimin e bagëtive, ndërsa kati i parë u kushtohej dhomave të banimit. Në nivelin e sipërm, oda e burrave zinte vendin qendror, me votrën përballë hyrjes, dhe divanhanen në parahyrje. Shkallët e brendshme prej druri lidhnin nivelet, duke ruajtur ndarjen ndërmjet funksioneve ekonomike, jetës familjare dhe pritjes së mysafirëve. Hambari i vjetër i misrit, i bashkëngjitur kullës, plotëson këtë organizim tradicional.[87]

Konstruksionet ndërkatëshe janë prej trarësh masivë druri dhe dyshemeje me dërrasa, ndërsa ndarjet e brendshme janë të lehta për të zvogëluar ngarkesën. Muratura e errët i jep kullës identitet të veçantë, kurse organizimi i brendshëm pasqyron nevojat familjare dhe traditën e mikpritjes. Ndërhyrja e pronarit në kulm më 2009 ishte një përpjekje për mirëmbajtjen e saj, por dëmtimet në brendësi dhe në muret e jashtme tregojnë nevojën për konservim të mëtejshëm. Ruajtja e kullës ka rëndësi për historinë e Firajës, për arkitekturën tradicionale dhe për kujtesën e përdorimit të saj si vend strehimi e qëndrese.[88]



Figura 44 Pamje e kullës së Osman Bajramit- Firajë (burmi: QRTK- Gjakovë)

[86] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material për Kullën e Osman Bajramit, 2002-2024

[87] Po aty

[88] Po aty

Kulla e Osman Jakupit, Skivjan



Figura 45 Detaje të përpunimit të dyshekllëkut të kullës së Osman Jakupit (Burmi: QRTK- Gjakove)

Në fshatin Skivjan, Kulla e Osman Jakupit po ashtu dallohet për muraturën e errët prej guri dhe shkallët e jashtme të mbuluara, që i japin hyrjes një karakter të veçantë. Kulla u ndërtua në shekullin XIX për banim dhe fortifikim, ajo shërbeu edhe si vend mbledhjeje i parisë së fshatit.[89]

Objekti zhvillohet në përdhesë dhe dy kate, sipas tipologjisë së kullave të Rrafshit të Dukagjinit. Muret janë punuar me gurë të çrregullt, ndërsa qoshet, kornizat e hapjeve dhe dyshekllëku dallohen për gurët e latuar. Përdhesa përmbante ahurin, me derë prej druri të bungut, dhe hapje të vogla. Shkallët e jashtme prej guri, të kufizuara me muraturë dhe të mbuluara me kulm të pjerrët, siguronin ngjitjen në nivelin e banimit.[90]

Dhomat e gjumit si në shumicën e kullave edhe këtu janë të organizuara në katin e parë, ndërsa shkallët e brendshme prej druri të shpiejnë në nivelin e sipërm, ku ndodhen oda e burrave, divanhanja dhe dyshekllëku prej guri. Oxhaku i përpunuar dhe tavani dekorativ i odës tregojnë kujdesin për hapësirën e pritjes. Konstruksionet ndërkatëshe janë prej trarësh druri, ndërsa kulmi është rindërtuar me dru bredhi dhe mbuluar me tjegulla të tipit mediteran.[91]

Kulla e ka humbur funksionin e banimit dhe përdoret për depozitimin e ushqimit të kafshëve. Një kullë dykatëshe dhe një garazh i mëvonshëm, të bashkëngjitur në dy fasada, kanë ndryshuar marrëdhënien e saj me rrethinën. Megjithatë, dera origjinale e ahurit, disa dritare, tavani i odës dhe veglat e vjetra bujqësore prej druri ruajnë dëshmi të jetës së dikurshme. Bashkë me shkallët karakteristike dhe historinë e kullës, këto elemente përbëjnë arsyet kryesore për ruajtjen e saj.[92]



Figura 46 Pamje të kullës së Osman Jakupit(burimi: QRTK- Gjakove)

[89] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material për Kullën e Osman Jakupit, 2002-2024
[90] Po aty
[91] Po aty
[92] Po aty

Kulla e Sahit Avdylit, Dujakë



Figura 47 Detaje të hapjeve të kullës së Sahit Avdylit (Burimi: QRTK- Gjakovë)

Kulla e Sahit Avdylit gjendet në rrugën kryesore të fshatit Dujak. Me pamjen e saj impozante ajo dallohet për vëllimin trekatësh, strehën prej gurësh të profilizuar dhe radhët e dritareve të vogla të dyshekllëkut. Kulla u ndërtua në shekullin XIX, dhe shërbeu për banim dhe si vend ku paria e fshatit mblidhej për të diskutuar çështjet e komunitetit. Historia e saj lidhet edhe me pronarin Sahit Avdyli, i cili mori pjesë si vullnetar në luftën kundër Malit të Zi dhe ra më 1912.[93]

Organizimi i kullës pasqyron ndarjen ndërmjet ekonomisë familjare, banimit dhe mikpritjes. Përdhesa përmbante ahurin dhe ushqimin e bagëtive, ndërsa kati i parë u kushtohej banorëve dhe lidhej me përdhesën përmes shkallëve të brendshme prej druri. Në katin e sipërm ndodheshin oda e burrave dhe divanhanja. Mysafirët ngjiteshin përmes shkallëve të jashtme prej druri, duke hyrë drejtpërdrejt në hapësirat e pritjes dhe duke ruajtur privatësinë e familjes.[94]

Konstruksionet ndërkatëshe janë realizuar me trarë masivë druri dhe dysheme dërrasash, ndërsa kulmi prej druri të bungut mbulohet me qeramidhe tradicionale. Dyshekllëku qëndron në të njëjtin rrafsh me muraturën dhe theksohet nga gjashtë dritare të vogla në secilin prej dy mureve të tij. Në brendësi, tavanet dekorative, dollapët e integruar, shkallët, dyert dhe votra ruajnë karakterin tradicional të kullës. Dy bajoneta të Luftërave Ballkanike i shtojnë enterierit edhe një dëshmi materiale të kujtesës historike.[95]

Kulla është relativisht e ruajtur, me portalin e mbuluar të oborrit në njërën anë dhe një objekt të ri ndihmës në tjetrën. Vlera e saj qëndron te organizimi i qartë i hapësirave, mjeshtëria e punimeve të drurit dhe roli i odës në jetën shoqërore të Dujakës. Ruajtja e këtyre elementeve mban të lexueshme lidhjen ndërmjet shtëpise, mikpritjes dhe traditës së pleqnarësisë.[96]



Figura 48 Pamje nga rruga të kullës së Sahit Avdylit (Burimi: QRTK- Gjakovë)

[93] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material për Kullën e Sahit Avdylit, 2002-2024
[94] Po aty
[95] Po aty
[96] Po aty

Kulla e Sylë (Arif) Aliajt, Palabardhë



Figura 49 Kulla e Sylë Aliajt (Burimi: QRTK- Gjakovë)

Kulla e Sylë (Arif) Aliajt gjendet në qendër të fshatit Palabardhë, e cila ruan një odë ku tradita e pritjes vazhdon përmes ndejave dhe ahengjeve familjare. U ndërtua në shekullin XIX nga Hajdar Metë Aliaj, me pjesëmarrjen e mjeshtërve dibranë dhe vendas, ajo shërbeu për banim dhe mbrojtje. Kujtesa e pronarëve e lidh edhe me strehimin e kaçakëve, ndërsa xhirimi në të i një dokumentari kushtuar Dervish Shaqës dhe Demush Nezirit i shton ndërtesës një lidhje me trashëgiminë rapsodike.[97]

Kulla zhvillohet në përdhesë e kat dhe ka qasje nga oborri me gjelbërim e drurë frutorë. Përdhesa shërbente për bagëtitë dhe ushqimin e tyre, ndërsa shkallët prej druri çonin në odën e burrave, pranë së cilës ndodhen paradhoma dhe nyja sanitare. Votra, kamaret, raftet dhe tavani me dekorime të thjeshta druri krijojnë karakterin e brendshëm të odës, e cila mbetet hapësira më e mirëmbajtur dhe më aktive e kullës.[98]

Themelet dhe muret janë prej guri, ndërsa konstruksionet ndërkatëshe dhe të kulmit prej druri të bungut, të punuar me dorë. Një shtyllë bungu me përmasa 30 × 30 centimetra shërben si mbështetje e konstruksionit ndërkatësh në përdhesë. Kulmi mbulohet me tjegulla të rrafshëta dhe përfundon me një strehë të formuar nga dy rende rrasash guri. Dyshekllëku, i orientuar nga rruga dhe pa dalje nga rrafshi i murit, dallohet nga katër dritare të vogla, harqet e të cilave janë realizuar me tulla të pjekura.

Porta dhe dritaret e dyshekllëkut ruajnë formën origjinale, ndërsa hapjet e tjera janë zgjeruar për të përmirësuar ndriçimin. Anekset e bashkëngjitura në tri anë kufizojnë pamjen e kullës dhe krijojnë probleme gjatë reshjeve. Megjithëse pjesërisht përdoret për depozitimin e ushqimeve dhe pajisjeve bujqësore, vazhdimësia e përdorimit të odës i jep ndërtesës vlerën e një trashëgimie ende të jetuar. [99]Ruajtja e saj lidhet me mjeshtërinë e ndërtimit, elementet origjinale dhe traditat familjare që vazhdojnë brenda saj.



Figura 50 Detaje të derës të kornizuar me gurë të latuar (burimi: QRTK- Gjakovë)

[97] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, Kulla e Sylë (Arif) Aliajt, 2002-2024

[98] Po aty

[99] Po aty

Kulla e Tal Belit / Idriz Hereqit, Kralan



Figura 51 Kulla e Tal Belit / Idriz Hereqit në Kralan, pamja ballore e kullës(Burimi: QRTK Gjakovë)

Në një oborr me drurë dhe gjelbërim në fshatin Kralan, kulla e themeluar nga Tal Beli dhe e trashëguar nga Idriz Hereqi mbart historinë e një shtëpie që shërbeu edhe si vend takimi për komunitetin. Brenda saj zhvilloheshin tubime festive, patriotike dhe mortore, duke e lidhur jetën familjare me atë shoqërore të fshatit. Koha e saktë e ndërtimit mbetet e panjohur, një mbishkrim në gur, që pronari e lidh me datimin e kullës, pret ende leximin dhe interpretimin specialistik.[100]



Figura 52 Detaje të derës me material të drurit (Burimi: QRTK- Gjakovë)

Sipas kujtesës së pronarit, kulla fillimisht kishte tri kate dhe mbulohej me rrasa guri. Pas shkatërrimit gjatë Luftërave Ballkanike, ajo u rindërtua më 1968 në dy nivele, përdhesë dhe kat. Përdhesa shërbente për bagëtitë, ndërsa shkallët prej druri çonin në katin e banimit, ku organizoheshin divanhanja, oda e burrave dhe dy dhoma për fjetje e përgatitje ushqimi. Ndërtimi mbështetej në teknikat tradicionale të punimit të gurit dhe drurit. Themelet dhe muret ishin prej guri, të lidhur me llaç horasan dhe, në disa pjesë, me llaç balte. Trarët ndërkatësh dhe konstruksioni i kulmit ishin prej druri të bungut, ndërsa dyshemetë realizoheshin me dërrasa. Portali me hark prej guri të gdhendur dhe dritaret e vogla me harqe gjysmërrethore i jepnin fasadave një karakter të dallueshëm. Në brendësi, tavani i odës me elemente të thjeshta druri të profiluar plotësonte hapësirën e pritjes.[101]

Mungesa e mirëmbajtjes dhe e ndërhyrjeve konservuese solli dobësim strukturor, dëmtime të brendshme dhe rrënim. Në dokumentimin që shënon ndërhyrjen e MKRS-së më 2024, kulla paraqitet në proces rindërtimi. Vlera e saj qëndron te gjurmët e teknikave tradicionale, mbishkrimet në gur dhe kujtesa e tubimeve që zhvilloheshin aty. Ruajtja e materialit të mbetur dhe dokumentimi i fazave ndërtimore janë thelbësore për të përcjellë këtë histori pa humbur dallimin ndërmjet pjesëve të vjetra dhe rindërtimit.[102]



Figura 53Kulla e Tal Belit / Idriz Hereqit në Kralan, para ndërhyrjes së raportuar më 2024. (Burimi: QRTK Gjakovë)

[100] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, Kulla e Tal Belit / Idriz Hereqit, 2002-2024

[101] Po aty

[102] Po aty

Kulla e Zeqë Ramë Sadrisë, Brovinë



Figura 54Kulla e Zeqë Ramë Sadrisë në Brovinë, pamja e kullës me dyshekllëk në poziten në qendër të fasadës kryesore (Burimi: QRTK Gjakovë)

Kulla e Zeqë Ramë Sadrisë gjendet në fshatin Brovinë e cila dallohet për dyshekllëkun prej guri të kuqërremtë dhe vargun e dhjetë hapjeve të vogla harkore. E ndërtuar në shekullin XIX për banim dhe mbrojtje, ajo ruan kujtesën e një bashkësie të madhe familjare.[103] Në rrëfimin e Ibër Sadrijajt, familja numëronte 74 anëtarë në 1947, ndërsa jeta e kullës lidhej ngushtë me shtëpitë dhe oborret përreth.[104]

Ndërtesa u zhvillua në përdhesë dhe dy kate, me një ndarje të qartë funksionale: ahuri dhe ushqimi i bagëtive në përdhesë, hapësirat familjare në katin e parë dhe pritja e mysafirëve në katin e sipërm. Muret janë punuar me gurë lumi të rrumbullakët, ndërsa qoshet, portali harkor dhe dyshekllëku me gurë të latuar. Konstruksionet ndërkatëshe dhe të kulmit janë prej trarësh masivë druri të bungut, me mbulesë prej qeramidhesh tradicionale. Streha me dalje të dyfishtë prej pllakash guri dhe dyshekllëku i dalë nga rrafshi i fasadës theksojnë përpunimin e jashtëm të kullës.[105]

Në odën e burrave, votra përballë hyrjes dhe dekorimet prej druri në tavan e mure krijojnë hapësirën përfaqësuese të kullës. Këtu mikpritja merrte edhe kuptim shoqëror, sipas kujtimeve të Ibër Sadrijajt, oda shërbente për dasma, pritje mortore dhe pajtime gjaqesh, ku mblidheshin familjarë, miq dhe përfaqësues të komunitetit. Kulla ishte kështu pjesë e një rrjeti marrëdhëniesh që bashkonte familjen me jetën e fshatit. [106]

Oborri në tri anë, muri rrethues prej guri dhe kanali i ujit pranë kullës plotësojnë mjedisin e saj rural.[1] [107] Sipas pronarit kjo kulle ishte e vetmja kullë e mbetur në Brovinë, prej dhjetëra kullave të shkatërruara, ajo merr rëndësi të veçantë si dëshmi e një trashëgimie dikur më të përhapur. Ruajtja e saj lidhet me mjeshtërinë e ndërtimit dhe me kujtesën e bashkëjetesës, mikpritjes dhe pajtimit, në një kohë kur ndryshimi i mënyrës së jetesës e dobëson përdorimin tradicional të kullave.[108]



Figura 55 Detaje te hapjeve të dritareve (burimi: QRTK- Gjakovë

[103] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, Kulla e Zeqë Sadrisë, 2002-2024
[104] TV Syri Vision, "Kulla e Zeqë Ramë Sadrisë e vetmja në fshatin Brovinë", reportazh, shkurt 2023
[105] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, Kulla e Zeqë Sadrisë, 2002-2024
[106] TV Syri Vision, "Kulla e Zeqë Ramë Sadrisë e vetmja në fshatin Brovinë", reportazh, shkurt 2023
[107] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, Kulla e Zeqë Sadrisë, 2002-2024
[108] TV Syri Vision, "Kulla e Zeqë Ramë Sadrisë e vetmja në fshatin Brovinë", reportazh, shkurt 2023

Kulla e Agës, Cërmjan, Gjakovë



Figura 56 Pamje të kullës së Agës në Cërmjan me dyshekllëkun në Përgjatë fasadës kryesore dhe pjesërisht në anën e majtë (Burimi: QRTK- Gjakovë)

Kulla e Agës mbart kujtesën e një ode ku mblidhej paria e zonës për pajtimin e gjaqeve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Kulla gjendet në qendër të fshatit Cërmjan, themeluesi i së cilës ishte, Adem Aga, gjyshi i ish-presidentes, Atifete Jahjaga, që njihej për veprimtarinë në pleqnarësi. Krahas këtij roli shoqëror, kulla ka shërbyer për banim dhe pritje të mysafirëve.[109]

Historia e objektit përfshin zhvendosje dhe rindërtime që kanë ndryshuar trajtën e saj. Fillimisht trekatëshe dhe në një vendndodhje tjetër, sipas pronarit, ajo u zhvendos më 1986 në lokacionin ku gjendet sot. Datimi fillestar mbetet i paqartë ndërmjet shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Gjatë luftës së fundit në Kosovë, kulla u dogj nga policia serbe dhe më pas iu nënshtrua ndërhyrjeve të pronarit.Në formën e saj dykatëshe, përdhesa përmban dhomat e qëndrimit e të fjetjes, kuzhinën dhe banjën, ndërsa kati i kushtohet odës së burrave dhe hajatit me dyshekllëk. Hyrja e banimit bëhet nga oborri, oda arrihet veçmas, përmes shkallëve të jashtme dhe ballkonit. Muratura prej gurësh me nuancë të errët hiri, qoshet e latuara dhe dyshekllëku pa dalje nga rrafshi i murit përcaktojnë pamjen e kullës. Kulmi prej druri të bungut dhe bredhit mbulohet me tjegulla të rrafshëta, ndërsa streha realizohet me mahi druri. Në odën e restauruar, votra, kamaret, dollapët dhe raftet ruajnë organizimin tradicional të hapësirës së pritjes.[110]

Zëvendësimi i konstruksionit ndërkatësh me pllakë betonarmeje, si dhe realizimi me këtë material i shkallëve dhe ballkonit, kanë ndryshuar ndjeshëm strukturën tradicionale. Megjithëse ndërtesa duket në gjendje të mire, ruajtja e saj kërkon kujdes ndaj elementeve të mbetura dhe dallimit ndërmjet pjesëve historike e ndërhyrjeve të mëvonshme. Rëndësia e kullës qëndron veçanërisht te kujtesa e pleqnarësisë dhe pajtimit, që e lidh kullën me historinë shoqërore të Cërmjanit.[111]



Figura 57 Pamje të kullës së Agës Cërmjan (burimi: QRTK- Gjakovë)

[109] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, Kulla e Agës Cërmjan, 2002-2024

[110] Po aty

[111] Po aty

Kulla e Ymer Pogës (Ymer Pogë Latifit), Rogovë e Hasit



Figura 59 Pamje e Kullës nga sipër, pas fazës së parë të restaurimit (Burimi: MKRS, janar 2026)



Figura 58 Pamje nga njëra prej hapjeve të Kullës së Ymer Pogës (Burimi: MKRS)

Në fshatin Rogovë të Hasit, pranë Drinit të Bardhë, Kulla e Ymer Pogës është një nga shembujt më të hershëm të banimit në kullë në Kosovë. Datimi i saj në fund të shekullit XVI lidhet me studimin e Fejaz Drançollit, i cili ia atribuon ndërtimin Hasan Agë Qelit të Demjanit. Ngjashmëritë e materialeve dhe të teknikës së muratimit me Xhaminë e Rogovës, të themeluar më 1580, mbështesin hipotezën e ndërtimit të tyre në të njëjtën periudhë.[112]

Kulla ka planimetri katrore, me përmasa të jashtme rreth 6,35 × 6,35 metra, dhe zhvillohet në përdhesë e dy kate. Përdhesa shërbente si ahur, kati i parë për jetën familjare, ndërsa kati i sipërm për pritjen e mysafirëve. Komunikimi ndërmjet niveleve realizohej me shkallë të brendshme druri. Portali me hark dhe frëngjitë në anët jugore e perëndimore, përfshirë atë mbi hyrje, dëshmojnë ndërthurjen e banimit me nevojën për mbrojtje.[113]

Veçantia kryesore arkitektonike është kupola prej tullash mbi odën e katit të sipërm, e mbuluar nga jashtë me kulm katërujor me rrasa guri. Muratura ndryshon përgjatë lartësisë, dy nivelet e poshtme janë prej guri, ndërsa kati i sipërm ndërthur gurin me rende tullash të vendosura horizontalisht dhe vertikalisht. Ky ndryshim ngre edhe çështjen e fazave të mundshme të ndërtimit. [114] Përdorimi i përkohshëm si xhami mbetet një mundësi historike, pasi që prania e kupolës, më vete, nuk e përcakton funksionin fetar të hapësirës.[115]

Ndërhyrjet e pjesshme të viteve 2009 dhe 2013-2014 përfshinë sanimin e mbulesës së kulmit dhe trajtimin e muraturës së jashtme e të strehës.[116] Në fillim të këtij viti është kryer një faze e parë ndërhyrjesh dhe parashihet vazhdimi i punimeve për funksionalizimin e plotë të kullës.[117]



Figura 60 Kulla në fazën restauruese (Burimi: MKRS, tetor 2026)

[112] Artan Krasniqi, *Monument*, vëll. V, 2018, pjesa mbi Kullën e Ymer Pogës në Rogovë; përfshin interpretimin e Fejaz Drançollit në *Kulla shqiptare*.
[113] Databaza e Trashëgimisë Kulturore, përshkrimi i Kullës së Ymer Pogës, Artan Krasniqi, *Monument*, vëll. V, 2018, pjesa mbi Kullën e Ymer Pogës në Rogovë
[114] Artan Krasniqi, *Monument*, vëll. V, 2018, pjesa mbi Kullën e Ymer Pogës në Rogovë
[115] Databaza e Trashëgimisë Kulturore, përshkrimi i Kullës së Ymer Pogës
[116] Po aty
[117] Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit



Kulla-teqe e familjes Nivokazi, Nivokaz



Figura 61 Kulla e Sadik Nivokazit (Burimi: DTTK- Gjakovë)

Kulla-teqe në Nivokaz ndërthur banimin e familjes së madhe me jetën shpirtërore të tarikatit Halveti. Historia e saj lidhet me bashkëjetesën e 117 anëtarëve të familjes, të paraqitur në dokumentarin "117" të Besim Sahatçiut. Sipas kujtesës së Sheh Mehmet Nivokazit, dy nivelet e poshtme u ndërtuan nga paraardhësit, ndërsa i treti u shtua me zgjerimin e familjes. Në vitin 1915, kur gjyshi i tij, Islami, mori detyrën e shehut, kulla fitoi edhe funksionin e teqesë.[118]

Data e saktë nuk njihej, vlerësimi rreth dyqindvjeçar i përket kujtesës familjare. Sa i përket pjesës funksionale, organizimi vertikal përfshinte nivelin për bagëtitë në perdhesë, katin e banimit në katin e parë dhe hapësirën e burrave në krye në katin e dytë. Me rreth 110 m² sipërfaqe të raportuar, kulla nuk i strehonte e vetme të gjithë anëtarët, kompleksi kishte një aneks guri mbi njëzet metra të gjatë, me korridor e dhoma, dhe një shtëpi zjarri për përgatitjen e ushqimit. Muret rrethuese bashkonin ndërtesat në një tërësi. Sipas dëshmisë së Shehut, gurët e zakonshëm merreshin nga Ereniku, ndërsa gurët e qosheve nga Gryka e Batushës. Qoshet, portat dhe kornizat gjysmëharkore dalloheshin nga guri i kuq i gdhendur.[119]

Përshkrimi i dokumentarit "117" sjell një pamje të jetës së përbashkët, gatimi, ndarja e sofrave, puna bujqësore dhe caktimi i detyrave organizonin ritmin e familjes. Shehu kujton se familja u nda në vitin 1977, ndërsa banimi në kullë vazhdoi deri në vitet 1980. Ndërtesat ndihmëse dhe oda e dikurshme nuk ishin ruajtur në tërësinë e tyre.[120] Gjatë luftës së fundit kulla u dogj pothuajse tërësisht. Familja ruajti gurët dhe rrënojën, duke mundësuar restaurimin më 2010. Rrëfimet për strehimin e Azem Bejtës dhe takimet e figurave kombëtare përcillen vetëm si dëshmi familjare.[121]



Figura 62 Kulla e Sadik Nivokazit (Burimi: DTTK- Gjakovë)

118 Artan Krasniqi, Monument, vëll. V pjesa për kullën-teqe të familjes së Sheh Mehmet Nivokazit
119 Po aty
120 Po aty
121 Artan Krasniqi, Monument, vëll. V pjesa për kullën-teqe të familjes së Sheh Mehmet Nivokazit

Kulla e Isuf Sadikut / Rexhep Shaban Sadikut, Nivokaz



Figura 63 Pamja ballore e kullës së Isuf Sadikut (Burimi: DTKK)

Kulla e Isuf Sadikut, e lidhur me familjen e Rexhep Shaban Sadikut, ruan një pjesë të arkitekturës dhe kujtesës së banimit të Nivokazit. Rrëfimi familjar e ndërlidh emrin e vjetër të monumentit me gjyshin ndërtues, ndërsa kujtesa e luftës sjell në qendër Rexhep Sadikun dhe pasardhësit e tij.[122]

Artan Krasniqi shpjegon se shteti e mbron objektin me emrin Isuf Sadiku, gjyshi i Rexhepit, të cilit familja ia atribuon ndërtimin. Kulla u ndërtua në shekullin XIX, Ganimete Sadiku kujton se familja banoi në kullë deri më 1988 dhe më pas u zhvendos në shtëpinë e re brenda oborrit. Ajo e përshkruan banimin si një periudhë të rëndësishme të jetës familjare, ndonëse uji duhej bartur nga oborri.

Kulla është trekatëshe, me themele e mure prej guri. Muratura kryesore përdor gurë lumi të parregullt, ndërsa qoshet dhe dyshekllëku janë punuar me gurë të latuar. Ndarjet e brendshme janë prej druri me përforcime vertikale, konstruksionet ndërkatëshe përshkruhen me trarë bungu dhe dysheme dërrasash. Përdhesa shërbente për bagëtitë, kati i mesëm për familjen dhe i sipërmi për odën e mysafirëve e dyshekllëkun.[123]

Dy rende pllakash guri formojnë strehën e çatisë. Gjatë punimeve konservuese-restauruese të vitit 2014 mbulesa tradicionale e kulmit u zëvendësua me tjegulla të përshkruara si mediterane. Gjatë këtij viti u trajtuan edhe dëmtime të mureve të jashtme. Ndërsa enterieri nuk ishte prekur nga ato punime dhe se ruheshin tavanet, dysheme, vatër, shkallë e dyshekllëk.[124]

Familja shprehte gatishmëri që kulla të rivitalizohej, përfshirë mundësinë e kthimit në bujtinë. Besnik Sadiku kërkonte ruajtjen për brezat e ardhshëm dhe propozonte që objekti të mbante emrin e të atit, Rexhepit, të vrarë gjatë luftës së fundit. Ky propozim nuk trajtohet si ndryshim zyrtar i emërtimit, emri Isuf Sadiku ruhet për lidhjen me inventarin, ndërsa emri i Rexhepit shënohet si pjesë e historisë dhe dëshmisë familjare.[125]



Figura 64 Pamje të enterierit të kullës së Isuf Sadikut (burimi: DTKK)

122 Po aty
123 Po aty
124 Artan Krasniqi, Monument, vëll. V (viti, vendi dhe botuesi ende të paidentifikuar), "Shenjat monumentale të fshatit që dikur kishte veç kulla"
125 Artan Krasniqi, Monument, vëll. V (viti, vendi dhe botuesi ende të paidentifikuar), "Shenjat monumentale të fshatit që dikur kishte veç kulla"

Kulla e Isa Zymer Binakaj



Figura 65 Detajet e muratures së kullës së Isa Zymer Binakaj (burimi: QRTK- Gjakove)

Kulla e Isa Zymber Binakajt e ndërtuar afër Kullës së Ahmet Asllanit në fshatin Devë, dallohet për pamjen e përmbajtur, me pak hapje dhe muraturë guri të theksuar nga fugat e trasha të llaçit. U ndërtua në fund të shekullit XIX për banim. Ajo përfaqëson një variant më të thjeshtë të kullës, ku karakteri arkitektonik shprehet kryesisht përmes materialeve dhe teknikës së ndërtimit.[126]

Ndërtesa ka plan drejtkëndësh dhe zhvillohet në përdhesë e kat. Muret janë punuar me gurë të madhësive dhe formave të ndryshme, të lidhur me llaç gëlqeror, ndërsa qoshet theksohen nga gurët e latuar me nuanca të ndryshme. Konstruksioni ndërkatësh përbëhet nga trarë masivë druri dhe dysheme dërrasash, edhe kulmi ka konstruksion druri, të mbuluar me qeramidhe tradicionale. Tavanet, votra dhe dyert e brendshme plotësojnë karakterin e kullës, pa pasurinë dekorative që haset në disa prej kullave trekatëshe të Dukagjinit.[127]

Ndryshimet e mëvonshme përfshijnë shkallët prej betonarmeje për ngjitjen në kat. Dy ndërtime të reja, të bashkëngjitura në fasadat anësore, kanë ndryshuar marrëdhënien e kullës me rrethinën dhe kanë kufizuar dukshmërinë e saj. Braktisja dhe mungesa e mirëmbajtjes janë shoqëruar me depërtim uji nga kulmi, lagështi, dëmtime të brendshme dhe dobësim strukturor, duke e bërë objektin të pashfrytëzueshëm.[128]

Vlera e ruajtjes qëndron te dëshmia e një forme më të thjeshtë të banimit tradicional dhe te teknikat e muraturës së gurit, që plotësojnë larminë arkitektonike të kullave të zonës. Mbrojtja nga uji dhe stabilizimi i strukturës janë të rëndësishme për të penguar humbjen e mëtejshme të këtyre dëshmive.



Figura 66 Pamje e kullës së Isa Zymer Binakaj (Burimi: QRTK-Gjakovë)

[126] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, Kulla e Isa Zymber Binakajt, 2002-2024

[127] Po aty

[128] Po aty

Kulla e Rexhep Hasanit, Rogovë e Hasit, Gjakovë



Figura 67 Përpunimi i dyshekllëkut të kullës së Rexhep Hasanit (burimi: QRTK- Gjakovë)

Kulla e Rexhep Hasanit, e njohur edhe si Kulla e Bajram Selmanit, e cila gjendet në Rogovë të Hasit, veçohet për muraturën e latuar në nuanca të bardha e gri të çelëta. Ndërtimi i saj lidhet me fillimin e shekullit XIX dhe me paraardhësit e familjes Hasani. Sipas gojëdhënave familjare, gurët u sollën nga Gradishi, pranë kanionit të Drinit. Krahas banimit, kulla shërbente për mbledhjet e parisë së fshatit, ndërsa frëngjitë në mure dëshmojnë edhe funksionin e saj mbrojtës.[129]

Ndërtesa zhvillohet në përdhesë e kat. Veçantia e organizimit të saj qëndron te përdhesa, ku ishin vendosur dhoma gjumi, të njohura si qilarë. Në katin e sipërm gjendeshin oda e burrave, divanhanja me dyshekllëkun dhe vatra e zjarrit. Dyshekllëku, i punuar me gurë të mëdhenj të latuar, shtrihet përgjatë tërë ballinës dhe vazhdon deri në gjysmën e fasadave anësore. Hapjet gjysmërrethore ndërthuren me ato katrore, duke krijuar një ritëm të dallueshëm në pjesën e sipërme të kullës.[130]

Punimi i gurit merr shprehje të veçantë mbi portën kryesore, ku janë skalitur ornamente dhe mbishkrime në osmanishte. Kornizat e dyerve e të dritareve plotësojnë këtë përpunim të fasadave, ndërsa në brendësi mjeshtëria e drurit shfaqet në tavane, dollapët e murit, shkallë dhe dyert e brendshme. Konstruksioni prej druri i kulmit katërujor, i mbuluar me qeramidhe tradicionale, përmbyll ndërtesën.[131]

[129] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore- Gjakovë, "Kulla e Rexhep Hasanit"

[130] Po aty

[131] Po aty

4.2 Kullat e Junikut

Kulla e Brahim Hoxhës, Junik



Figura 68 Pamje të kullës së Brahim Hoxhës/ Odës së Junikut (burimi: DTKK)

Në qendër të Junikut, Kulla e Brahim Hoxhës mbart emrin "Oda e Junikut", që është lidhur me kuvendet, pajtimin e gjaqeve dhe ndarjen e drejtësisë sipas traditës zakonore. Brenda saj, jeta familjare bashkëjetonte me çështjet e komunitetit dhe përpjekjet për bashkim kombëtar. Këtu u prit Haxhi Zeka gjatë përgatitjeve për Lidhjen e Pejës dhe u mbajt Kuvendi i Junikut, më 21-25 maj 1912.[132]

Me planimetri katrore rreth 10 × 10 metra, kulla u zhvillua në përdhesë e dy kate. Muret prej guri, rreth një metër të trasha, dhe qoshet e punuara me gurë të latuar i japin pamjen e një shtëpie të fortifikuar. Në ballinë shihet dyshekllëku këndor prej druri, i dalë jashtë muraturës dhe i shtrirë në dy anë të objektit. Hapjet e ornamentuara, portat gjysmëharkore dhe shkallët e jashtme prej guri plotësojnë përpunimin e fasadave. Druri i gështenjës dhe i bungut, i latuar me sëpatë, dëshmon mjeshtërinë tradicionale të ndërtimit.Ndarja e kateve pasqyronte ritmin e jetës së familjes. Përdhesa strehonte bagëtitë, ndërsa në katin e parë jeta zhvillohej rreth dhomës së zjarrit, ku oxhaku i madh shërbente për gatim dhe pjekjen e bukës. Pranë saj ndodheshin dhoma e fjetjes dhe çarraniku për ruajtjen e bulmetit. Kati i sipërm i kushtohej pritjes, divanhanja të shpie në odën e burrave, ku dera e gdhendur, tavani prej druri, oxhaku, raftet e profilizuara dhe trapazani krijonin një hapësirë të punuar me kujdes për mikun dhe kuvendin.[133]

Djegia gjatë luftës më 1998 ndërpreu përdorimin e kullës. Restaurimi i vitit 2002, me mbështetjen e CHwB-së dhe SIDA-s suedeze, mundësoi rikthimin e banimit dhe ruajtjen e karakterit tradicional të odës, duke vazhduar lidhjen e ndërtesës me familjen dhe komunitetin.[134]



Figura 69 Pamje e enterierit të kullës së Brahim Hoxhës (Burimi: DTKK)

[132] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore -Gjakovë, "Kulla e Brahim Hoxhës", (2002-2024); Databaza e Trashëgimisë Kulturore e Kosovës, "Kulla e Brahim Hoxhës, Oda e Junikut",

[133] Po aty

[134] Po aty

Kulla e Sadik Shehut, Junik

Kulla e Sadik Shehut është pjesë e një mjedisi të pasur me kulla familjare, pranë atyre të Qallakëve dhe Demësylajve. U ndërtua në fillim të shekullit XIX, ajo shërbeu për banim, mbrojtje dhe takime me rëndësi shoqërore. Veçantia e saj shprehet në punimin e gurit, ku ngjyrat dhe format e gdhendura theksojnë qoshet dhe hapjet e ndërtesës.[135]

Kulla u zhvillua në përdhesë e dy kate, mbi themele masive guri. Në muraturë është përdorur guri vendor, i ndërthurur me gurin e kuqërremtë nga fshati Botushë. Qoshet janë punuar me gurë të latuar dyngjyrësh, ndërsa i njëjti trajtim shumëngjyrësh vazhdon te portat harkore dhe dritaret me hark të dyfishtë të odës së burrave. Dysheklléku prej guri del jashtë muraturës në ballinë dhe në fasadën anësore, duke lidhur të dyja anët në një kompozim të përbashkët.[136]

Organizimi i brendshëm ndante ekonominë shtëpiake, jetën familjare dhe pritjen e mysafirëve sipas kateve. Përdhesa përbëhej nga një hapësirë e vetme për bagëtitë, me hyrjen dhe shkallët drejt katit të banimit. Në katin e parë ndodheshin dhoma e zjarrit, dhoma e bulmetit dhe dhoma e fjetjes. Sipër vendosej oda e burrave me divanhane dhe një korridor të ngushtë drejt nyjës sanitare. Qasja e veçantë për mysafirët e dallonte këtë pjesë nga hapësirat familjare, ndërsa drugdhendjet dhe guri i latuar bashkonin nevojat praktike me përpunimin estetik të kullës.[137]





Figura 70 Kulla e Sadik Shehut (burimi: QRTK- Gjakove)

[135] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, "Kulla e Sadik Shehut", (2002-2024)

[136] Po aty

[137] Po aty

Kulla e Jah Imerit, Junik



Figura 71 Detaj i hapjeve në kullën e Jah Imerit në Junik. (Burimi: QRTK Gjakovë)

Në lagjen Hoxhaj, pranë xhamisë në qendër të Junikut, Kulla e Jahë Imerit dallohet për dyshekllëkun prej guri që del jashtë muraturës në dy anë të ndërtesës. Kulla u ndërtua në fillim të shekullit XIX, ajo bashkonte banimin familjar me mbrojtjen, përmes mureve masive që arrijnë trashësinë pothuajse një metër. Guri i lidhur me llaç gëlqeror ndërthuret me drurin e gështenjës, të latuar me sëpatë, në shtyllat dhe trarët mbajtës. Kulmi katërujor ka konstruksion druri dhe mbulesë me tjegulla tradicionale.[138]

Jeta e shtëpisë organizohej në përdhesë e dy kate. Përdhesa, e shtruar me kalldrëm guri, shërbente si ahur dhe ajrosej përmes frëngjive. Shkallët e drurit çonin në katin familjar, ku korridori i gjerë lidhte dhomën e zjarrit, dhomën e fjetjes dhe çarranikun për ruajtjen e bulmetit. Në katin e sipërm vendoseshin oda e burrave dhe divanhanja, duke i dhënë pritjes së mysafirëve një hapësirë të veçantë brenda kullës.[139]

Oda ndahej në dy pjesë, të njohura si “çerga e madhe” dhe “çerga e vogël”. Dera hyrëse, dollapët, oxhaku dhe raftet dalloheshin për përpunimin dekorativ, ndërsa dy dritare gjysmëharkore ndriçonin brendësinë. Divanhanja kishte oxhakun e vet dhe dy hyrje, një të jashtme e një të brendshme; dritaret e vogla të hapura në gur plotësonin ndriçimin e saj. Me kalimin e kohës, dritaret e dyshekllëkut u zgjeruan, duke ndryshuar pamjen fillestare. Gjatë luftës në Kosovë, kulla i shpëtoi djegies, por pësoi dëmtime.[140]



Figura 72 Pamja nga rruga e kullës së Jah Imerit në Junik. Burimi: QRTK Gjakovë;

[138] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, “Kulla e Jah Imerit”, 2002-2024.

[139] Po aty

[140] Po aty

Kulla e Tafë Hoxhës, Junik

Kulla e Tafë Hoxhës ndodhet në pjesën e epërme të lagjes Hoxhaj në Junik, ajo lidh historinë e banimit familjar me veprimtarinë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Kulla u ndërtua në fillim të shekullit XIX, ajo shërbeu për banim e mbrojtje dhe më vonë për strehimin e luftëtarëve shqiptarë. Tafë Hoxha ishte bashkëpunëtor i Hasan Prishtinës dhe Bajram Currit, gjatë viteve 1921-1923, kur Juniku ishte zonë neutrale, në kullën e tij u strehuan edhe Azem e Shote Galica.[141]

Guri i marrë nga lumi Erenik dhe druri i gështenjës nga malet e familjes përbënin materialet kryesore të ndërtimit. Muratura lidhej me llaç gëlqeror, ndërsa elementet prej druri punoheshin me sëpatë. Fillimisht, kulla ngrihej në përdhesë e dy kate dhe mbulohej me kulm katërujor me tjegulla. Në katin e sipërm ndodheshin oda e burrave me dekorimet e saj, divanhanja dhe dyshekllëku prej guri, i cili dilte jashtë muraturës në krahun e djathtë të ballinës. Këto hapësira i jepnin pritjes së mysafirëve vend të veçantë në organizimin e shtëpisë.[142]

Pamja e kullës ndryshoi pas vitit 1980, kur u rrënua kati i sipërm bashkë me odën dhe dyshekllëkun, duke e lënë ndërtesën në dy nivele. Përshtatjet për jetën familjare sollën një kulm të ri, zgjerimin e portës dhe hapjen e dritareve të mëdha gjysmëharkore, disa të kornizuara me tulla të kuqe. Edhe përdhesa u riorganizua me dhoma, kuzhinë e banjo. Këto ndryshime e larguan ndërtesën nga forma e saj fillestare, ndërsa historia e strehimit dhe e veprimtarisë së Tafë Hoxhës mbetet pjesë e rëndësishme e kujtesës së saj.[143]



Figura 74 Pamja ballore e Kullës së Tafë Hoxhës në Junik (Burimi: QRTK Gjakovë)



Figura 73 Pamja anësore nga rruga e Kullës së Tafë Hoxhës në Junik (Burimi: QRTK Gjakovë)

[141] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, "Kulla e Taf Hoxhës", 2002-2024.
[142] Po aty
[143] Po aty

Kulla e Ramë Zyber Krasniqit, Junik




Figura 75 Kulla e Ramë Zyber Krasniqit në Junik. (Burimi: QRTK Gjakovë)

Pranë xhamisë së Qokut në Junik, Kulla e Ramë Zyber Krasniqit dallohet për përpunimin e gurit në ballinë, qoshe dhe dyshekllëk. E ndërtuar në fillim të shekullit XIX, ajo shërbeu si shtëpi familjare, me hapësira që bashkonin nevojat e jetesës së përditshme me ekonominë shtëpiake. Planimetria drejtkëndëshe, me përmasa rreth 9,22 × 10,30 metra, kufizohet nga mure guri, ndërsa kulmi katërujor ka konstruksion druri dhe mbulesë me tjegulla. Portat me korniza guri e harqe dhe dritaret harkore të katit plotësojnë karakterin e fasadave.[144]

Përdhesa shërbente si ahur, me dritare të vogla drejtkëndëshe, ndërsa shkallët prej druri çonin në hapësirat e familjes. Jeta e përditshme përqendrohej rreth dhomës së zjarrit, ku oxhaku i madh shërbente për ngrohje dhe gatim. Pranë tij vendoseshin magjja e bukës, çerepët dhe saçet. Dy dhoma të vogla fjetjeje, me vend për një shtrat dhe arkat e rrobave, si dhe çarraniku për ruajtjen e bulmetit, plotësonin organizimin e brendshëm.[145]

Djegia gjatë luftës së viteve 1998–1999 ndërpreu banimin familjar. Ndërhyrjet e mëvonshme, të ndërmarra nga pronari më 2007 dhe CHwB-ja më 2015, sollën edhe ndryshime në ndërtim: mbështetjet e brendshme prej druri u zëvendësuan me shtylla betonarmeje dhe muret e brendshme u realizuan me blloqe. Pas restaurimit, kulla u përshtat si lokal me ushqime tradicionale, duke i dhënë hapësirave të dikurshme familjare një përdorim të ri të lidhur me mikpritjen.[146]

[144] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, "Kulla e Ramë Zyber Krasniqit", (2002-2025.)

[145] Po aty

[146] Po aty

Kulla e Sadik Shehu, Junik



Figura 76 Kulla e Sadik Shehut (burimi: QRTK – Gjakovë)

Në lagjen Hoxha, në qendër të Junikut, Kulla e Sadik Shehut është pjesë e një mjedisi të pasur me kulla familjare, pranë atyre të Qallakëve dhe Demësylajve. E ndërtuar në fillim të shekullit XIX, ajo shërbeu për banim, mbrojtje dhe takime me rëndësi shoqërore. Veçantia e saj shprehet në punimin e gurit, ku ngjyrat dhe format e gdhendura theksojnë qoshet dhe hapjet e ndërtesës.[147]

Kulla zhvillohet në përdhesë e dy kate, mbi themele masive guri. Në muraturë është përdorur guri vendor, i ndërthurur me gurin e kuqërremtë nga fshati Botushë. Qoshet janë punuar me gurë të latuar dyngjyrësh, ndërsa i njëjti trajtim shumëngjyrësh vazhdon te portat harkore dhe dritaret me hark të dyfishtë të odës së burrave. Dysheklleku prej guri del jashtë muraturës në ballinë dhe në fasadën anësore, duke lidhur të dyja anët në një kompozim të përbashkët.[148]

Organizimi i brendshëm ndante ekonominë shtëpiake, jetën familjare dhe pritjen e mysafirëve sipas kateve. Përdhesa përbëhej nga një hapësirë e vetme për bagëtitë, me hyrjen dhe shkallët drejt katit të banimit. Në katin e parë ndodheshin dhoma e zjarrit, dhoma e bulmetit dhe dhoma e fjetjes. Sipër vendosej oda e burrave me divanhane dhe një korridor të ngushtë drejt nyjës sanitare. Qasja e veçantë për mysafirët e dallonte këtë pjesë nga hapësirat familjare, ndërsa drugdhendjet dhe guri i latuar bashkonin nevojat praktike me përpunimin estetik të kullës.[149]



Figura 77 Pamja e oborrit të kullës së Sadik Shehut (burimi: QRTK – Gjakovë)

[147] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë
[148] Po aty
[149] Po aty

Kulla e Rrustë Zeqirit, Junik



Figura 78 Pamja e kullës së Rrustë Zeqirit, pas restaurimit (Burimi: QRTK- Gjakovë)

Kulla e Rrustë Zeqirit u ndërtua në trojet e familjes Isufaj, në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XIX si shtëpi e fortifikuar. Krahas jetës familjare, ajo shërbeu si vendtakim për Hasan Prishtinën, Beqir Agë Vokshin, Azem Bejtën dhe parinë e Junikut, duke u lidhur me veprimtarinë shoqërore e kombëtare të kohës.[150]

Kulla ka një planimetri katërkëndëshe dhe zhvillohet në përdhesë e dy kate. Muret prej gurit të Erenikut, janë të lidhur me llaç gëlqeror, të cilat arrijnë rreth një metër trashësi në bazë dhe ngushtohen në rreth 80 centimetra në katin e sipërm. Qoshet dhe harqet e dyerve e të dritareve janë të punuara me gurë të latuar, ndërsa druri ishte siguruar nga malet e Junikut. Në pamjen e dikurshme veçohej dyshekllëku prej druri, i dalë jashtë mureve perimetrale në nivelin më të lartë.[151]

Hyrjet e veçanta pasqyronin ndarjen e funksioneve, nga oborri hyhej në ahurin e përdhesës, ndërsa shkallët e gurit nga rruga çonin në katin familjar, me dhomën e zjarrit, dy dhoma fjetjeje dhe divanhanen. Shkallët e brendshme prej druri vazhdonin drejt odës së burrave. Oxhaku, tavani, dollapët, raftet dhe trapazani e bënin odën hapësirën më të përpunuar të kullës. Ajo shërbente për ndejë gjatë ditës dhe për fjetjen e burrave e të mysafirëve gjatë natës. Divanhanja e sipërme,



Figura 80 Pamja e pjesës së oborrit (Burimi: QRTK- Gjakovë)




Figura 79 Pamja e kullës së Rrustë Zeqirit, pas restaurimit (Burimi: QRTK- Gjakovë)

[150] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material përshkrues për "Kullën e Rrustë Zeqirit", në bibliografinë e materialit referohet: KK Junik, *Guidë e Junikut dhe Gjakovës* (Junik, 2013)

[151] Po aty

me dritare më të shumta, përdorej edhe për qëndrim gjatë stinëve të ngrohta.[152]

Kulla u dogj më 1998, duke mbetur vetëm me muret. Restaurimi i vitit 2011, me mbështetjen e CHwB-së, Komunës së Junikut dhe MKRS-së, i dha një përdorim të ri si Qendër për Turizëm Regjional. Ndërhyrja solli edhe ndryshimin e fasadës perëndimore, ku pjesë të muraturës u zëvendësuan me sipërfaqe xhami përgjatë niveleve të ndërtesës e cila I dha një karakter të veçantë kullës.[153]



[152] Po aty

[153] Po aty

Kulla e Osmon Llollunit, Junik



Figura 81 Shkallët e kullë sës Osmon Llollunit që të shpiejnë në odë të burrave (burimi: QRTK – Gjakovë)

Kulla e Osmon Llollunit u ndërtua në fillim të shekullit XIX në lagjen e Bajraktarëve për banimin e familjes Llulluni. Objekti kishte tre etazhe te zhvilluara në përdhesë e dy kate.Ajo dallohet për dyshekllëkun prej guri që del në ballinë dhe në fasadën e djathtë. Dritaret e vogla përgjatë tij ndriçonin hapësirën e pritjes, ndërsa oborri me kopsht dhe pozllomi plotësonin kompleksin familjar.[154]

Organizimi i brendshëm ndante hapësirat ekonomike nga jeta familjare dhe mikpritja. Përdhesa shërbente si ahur, ndërsa në katin e parë gjendeshin dhomat e fjetjes, dhoma e zjarrit, kthina e bulmetit dhe divanhanja. Në katin më të lartë vendosej oda e burrave, me përpunimin më të pasur dekorativ të ndërtesës. Pranë saj, divanhanja ishte e hapur deri te konstruksioni i çatisë, duke lënë të dukshme strukturën e saj, dhe përmbante një oxhak e dyshekllëkun prej guri. Mysafirët kishin një rrugë të veçantë hyrjeje, shkallët e jashtme prej guri çonin në katin e parë, prej nga ngjitja vazhdonte me shkallë druri drejt odës.[155]

Kulla u dogj gjatë luftës së viteve 1998-1999 dhe u restaurua më pas nga familja. Përshtatja për banim ndryshoi sidomos brendësinë, ahuri u shndërrua në hapësira qëndrimi ditor, ndërsa në katin familjar u riorganizuan dhomat e fjetjes dhe sanitaret. Në nivelin e sipërm u mbajt organizimi tradicional i odës dhe divanhanes. Përforcimi dhe fugatimi i mureve, kornizimi i hapjeve me tulla dhe mbulimi me tjegulla moderne ndryshuan pamjen e jashtme, duke shtuar një fazë të re në historinë ndërtimore të kullës.[156]



Figura 82 Pamja e kullës së Osmon Llollunit nga oborri (Burimi: QRTK - Gjakovë)

[154] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore- Gjakovë, materiali përshkrues për "Kullën e Osmon Llollunit", bibliografia referuar tek veprat e Fejaz Drançollit dhe Flamur Dolit

[155] Po aty

[156] Po aty

Kulla e Kukajve, Junik



Figura 83 Kulla e Kukajve me dyshekllëkun në tri fasada(Burimi: QRTK - Gjakovë)

Në lagjen e Gaxherrëve të Epërm në Junik, Kulla e Kukajve u ndërtua në fillim të shekullit XIX nga mjeshtër dibranë dhe vendas. Banimi familjar ndërthurej me mbrojtjen, gjë që vërehet tek dritaret e vogla dhe frëngjitë në të katër fasadat, këto e mundësonin vrojtimin dhe mbrojtjen e ndërtesës. Veçantia e saj arkitektonike është dyshekllëku prej guri, i cili del jashtë mureve perimetrale në tri fasada.[157]

Me planimetri katrore dhe përdhesë e dy kate, kulla mbështetet në mure masive që arrijnë rreth një metër trashësi në bazë dhe ngushtohen në lartësi. Guri i papërpunuar nga lumi Erenik, i lidhur me llaç gëlqeror, përbën muraturën e fasadave, ndërsa qoshet, harqet dhe anët e hapjeve si teknik e përdorur në shumë kulla të tjera të rrafshit të Dukagjinit, janë punuar me gurë të latuar. Ky përpunim më i kujdesshëm thekson portat dhe dritaret përkundrejt sipërfaqeve të parregullta të mureve.[158]

Përdhesa shërbente për strehimin e bagëtive dhe ruajtjen e ushqimit të tyre. Mbi të zhvillohej jeta familjare, rreth dhomës së zjarrit, dhomës së fjetjes dhe asaj të bulmetit. Një divanhane e vogël dhe shkallët prej druri lidhnin këtë nivel me katin e sipërm, ndërsa sanitaret vendoseshin në një pjesë të bashkëngjitur në fasadën veriore. Oda e burrave dallohej për derën e gdhendur, tavanin me shiklla, oxhakun, dollapët, raftet dhe trapazanin. Pranë saj, divanhanja ndriçohej nga një varg dritaresh të vogla gjysmëharkore me korniza guri. Shkallët e jashtme u siguronin mysafirëve qasje të veçantë në kate, duke e ndarë hyrjen e tyre nga qarkullimi i përditshëm i familjes. Ndryshimet e mëvonshme prekën sidomos dyert, dritaret dhe kulmin.[159]

[157] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë Materiali përshkrues i përcjellë për "Kullën e Kukajve", bibliografia shoqëruese: Fejaz Drançolli, *Kullat Shqiptare* (Prishtinë, 2001); Ministria Kultuore e Rinisë dhe Sportit, *Trashëgimia e evidentuar në Kosovë* (Prishtinë, 2005).

[158] Po aty

[159] Po aty

Kulla e Nur Shalës, Junik

Kulla e Nur Shalës e ndërtuar në lagjen e Gaxherrit të Ulët në Junik, dallohet për dyshekllëkun prej guri që përshkon tërë ballinën dhe vazhdon në një pjesë të të dy fasadave anësore. Dritaret e vogla, të punuara me gurë të latuar e të drejtuara nga rruga, i japin këtij niveli një ritëm të veçantë. Kulla u ndërtua në fillim të shekullit XIX nga mjeshtër dibranë në bashkëpunim me mjeshtër vendas, të cilët kontribuuan sidomos në drugdhendjen e brendësisë. Ajo bashkonte banimin familjar me strehimin e bagëtive dhe funksionin mbrojtës.[160]

Planimetria katrore zhvillohet në përdhesë e dy kate. Muret prej guri, të lidhur me llaç gëlqeror, kanë trashësi rreth 90 centimetra në bazë dhe ngushtohen drejt kateve të sipërme përmes shkallëzimit nga brenda. Gurët e latuar si në shumicën e kullave në Junik theksojnë qoshet dhe kornizat harkore të dyerve e të dritareve. Pas portës prej druri, përdhesa hapet si një hapësirë e vetme e shtruar me kalldrëm, ku grazhdi i ngritur mbi gurë shërbente për ushqimin e bagëtive. Shkallët prej druri të shpiejnë në katin familjar, me dhomën e zjarrit, dhomën e fjetjes, çarranikun dhe një divanhane të vogël.[161]

Në katin e sipërm, oda e burrave përmblidhte punimet më të kujdesshme të brendësisë, tavanin me shiklla, derën hyrëse, dollapët, raftet, oxhakun dhe trapazanin. Pranë saj ndodheshin divanhanja, dyshekllëku dhe korridori drejt sanitareve, ndërsa shkallët e jashtme u shërbenin mysafirëve. Ndërhyrjet restauruese sollën ndryshime në dyer, dritare, kulm dhe brendësi. Mes tyre ishte edhe zëvendësimi i shtresave të dikurshme të dyshemesë, me dhe e dërrasa të trasha, me një dysheme të dyfishtë prej dërrasash.[162]



Figura 84 Pamja e kullës së Nur Shalës nga rruga (burimi: QRTK- Gjakovë)

[160] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore- Gjakovë Materiali përshkrues i përcjellë për "Kullën e Nur Shalës", nga Mark Krasniqi, "Shtëpitë shqiptare në Kosovë", *Gjurmime Albanologjike - Folklor dhe Etnologji* (Prishtinë, 1971); Fejaz Drançolli, *Kullat Shqiptare* (Prishtinë, 2001)

[161] Po aty

[162] Po aty


5. Kullat në rajonin e Prizrenit

Kullat në rajonin e Prizrenit tregojnë një traditë ndërtimore në të cilën banimi, ekonomia familjare, mikpritja dhe nevoja për siguri kanë ndikuar në formësimin e hapësirës. Në këtë kapitull, rajoni trajtohet përmes shembujve nga Prizreni, Rahoveci, Suhareka dhe Malisheva, të cilët, pavarësisht tipareve të përbashkëta, shfaqin dallime në organizim, përpunim arkitektonik dhe marrëdhënie me vendbanimin. Përzgjedhja përqendrohet te kullat e përfshira në kuadrin e mbrojtjes së përkohshme, duke përfshirë edhe dëshmi të dokumentuara të ndërtesave tashmë të rrënuara. Ajo nuk përbën një inventar të plotë të kësaj trashëgimie, rajoni posedon edhe kulla të tjera që nuk trajtohen këtu, mungesa e të cilave në këtë përmbledhje nuk nënkupton rëndësi më të vogël historike apo arkitektonike. Po kështu, kullat e humbura përbëjnë një pjesë të rëndësishme të historisë së banimit, edhe kur prej tyre kanë mbetur vetëm dokumente, fotografi dhe kujtime.

Nga shqyrtimi i ndërtesave del se emërtimi “kullë” përfshin një larmi zgjidhjesh, nga vëllimet kompakte me karakter të theksuar mbrojtës deri te shtëpitë-kulla me çardak dhe banesat me brendësi të përpunuara. Për këtë arsye, arkitektura e tyre nuk mund të kuptohet vetëm përmes lartësisë ose masivitetit të mureve. Dallimet ndërmjet një çardaku prej druri, një dyshekllëku prej guri dhe një balline të mbyllur shprehin mënyra të ndryshme të organizimit të jetës dhe të lidhjes me hapësirën e jashtme. Shumica e rasteve të trajtuara lidhen me shekullin XIX, ndërsa datimet më të hershme dhe shembujt e shekullit XX tregojnë vazhdimësinë dhe përshtatjen e kësaj tradite.

Vendndodhja ndikon drejtpërdrejt në karakterin e kullave. Në mjediset rurale, ato shpesh ishin pjesë e një tërësie familjare me oborr, ahur, hambar dhe ndërtesa ndihmëse. Terreni i pjerrët mundësonte hyrje në nivele të ndryshme dhe ndikonte në ndarjen e funksioneve. Në mjedisin qytetar të Rahovecit, marrëdhënia me rrugën, sheshin dhe parcelat fqinje merr peshë më të madhe, disa objekte marrin pjesë drejtpërdrejt në pamjen e hapësirës publike, ndërsa të tjera e orientojnë jetën e brendshme drejt oborrit. Kështu, ngjashmëria në materiale nuk prodhon domosdoshmërisht të njëjtën mënyrë banimi.

Guri dhe druri përbëjnë bazën e përbashkët materiale, por përdorimi i tyre shfaq njohuri dhe praktika të ndryshme ndërtimore. Muratura e thatë bashkëjeton me muraturën e lidhur me baltë ose gëlqere, përforcimet me hatulla druri shfaqen në disa ndërtesa, ndërsa mungojnë në të tjera. Krahas mureve masive, ndarjet më të lehta me skelet druri, qerpiç ose thupra krijojnë një dallim ndërmjet




mbështjellësit të jashtëm dhe organizimit të brendshëm. Kjo larmi na tregon se tradita vendore mbështetej në përshtatjen e teknikave sipas kushteve dhe nevojave konkrete.

Organizimi funksional pasqyron afërsinë ndërmjet jetës familjare dhe ekonomisë shtëpiake. Nivelet e poshtme shpesh përmbanin hapësira për bagëti, depozitim ose përgatitje ushqimi, ndërsa katet e sipërme përdoreshin për banim dhe pritje. Megjithatë, kjo ndarje nuk ishte e njëtrajtshme. Hyrjet e veçanta, shkallët e jashtme dhe hapësirat e përbashkëta të qarkullimit mundësonin dallimin ndërmjet familjarëve, mysafirëve dhe veprimtarive ekonomike. Përdorimi i disa kullave për arsim, administrim, veprimtari ushtarake apo takime dëshmon gjithashtu se roli i tyre mund të tejkalonte kufijtë e shtëpisë private.

Individualiteti arkitektonik shfaqet veçanërisht në pragjet dhe hapësirat e pritjes, portat harkore, shtyllat, tavanet e gdhendura dhe pajisjet e integruara të brendësisë. Përmbajtja e jashtme e disa ndërtesave shoqërohet me një trajtim të pasur të odave, duke krijuar një dallim të dukshëm ndërmjet pamjes publike dhe përjetimit të brendshëm. Motivet e gdhendura në gur e dru i japin kullës edhe një dimension simbolik, ndërsa oxhaqet, kamaret dhe këndet e larjes e lidhin përpunimin artistik me përdorimin e përditshëm.

Transformimet dhe humbjet janë pjesë e kësaj historie. Ndryshimi i hyrjeve, mbyllja e çardakëve, zëvendësimi i mbulesave dhe ndërtimet e reja në oborre tregojnë përshtatjen ndaj nevojave të mëvonshme, por edhe dobësimin e marrëdhënieve fillestare hapësinore. Dëmtimet nga lufta, braktisja dhe mungesa e mirëmbajtjes kanë cenuar si objektet, ashtu edhe tërësitë ku ato bënin pjesë. Prandaj, vlera e kësaj trashëgimie qëndron njëkohësisht te struktura e ruajtur, mjeshtëria ndërtimore, konteksti i vendosjes dhe kujtesa e përdorimit. Mbrojtja e saj kërkon që këto lidhje të mbeten të lexueshme edhe pas restaurimit.



5.1 Prizreni dhe rrethina

Kulla e Pjetër Prenkpalajt, Zym



Figura 85 Pamje e Kullës së Pjetër Prenkplalajt para restauirmit (Burimi: QRTK - Prizren)

Kulla e Pjetër Prenkpalajt, e vendosur në terrenin e pjerrët të lagjes Prenkpalaj në Zym të Hasit, e njohur edhe si Shtëpia e Gegë Nokë Prenkpalajt, dallohet për ndërthurjen e muraturës së gurit me mjeshtërinë e drurit. E ndërtuar në shekullin XIX për banim dhe ruajtjen e bagëtisë, ajo i përket tipit të shtëpi-kullave me çardak përgjatë gjithë ballinës. Çardaku lindor, fillimisht i hapur, u mbyll më vonë me muraturë guri, por dhjetë shtyllat prej druri me kapitele të dekoruara mbetën dëshmi të organizimit të mëparshëm.[163]

Ndërtesa ka planimetri drejtkëndëshe dhe zhvillohet në tri nivele, në suteren, përdhesë dhe kat. Suter eni përmbante dy dhoma banimi me hyrje nga oborri, ndërsa përdhesa bashkonte hapësirat e shtëpisë së zjarrit me dy ahure që kishin qasje të jashtme. Në katin e sipërm organizoheshin tetë dhoma gjumi, dhoma e miqve dhe hapësirat e qarkullimit. Shkallët e brendshme prej druri shërbenin për familjarët, ndërsa hyrjet nga oborri mundësonin qasjen e veçantë të mysafirëve. Ky organizim shfrytëzonte pjerrësinë e terrenit dhe dallonte hapësirat familjare nga ato të pritjes.[164]

Veçantia konstruktive qëndron te muret mbajtëse prej guri vendor të latuar, të ndërtuara në të thatë, pa llaç, dhe të përforcuara me trarë horizontale druri. Ndarjet e brendshme realizoheshin me thupra, ndërsa sipërfaqet e brendshme suvatoheshin me baltë të përzier me kashtë. Konstruksionet ndërkatëshe dhe të kulmit ishin prej druri, kulmi treujor mbulohej me rrasa guri dhe përfundonte me streha të gjera. Shtyllat e çardakut, trau dekorativ mbi hyrjen e dhomës së miqve, dyert, raftet dhe parmakët prej druri plotësonin karakterin e kullës. Magjja e bukës dhe sofra e tregonin gjithashtu mënyrën tradicionale të jetesës.[165]

Braktisja dhe mungesa e mirëmbajtjes e lanë kullën të ekspozuar ndaj reshjeve dhe degradimit, duke shkaktuar rrënimin e pjesshëm të mureve dhe dëmtime të rënda të elementeve prej druri. Ndërhyrjet emergjente dhe punimet restauruese që pasuan synuan përforcimin e ndërtesës dhe ruajtjen e



Figura 86 Kulla e Pjetër Prenkpalajt pamja pas restaurimit (burimi: MKRS)

[163] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, "Kulla e Pjetër Prenkpalajt / Shtëpia e Gegë Nokë Prenkpalajt", 18.08.2015.

[164] Po aty

[165] Po aty

tipareve të saj arkitektonike.[166] Rëndësia e ruajtjes së saj lidhet veçanërisht me teknikën e muraturës së thatë, gjurmët e çardakut dhe drugdhendjet, që dokumentojnë një variant të veçantë të banimit tradicional në Has.

Sipas njoftimit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 7 tetor 2026, punimet restauruese në Kullën e Pjetër Prenkpalajt kanë përfunduar. Ku ndërhyrja vlerësohet si shpëtim i ndërtesës nga rrënimi dhe rikthim i integritetit të saj, duke mundësuar ruajtjen e vlerave historike dhe arkitekturore të këtij shembulli të arkitekturës tradicionale të Hasit.[167]



Figura 87 Kulla e Pjetër Prenkpalajt pamja pas restaurimit (burimi: MKRS)

[166] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, njoftim mbi vizitën në terren dhe ecurinë e punimeve restauruese në Kullën e Pjetër Prenkpalajt, 15 dhjetor 2025;
[167] Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), "Shpëtohet nga rrënimi Kulla e Pjetër Prenkpalaj në Zym të Hasit, Prizren", 7 tetor 2026.

Kulla e Tahir Reshitit/Ryshitit, Kojushë



Figura 88 Kulla e Tahir Reshitit, pamja ballore (burimi: QRTK Prizren)

Në Lagjen Qunaj të Kojushës, në rajonin e Hasit, Kulla e Tahir Reshitit dallohet për portat harkore prej guri dhe motivin e gjysmëhënës të skalitur mbi hyrjen e përdhesës. E vendosur në terren të rrafshët, me fasadën ballore drejt veriperëndimit, ajo është pjesë e një oborri të rrethuar me mure guri, ku bashkëjetojnë një shtëpi e vjetër dhe dy shtëpi më të reja. Sipas të dhënave gojore, kulla është ndërtuar në shekullin XIX dhe ka shërbyer për banim dhe ruajtjen e bagëtisë.[168]

Planimetria drejtkëndëshe organizohet në përdhesë dhe kat. Në përdhesë gjenden ahuri dhe dy dhoma banimi, ndërsa në kat pesë dhoma dhe holli. Secili nivel ka hyrje të veçantë nga fasada veriperëndimore, përdhesa arrihet drejtpërdrejt nga oborri, kurse kati përmes shkallëve të jashtme prej guri. Të dyja portat kanë dyer druri dhe korniza harkore të punuara me gurë vendorë të gdhendur.[169]


Muret mbajtëse, rreth 70 centimetra të trasha, janë ndërtuar me gurë të thyer dhe llaç gëlqeror, pa breza horizontalë druri. Ndarjet e brendshme janë realizuar me thupra, të suvatuara me llaç balte dhe kashtë. Trarët e gdhendur prej druri formojnë konstruksionin ndërkatësh, ndërsa një shtyllë në ahur, me kapitel të punuar dhe bazament guri, tregon kujdesin për detajet konstruktive. Kulmi katërujor përfundon me një kurorë guri të profilizuar dhe mbulohet me tjegulla të rrafshëta, të zëvendësuara nga pronarët më 1985. [170] Oxhaqet, kamaret, frëngjitë dhe dritaret harkore plotësojnë brendësinë e kullës. Në dy dhoma ruhen këndet e larjes, ose hamamxhikët, me platforma të ngritura rreth 20 centimetra mbi dysheme. Bashkë me dyert origjinale dhe enët e veglat tradicionale, këto elemente e bëjnë kullën një dëshmi të vlefshme të jetës familjare në Has.[171]

Mungesa e mirëmbajtjes ka sjellë dobësim të muraturës, dëmtime të ndarjeve dhe degradim të trarëve, tavaneve, dyerve e dritareve nga kalbja dhe insektet. Në gjendjen e dokumentuar, kulla ishte vetëm pjesërisht e banueshme. Ruajtja e saj ka rëndësi për teknikat tradicionale të ndërtimit, përpunimin e gurit dhe drurit, si dhe elementet e jetës së përditshme që ende mbart.[172]



Figura 89 Pamja e ahurit në përdhesë (burimi: QRTK-Prizren)

[168] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, "Kulla e Tahir Reshitit", Kojushë (02.09.2015)
[169] Po aty
[170] Po aty
[171] Po aty
[172] Po aty



Kulla e Zaptijve, Zym



Figura 90 Pamje të kullës së Zaptijve me murë të dëmtuar (QRTK-Prizren, shkurt 2025)

Kulla e Zaptijëve e ndërtuar në Zym, ruan kujtesën e ndryshimeve në jetën publike të fshatit. Nga stacion policor gjatë periudhës osmane, ajo u kthye në hapësirë mësimi në gjuhën shqipe dhe seli administrative, përpara se të përshtatej si shtëpi e familjes Berisha. Historia e saj shtrihet nga shekulli XIX në shekullin XX, duke e bërë një nga ndërtesat e hershme publike të Zymit.[173]

E rrethuar në të katër anët nga oborri dhe muret prej guri, kulla zhvillohet në përdhesë e kat. Planimetria drejtkëndëshe plotësohet nga një aneks i vogël që del nga vëllimi kryesor. Holli lidh tri kthinat e përdhesës dhe hapësirën ndihmëse, ndërsa shkallët prej druri në formë L çojnë në kat, ku organizohen katër kthina dhe një hapësirë e vogël në aneks. Në oborr ruhen edhe muret e bodrumit të një ndërtese tjetër prej guri.[174]

Muret masive dhe qoshet e punuara me gurë të gdhendur ndërthuren me ndarjet e katit të realizuara në sistemin bondruk, me skelet druri dhe mbushje qerpiçi. Trarët ndërkatësh mbeten të dukshëm në tavane, ndërsa dyshemetë janë shtruar me dërrasa. Kulmi katërujor prej druri mbulohet me rrasa guri. Portali gjysmërrethor dhe dy dritaret origjinale harkore dëshmojnë mjeshtërinë e gdhendjes së gurit, ndërkaq dyert e vjetra dhe arkat prej druri me motive gjeometriike e florale pasurojnë brendësinë. Hapjet e tjera janë ndryshuar gjatë përshtatjes për banim në gjysmën e dytë të shekullit XX.[175]

Braktisja dhe mungesa e mirëmbajtjes kanë cenuar ndërtesën. Gjatë vitit 2019 është evidentuar depërtim uji nga kulmi, lagështi, çarje në mure dhe dëmtime të dyshemeve, tavaneve e elementeve prej druri. Ruajtja e kullës ka rëndësi si për arkitekturën tradicionale dhe mbulesën me rrasa guri, ashtu edhe për historinë e arsimit dhe administrimit në Zym. Ndryshimi i funksioneve e bën atë dëshmi të mënyrës se si një ndërtesë i është përshtatur nevojave të komunitetit ndër breza.[176]



Figura 91 Detaje e shkallëve në kullën e Zaptive (QRTK- Prizren, shkurt 2025)

[173] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, Kulla e Zaptijve, Zym (02.09.2015)
[174] Po aty
[175] Po aty
[176] Po aty

Kulla e familjes Cikaj, Gjonaj, Prizren



Figura 92 Pamja ballore e Kullës së Familjes Cikaj, Gjonaj, Prizren (QRTK Prizren, 2023)

Në fshatin Gjonaj, Kulla e familjes Cikaj ruan një pasuri të veçantë gdhendjesh në gur, me motive spirale rreth hyrjes, simbolin e gjarprit mbi portë dhe figura diellore pranë hapjeve. Këto hollësi i japin kullës një shprehje artistike që shkon përtej masivitetit të muraturës. E datuar rreth vitit 1850, kulla lidhet, sipas gojëdhënave, me Hasan Cikajn dhe mjeshtrit dibranë. Ajo ndodhet në rrugën "Batalioni i tretë", brenda një lagjeje ku ndërtesat e reja kanë ndryshuar gradualisht mjedisin tradicional.[177]

Ndërtesa ka planimetri katrore dhe zhvillohet në përdhesë e kat, me mure masive prej guri të lidhur me llaç gëlqeror. Veçoria kryesore është dyshekllëku këndor prej guri, i shtrirë në anën e majtë të ballinës, pa dalje nga rrafshi i murit. Përdhesa ndahej ndërmjet hapësirave familjare dhe ahurit, me hyrje të veçanta. Në kat organizoheshin tri dhoma, dyshekllëku dhe hapësira sanitare; dhoma jugore përmbante vatrën, ndërsa ajo lindore hamamxhikun.[178]

Nga brendësia ruhen oxhaqet, pjesë të tavaneve prej druri dhe një shtyllë guri në dyshekllëk, e formësuar në trajtë spirale dhe e përfunduar me kapitel guri. Dyert prej druri të gdhendur dhe zbukurimet e fasadave dëshmojnë ndërthurjen e mjeshtërisë së gurit me atë të drurit. Motivet e gjarprit dhe diellit interpretohen në dokumentimin e kullës në lidhje me besimet popullore për mbrojtjen e familjes, jetën dhe mirëqenien.[179]

Braktisja, mungesa e mirëmbajtjes dhe ndërhyrjet e mëvonshme kanë cenuar ndërtesën. Në dokumentimin e vitit 2024, ajo paraqitet e pabanuar dhe e pashfrytëzueshme, me depërtim uji nga kulmi, dobësim strukturor dhe humbje të pjesëve të brendshme. Tri ndërtesa të reja në oborr kanë ndryshuar gjithashtu kontekstin e saj. Ruajtja e kullës ka rëndësi veçanërisht për dyshekllëkun këndor, gdhendjet simbolike dhe elementet origjinale të mbetura, të cilat dëshmojnë larminë tipologjike dhe artistike të arkitekturës tradicionale të Hasit.[180]



Figura 93 Konstruksioni mes-katësh pothuajse i shkatërruar i Kullës së Familjes Cikaj, Gjonaj, Prizren (QRTK Prizren, 2023)

[177] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, Kulla e familjes Cikaj, Gjonaj, (02.09.2015)
[178] Po aty
[179] Po aty
[180] Po aty

Shtëpia e gurit e familjes Hoxhaj, Zhur, Prizren



Figura 94 Pamje Verilindore e kullës së familjes Hoxhaj (Burimi : QRTK- Prizren)

Shtëpia e gurit e familjes Hoxhaj, e njohur edhe si Kulla e Reshat Hoxhajt, gjendet në qendër të fshatit Zhur, pranë rrugës "Komandant Petriti". Datohet në shekullin XIX, megjithëse teknika dhe stili i ndërtimit sugjerojnë një prejardhje të mundshme nga shekujt XVIII-XIX. Sipas kujtesës familjare, shtëpia është trashëguar përgjatë tetë brezave.[181]

Ndërtesa ka planimetri drejtkëndëshe dhe zhvillohet në përdhesë e kat. Muret masive janë punuar me gurë të parregullt, të lidhur me llaç balte, ndërsa qoshet me gurë të gdhendur drejtkëndorë. Gjatë viteve 1980, hyrja lindore u mbyll dhe në anën veriore u shtua një aneks me shkallë betoni. Në këtë periudhë, mbulesa e kulmit me rrasa guri u zëvendësua me tjegulla të rrafshta argjile.[182]


Përshtatjet për nevojat e banorëve ndryshuan shumë prej dhomave, ndërsa oda ruajti një brendësi të pasur me punime tradicionale. Tavani prej druri dallohet për motivet florale, me lule dhe gjethe të stilizuara.[183] Në dhomën verilindore veçohen tavani në stilin *shishe*, rozeta shumëkëndore në qendër, zbukurimet trekëndore në kënde dhe kapakët e gdhendur të dollapëve. Oxhaku me bazë rrethore e motive florale, qymlekllëku dhe hamamgjiku plotësojnë organizimin e saj. Këto elemente e dallojnë shtëpinë për ndërthurjen e ndërtimit rural prej guri me përpunimin dekorativ të brendësive të shtëpive qytetare.[184]

Gjatë viteve 80-ta, pronari ndërmori rindërtimin e kulmit dhe shtimin e aneksit verior me shkallë betoni, duke zhvendosur hyrjen nga lindja në veri. Mbulesa me rrasa guri u zëvendësua me tjegulla të rrafshta argjile. Pavarësisht përshtatjeve, elementet tradicionale të brendësisë dëshmojnë një përpunim artistik të pasur, të afërt me atë të shtëpive qytetare.[185]



Figura 95 Parahyjra në dhomën kryesore - hamamgjiku dhe qymlekllëku (burmi: QRTK- Prizren)

[181] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, "Shtëpi guri e familjes Hoxhaj", 15.08.2018
[182] Po aty
[183] EC Ma Ndryshe, *Bukur dhe Gjelbër*, nëntor 2018, zëri "Reshat Hoxhaj's Kulla, Zhur, Prizren"
[184] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, "Shtëpi guri e familjes Hoxhaj", 15.08.2018
[185] Po aty



5.2 Rahoveci

Kulla e Ismet Çemegës, Rahovev



Figura 96 Kulla e Ismet Çemegës para restaurimit 2013 (Burimi: DDTK)

Në sheshin Vrella, në qendrën e vjetër të Rahovecit, Kulla e Ismet Çmegës ruan lidhjen ndërmjet kullës tradicionale dhe hapësirës publike. E ndërtuar gjatë shekullit XIX nga Dervish Meriqi dhe më vonë e kaluar në pronësi të familjes Çmega, ajo e përfaqëson një nga shembujt e mbetur të banimit në kullë në këtë qytet. Pozita pa mure rrethuese që e shkëpusin nga rruga, e bën pjesë të drejtpërdrejtë të jetës dhe pamjes së sheshit.[186]

Me përmasa rreth 6,3 × 4,3 metra, ndërtesa ka planimetri drejtkëndëshe dhe zhvillohet në përdhesë e dy kate. Organizimi i brendshëm është i përmbledhur, përdhesa dhe kati i parë përmbajnë nga një hapësirë kryesore, ndërsa shkallët veçohen me mur ndarës. Në katin e sipërm, dyshekllëku prej guri shtrihet përgjatë gjithë fasadës jugore dhe vazhdon pjesërisht në atë perëndimore. Ky element e lidh kullën me traditën tipologjike të kullave të Rrafshit të Dukagjinit.[187]

Themelet dhe muret e përdhesës janë ndërtuar me gurë vendorë, pjesërisht të gdhendur, dhe gurë lumi, të lidhur me llaç gëlqeror. Muratura arrin trashësinë rreth 60 centimetra. Druri është përdorur për trarët ndërkatësh, dyshemetë me dërrasa, shkallët, dyert dhe dritaret. Kulmi katërujor, me konstruksion druri dhe mbulesë prej rrasash guri, pasqyron një zgjidhje karakteristike të ndërtimeve tradicionale të rajonit të Rahovecit. Druri është përdorur për trarët meskatësh, dyshemetë me dërrasa, shkallët, dyert dhe dritaret. Kulmi katërujor, me konstruksion druri dhe mbulesë prej rrasash guri, pasqyron një zgjidhje karakteristike të ndërtimeve tradicionale të rajonit të Rahovecit.[188]



Figura 97 Kulla e Ismet Çemegës pas restaurimit 2015 (Burimi: DDTK)

Mungesa e mirëmbajtjes solli dëmtime të rënda në muraturë, kulm dhe konstruksionet ndërkatëshe, si dhe humbjen e elementeve dekorative.

[186] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, "Kulla e Ismet Çmegës", 23.07.2015.


[187] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, "Kulla e Ismet Çmegës", 23.07.2015.; Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, "Kulla e Ismet Çmegës"

[188] Po aty

Restaurimi i pjesshëm i vitit 2014, i realizuar nga MKRS-ja dhe CHwB-ja, përforcoi strukturën dhe rehabilitoi kulmin, konstruksionin ndërkatësh dhe shkallët e brendshme. Megjithatë, pas ndërhyrjes kulla mbeti e pabanuar.[189]

Vlera e saj shtrihet edhe në marrëdhënien me mjedisin përreth. Së bashku me shtëpitë tradicionale, fragmentet e mureve të vjetra dhe kroin Vrella, të furnizuar nga burimi i Krajishtës përmes rrjedhjes me gravitet, kulla tregon organizimin e një lagjeje historike të Rahovecit. Ruajtja e kësaj tërësie përcjell mënyrën se si banimi, rruga dhe furnizimi publik me ujë ndërthureshin në strukturën urbane të shekullit XIX.[190]

[189] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, "Kulla e Ismet Çmegës", 23.07.2015.
[190] Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, "Kulla e Ismet Çmegës"



Kulla e Hajrulla Qantës, Rahovec



Figura 98 Kulla e Hajrulla Qantës, (Burimi: QRTK- Prizren, Mars 2025)

Në sheshin Republika në Rahovec, kulla-shtëpi e Hajrullah Çantës shfaq dy mënyra të ndryshme të marrëdhënies me mjedisin, fasada të thjeshta drejt rrugës dhe një ballinë të punuar me kujdes drejt oborrit. E datuar përafërsisht në fund të shekullit XVIII, ndërtesa ka kaluar nëpër ndryshime të shumta fizike dhe funksionale. Fillimisht shërbeu për banim dhe vrojtim, ndërsa gjatë shekullit XIX deri më 1908 u përdor si bazë ushtarake osmane. Më pas u rikthye sërish në funksionin e banim-it.[191]

Ndërtesa ka planimetri katërkëndëshe të parregullt dhe zhvillohet në përdhesë të lartë e kat. Fasadat veriore dhe lindore kufizohen me rrugën, ndërsa fasada jugore hapet drejt oborrit të brendshëm. Në këtë ballinë, pjesa qendrore del përtej rrafshit të murit, duke krijuar thellësi dhe dritëhije. Porta dhe dritaret e përdhesës përfundojnë me harqe gjysmërrethore, të formuara nga gurë të gdhendur me ngjyra të bardha, blu dhe të verdha, që e bëjnë hyrjen elementin kryesor të kompozimit.[192]

Muratura e përdhesës është punuar me gurë drejtkëndësh të gdhendur, të renditur në breza horizontalë, ndërsa kati është ndërtuar kryesisht me tulla argjile të lidhura me llaç gëlqeror. Prania e muraturës së gurit edhe në një pjesë të katit, në fasadën veriore, sugjeron mundësinë e një ndërtimi fillestar tërësisht prej guri dhe të një rindërtimi të mëvonshëm të katit. Kulmi katërujor, fillimisht i mbuluar me rrasa guri, u zëvendësua me mbulesë me tjegulla argjile nga mesi i shekullit XX.[193]

Brendësia dallohet për punimet e drugdhendjes, dyert me motive gjeometrike, tavanet e tipit "shishe tavan" dhe dyert e dollapëve të integruar në mur. Hambari i vendosur në parapetin e dritareve dhe dritaret dyshe me korniza druri e grila metalike nga brenda plotësojnë dëshminë e organizimit



Figura 99 Kulla e Hajrulla Qantës, porta kryesore (Burimi: QRTK- Prizren, Mars 2025)

[191] Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, "Kulla-shtëpi e Hajrullah Çantës"

[192] Po aty

[193] Po aty

tradicional të kullës. Ndërtimet e shtuara në oborr kanë kufizuar dukshmërinë e kullës-shtëpi dhe marrëdhënien e saj me hapësirën përreth. Ruajtja e ballinës së punuar në gur dhe e elementeve të brendshme prej druri ka rëndësi për të përcjellë mjeshtërinë ndërtimore dhe fazat e ndryshme të jetës së kësaj kulle.[194]



Figura 100 Pamja e kullës kah rruga kryesore (Burimi: QRTK-Prizren, Mars 2025)

[194] Po aty

Kulla e Mahmud Pashës, Opterushë



Figura 101 Kulla e Mahmud Pashës, pamja Jug-lindore (burimi: DTKK)

Kulla e Mahmud Pashës e vendosur në fshatin Opterushë të Rahovecit, mbart historinë e një ndërtese që ndërthuri banimin dhe mbrojtjen me administrimin e jetës së fshatrave përreth. Ndërtimi i saj mendohet t'i përkasë shekullit XIX dhe i atribuohet Mahmud Pashë Rrotullit. Emërtimi i ruajtur në popull e lidh kullën me këtë figurë, megjithëse koha e saktë dhe rrethanat e ndërtimit mbeten të pasqaruara.[195]

Kulla ka planimetri katrore, me brinjë rreth gjashtë metra, dhe zhvillohet në përdhesë e dy kate. Ndarja e funksioneve sipas niveleve pasqyron ndërthurjen e mikpritjes me nevojat ekonomike dhe mbrojtëse, përdhesa shërbente si ahur për bagëtitë e mysafirëve, kati i parë për akomodim dhe takime, ndërsa kati i sipërm për vrojtimin e rrethinës. Supozohet se fillimisht ndërtesa kishte edhe një qoshk, i cili humbi gjatë transformimeve të mëvonshme.[196]

Kulla ka planimetri katrore, me brinjë rreth gjashtë metra, dhe përbëhet nga përdhesa dhe dy kate. Përdhesa shërbente si ahur për bagëtitë e mysafirëve, kati i parë për akomodim dhe takime, ndërsa kati i sipërm për vrojtimin e rrethinës. Mendohet se fillimisht kulla kishte edhe një qoshk, i cili u humb gjatë ndërhyrjeve të mëvonshme.[197]

Gjatë shekullit XIX, kulla shërbeu si ndërtesë administrative për disa fshatra përreth. Në periudhën jugosllave u përdor për veprimtari politike, ndërsa më vonë u përshtat si mulli. Lufta e vitit 1999 shkaktoi dëme të rënda, duke rrënuar kulmin, konstruksionin ndërkatësh dhe pjesën më të madhe të mureve. Restaurimi i vitit 2014 konsolidoi strukturën e mbetur. Ndryshimet ndër vite dëshmojnë përshtatjen e kullës ndaj funksioneve të ndryshme familjare, publike dhe ekonomike[198] Ruajtja e kullës shihet si mundësi për t'i dhënë asaj një funksion të ri në jetën e fshatit. Komuniteti ka propozuar shfrytëzimin e saj për aktivitete të përbashkëta dhe si bujtinë, duke nxitur turizmin kulturor në Opterushë..



Figura 102 Kulla e Mahmud Pashës, (burimi: DTKK)

[195] Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, "Kulla e Mahmud Pashës"
[196] Po aty
[197] Po aty
[198] Po aty

Kulla-shtëpi e Qamil Vuçitërnës, Rahovec



Figura 103 Fasada veriore e kullës (burimi: QRKT – Prizren)

Kulla-shtëpi e Qamil Vuçitërnës pasqyron përshtatjen e shtëpisë tradicionale me relievin dhe dendësinë e qendrës së vjetër të Rahovecit. Mendohet të jetë ndërtuar nga fundi i shekullit XIX dhe ka shërbyer për banim. Ndërsa faqja perëndimore orientohet drejt sheshit, hyrja kryesore hapet nga oborri verior, përmes një porte me hark gjysmërrethor prej guri të gdhendur.[199]

Ndërtesa ka planimetri katërkëndëshe të parregullt dhe zhvillohet në përdhesë e kat. Përdhesa bashkonte funksionet ekonomike me përgatitjen dhe ruajtjen e ushqimit. Nga korridori qendror arrihej në kuzhinën me oxhak dhe në dy hapësira të tjera, të cilat mendohet të kenë shërbyer si ahur dhe si depo ushqimore, e njohur si *fllanik*. Shkallët njëkrahëshe prej druri çonin në katin e banimit, ku organizoheshin katër dhoma dhe një nyje sanitare.[200]

Muret e përdhesës janë punuar me gurë drejtkëndësh të gdhendur, të lidhur me llaç gëlqeror dhe të përforcuar me breza horizontalë druri. Trarët ndërkatësh, dyshemetë e katit, shkallët, dyert dhe dritaret dëshmojnë përdorimin e gjerë të drurit. Në brendësi veçohen punimet e tipit "shishe tavan", sidomos tavani i dhomës veriperëndimore me rozetë druri. Portali harkor dhe muratura e përpunuar e përdhesës plotësojnë karakterin arkitektonik të ndërtesës.[201]

Përshtatjet e mëvonshme ndryshuan disa prej tipareve të sa,: kornizat prej guri të dritareve të ballinës u zëvendësuan me korniza druri, ndërsa mbulesa fillestare prej rrasash guri e kulmit katërujor u zëvendësua nga mesi i shekullit XX me pllaka të valëzuara. Ndërtimet e reja kufizuan gjithashtu hapësirën e oborrit. Deri më 2015, braktisja dhe mungesa e mirëmbajtjes kishin sjellë depërtim uji, çarje strukturore dhe dëmtime të kulmit e të elementeve të brendshme. Ruajtja e kullës-shtëpi lidhet me mbrojtjen e punimeve të gurit dhe drurit, por edhe me vazhdimësinë e peizazhit historik përreth sheshit Vrella.[202]



Figura 104 Mutfaku në përdhesë (burimi: QRTK- Prizren)

[199] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, "Kulla-Shtëpi e Qamil Vuçitërnës", 27.10.2015.
[200] Po aty
[201] Po aty
[202] Po aty

5.3 Suhareka dhe Malisheva

Kulla e Jonuz Hasan Tafollit , Çadrak, Suharekë



Figura 105 Kulla e Jonuz Hasan Tafollit, Fasada Jug-perëndimore (Burimi: DDTK)

Çardaku prej druri, i shtrirë përgjatë ballinës juglindore, është elementi dallues i Kullës së Jonuz Hasan Tafollit në lagjen Tafolli të fshatit Çadrak. E ndërtuar në shekullin XIX, kulla shërbeu për banim dhe ruajtjen e bagëtisë. Vendosja në terren të pjerrët mundësoi organizimin në dy nivele, suteren dhe kat, me hyrje të veçanta nga oborri.[203] Sipas banorëve të fshatit, ajo u përdor edhe si odë deri në fund të viteve 1990, kur shpërngulja e familjes Tafolli solli braktisjen e ndërtesës.

Sutereni përmbante ahurin, ndërsa kati i sipërm bashkonte korridorin, çardakun dhe odën. Qasja në të dy nivelet bëhej nga ana perëndimore: drejtpërdrejt nga oborri për ahurin dhe nëpërmjet shkallëve të jashtme prej guri për hapësirën e banimit. Oda kishte oxhak dhe një kamare në mur. Çardaku dilte rreth 50 centimetra përtej rrafshit të fasadës, mbështetej në muret konstruktive dhe pesë shtylla druri, ndërsa rrethohej me dërrasa. Kjo dalje i jepte thellësi ballinës dhe lidhte hapësirën e brendshme me pamjen drejt oborrit.[204]

Themelet dhe muret janë ndërtuar me gurë të lidhur me llaç balte, ndërsa hatullat prej druri, të vendosura horizontalisht çdo rreth një metër, përforcojnë muraturën. Dyert dhe dritaret janë prej druri, kurse kulmi me streha të gjera dhe mbulesë prej rrasash guri plotëson karakterin tradicional të ndërtesës.[205]

Braktisja dhe mungesa e mirëmbajtjes e lanë kullën të ekspozuar ndaj depërtimit të ujit dhe degradimit. Dëmtimit të murit pranë shkallëve hyrëse nga një granatë gjatë luftës së fundit iu shtuan dëmtime të murit të oxhakut, dyshemesë dhe kulmit. Në vitin 2022, kulla iu nënshtrua ndërhyrjeve restauruese dhe konservuese nga QRTK-ja në Prizren, në kuadër të programit të investimeve të MKRS-së.[206] Këto ndërhyrje synuan ruajtjen e një kulle që, përveç teknikave tradicionale të gurit dhe drurit, mbart edhe kujtesën e odës dhe të jetës shoqërore të fshatit



Figura 106 Kulla e Jonuz Hasan Tafollit, Fasada verilindore (Burimi: DDTK)

[203] Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, "Kulla e Jonuz Hasan Tafollit"
[204] Po aty
[205] Po aty
[206] Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, njoftim mbi ndërhyrjet restauruese-konservuese në Kullën e Jonuz Tafollit në Çadrak,

Kulla e Ramë Bllacës, Bllacë, Suharekë

Në qendër të fshatit Bllacë, shtëpia e ndërtuar më 1936 me nismën e Ramë Fejzullah Bllacës ndërthur historinë familjare me atë të arsimit dhe të kundërshtimit të shpërnguljes së shqiptarëve. Punimet e gurit u realizuan nga mjeshtrit Tafë dhe Hamit Myftari, ndërsa drugdhendjet nga Shyqë Motorri i Prizrenit. Krahas banimit, ndërtesa shërbeu për një periudhë edhe si shkollë fillore. [207] Sipas dëshmisë së Afrim Bllacës, nipit të Ramë Bllacës, familja e vuri shtëpinë në dispozicion të shkollës gjatë viteve 1950, për më shumë se pesë vjet.[208]

Ndërtesa ka planimetri drejtkëndëshe dhe zhvillohet në bodrum, përdhesë e kat. Organizimi mbështetet në hollin qendror dhe dhomat në të dy anët e tij. Përdhesa përmban dy dhoma dhe shkallët për në kat, ndërsa sipër gjenden çardaku, dy dhoma dhe ballkoni. Muret janë ndërtuar me gurë të lidhur me llaç balte dhe të përforcuar me hatulla druri. Konstruksioni ndërkatësh dhe kulmi katërujor janë prej druri, me mbulesë tjegullash argjile.[209]

Brendësia dallohet për dyert me motive gjeometrike, parmakët e shkallëve me forma ovale dhe dollapët e integruar në mure. Oxhaku në përdhesë dhe hamamxhiku në njërën prej dhomave të katit dëshmojnë mënyrën tradicionale të organizimit të jetës familjare. Fasada ishte zbukuruar me reliev rreth ballkonit dhe dritareve. Shtëpia ishte pjesë e një kompleksi më të gjerë familjar, me oborr të rrethuar me mure guri, pus dhe ndërtesa ndihmëse për nevojat e ekonomisë shtëpiake.[210]



Figura 107 Kulla e Ramë Bllacës, Fasada lindore (burimi: QRTK- Prizren)

[207] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, "Shtëpia e Ibrahim Ramë Bllacës", (02.12.2015)
[208] TËVË 1, "Kulla e Ramë Bllaca ka qenë qendër bashkimi për ideal kombëtar", maj 2026
[209] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, "Shtëpia e Ibrahim Ramë Bllacës", (02.12.2015).
[210] Po aty

Kulla e Shaqir Hazrollit, Banjë, Malishevë



Figura 108 Pamja ballore e kullës së Shaqir Hazrollit

Kulla e Shaqir Hazrollit është ndërtesa e vetme e mbetur nga kompleksi i dikurshëm i banimit të familjes. Oda e miqve, hambari dhe objektet ndihmëse u rrënuan pas ndarjes së pronave dhe ndërtimit të shtëpive të reja. Kulla mbeti në fund të parcelës, pas ndërtesave të mëvonshme. Mbi harkun e portës hyrëse janë skalitur dy shënime datimi, "1314 hixhri" dhe "1899", të cilat kërkojne sqarim për marrëdhënien ndërmjet tyre. [211]

Ndërtesa ka planimetri afërsisht katrore, me përmasa rreth 10 × 9 metra, dhe zhvillohet në përdhesë e kat. Muret janë ndërtuar me gurë vendorë të latuar, ndërsa çatia ka konstruksion druri dhe mbulesë prej rrasash guri. Hyrja lindore theksohet nga porta harkore dhe një dritare me të njëjtën formë në të majtë të saj. Sipër hyrjes, dyshekllëku shtrihet përgjatë ballinës, me një dalje të lehtë përtej muraturës dhe një varg prej dymbëdhjetë dritaresh harkore. Frëngjitë e shumta në të gjitha anët dëshmojnë karakterin mbrojtës të ndërtesës.[212]

Përdhesa përbëhet nga një hapësirë e vetme, me shkallët prej druri në të djathtë të hyrjes. Në kat organizohen holi me dyshekllëkun, një odë me oxhak dhe një korridor i ngushtë drejt nyjeve sanitare. Në hol veçohet edhe një sofa e ngritur rreth 60 centimetra mbi dysheme. Hapjet harkore, frëngjitë dhe dallimet në nivelin e dyshemesë e bëjnë organizimin e brendshëm pjesë të rëndësishme të karakterit të kullës. Brendësinë e pasuron tavani prej druri të gdhendur me motive florale dhe zbukurime të tjera, të cilat lidhen me kohën e ndërtimit.[213]



Figura 109 Pamje të përpunimit të murit dhe hapjeve të Kullës së Shaqir Hazrollit

[211] Dokumentar i shkurtër për kullën e Shaqir Hazrollit- "Kulla e lagjes Hazrollaj- Banje"

[212] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren"Kulla e Shaqir Hazrollit"

[213] EC Ma Ndryshe: Bukur dhe Gjelber, Nëntor, 2018

6. Kullat e rrënuara

Një numër i madh kullash në Kosovë janë shkatërruar gjatë luftës së viteve 1998-1999, ndërsa humbja e tyre ka vazhduar edhe më pas, për shkak të braktisjes, mungesës së mirëmbajtjes dhe rrënimeve. Përmasat e këtij shkatërrimi shtrihen përtej rajoneve të Gjakovës dhe Prizrenit, duke përfshirë edhe rajonin e Pejës, veçanërisht Deçanin. Sipas të dhënave të përcjella nga Radio Evropa e Lirë më 2017, përpara luftës në Kosovë llogariteshin rreth 700 kulla. Vetëm në Komunën e Deçanit, nga 263 kulla që ekzistonin deri më 1999, rreth 70 ishin shkatërruar tërësisht, ndërsa vetëm katër kishin shpëtuar me dëmtime të vogla, të tjerat kishin pësuar dëmtime të mëdha ose të pjesshme. [214] Humbja e këtyre objekteve nënkupton zhdukjen e dëshmive të mjeshtërisë ndërtimore, organizimit familjar dhe traditave të mikpritjes shqiptare. Mbrojtja dhe restaurimi në kohë do të kishin mundësuar ruajtjen e shumë prej tyre, ndërsa për kullat e rrënuara, çdo mundësi rindërtimi duhet të mbështetet në dokumentacion të besueshëm dhe në ruajtjen e materialit origjinal të mbetur. Shembujt e paraqitur më poshtë përbëjnë vetëm një pjesë të kullave të humbura në zonën e këtij hulumtimi dhe synojnë të ruajnë njohuritë për karakteristikat dhe rëndësinë e tyre, pa e zvogëluar vlerën e kullave të tjera të papërfshira.

Kulla e Musë Rexhepajt, Hereq (e rrënuar në vitin 2025)



Figura 110 Pamja ballore e kullës së Musë Rexhepajt (Burimi: QRTK- Gjakovë)

Kulla e Musë Rexhepajt ndodhej në qendër të fshatit Hereq, e cila u ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Ajo shërbente për banim dhe mbrojtje në rast nevoje. Me planimetri drejtkëndore, përdhesë dhe kat, përfaqësonte një variant të thjeshtë të kullës, pa dyshekllëk dhe me përpunim të përmbajtur të brendësisë.[215]

Themelet dhe muret ishin ndërtuar me gurë të përmasave të ndryshme, ndërsa qoshet theksoheshin nga gurë të latuar me nuanca të hirta. Muret e jashtme arrinin trashësi deri në 50 centimetra; ndarjet e brendshme ishin më të holla, të realizuara me dërrasa dhe përforcime vertikale druri. Trarët ndërkatësh dhe konstruksioni i kulmit ishin prej druri të bungut, ndërsa mbulesa përbëhej nga tjegulla të rrafshëta. Një hollësi karakteristike ishte streha prej pllakash guri të latuar, të vendosura në dy radhë të dala. Hyrja nga oborri çonte në përdhesë, e cila në përdorimin e mëvonshëm shërbente për ruajtjen e ushqimeve dhe druve, si dhe pjesërisht si kuzhinë verore. Shkallët e brendshme prej

[214] Radio Evropa e Lirë, "Kullat, shënjestra të luftës që mbijetuan", 4 maj 2017. Të dhënat për Deçanin përcillen në artikull nga arkitekti Shkëlzen Shehu, zyrtar në Drejtorinë për Urbanizëm të Komunës së Deçanit.

[215] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, *"Kulla e Musë Rexhepaj", Hereq Gjakovë*, 2002-2024.

druri lidhnin këtë nivel me katin, ku gjendeshin dhomat e qëndrimit dhe të fjetjes, bashkë me odën e burrave. Tavani i odës kishte dekorim të thjeshtë prej druri, duke i dhënë hapësirës së pritjes një trajtim të veçantë brenda ndërtesës.[216]

Kulla, tashmë e rrënuar, kishte rëndësi si dëshmi e banimit tradicional rural dhe e ndërthurjes së jetës familjare, ekonomisë shtëpiake dhe mikpritjes. Mungesa e dyshekllëkut, organizimi në dy nivele dhe përdorimi i gurit e drurit të bungut pasqyronin larminë e zgjidhjeve ndërtimore të kullave të rajonit. Dokumentimi i saj ruan njohuri për një ndërtesë, vlera e së cilës qëndronte te organizimi funksional dhe mjeshtëria tradicionale e ndërtimit.[217]



Figura 111 Dëmtimet kyçe të kullës së Musë Rexhepajt (Burimi: QRTK- Gjakovë)

[216] Po aty

[217] Po aty

Kulla e Ismail Hodaj Pogaj, Krajk, Prizren (e rrënuar në vitin 2012)



Figura 112 Fasada ballore me çardak, më 2002 (QRTK- Prizren)

Kulla e Ismail Hodaj Pogaj e ndërtuar në fshatin Krajk të Hasit, kishte tiparin dallues çardakun prej druri të bungut, i shtrirë përgjatë gjithë ballinës. Kjo kullë ishte ndërtuar në shekullin XIX, në terrenin e pjerrët të lagjes Samahodaj, ajo bashkonte muraturën masive prej guri me punimet e drurit të hapësirës së banimit.[218]

Ndërtesa kishte planimetri drejtkëndëshe dhe zhvillohej në suteren e kat. Sutereni shërbente si ahur dhe kishte dy hyrje prej druri nga oborri, në anën juglindore. Në kat gjendeshin çardaku dhe tri oda me përmasa të njëjta, secila me oxhak dhe dy kamare. Tri palë shkallë prej druri mundësonin qasjen në pjesët e banimit të tri familjeve. Çardaku dilte rreth 60 centimetra përtej fasadës, mbështetej në muret konstruktive dhe shtatë shtylla druri, ndërsa rrethohej me dërrasa.[219]

Themelet dhe muret mbajtëse ishin prej guri vendor, të lidhur me llaç balte dhe të përforcuar horizontalisht me hatulla druri. Ndarjet e brendshme ndërthurnin skeletin prej druri me mbushje qerpiçi dhe thupra të gërshetuara, të suvatuara me baltë e të lyera me gëlqere. Trarët ndërkatësh, tavanet dhe konstruksioni i kulmit ishin prej druri, ndërsa kulmi katërujor mbulohej me tjegulla tradicionale të luguara. Drugdhendja e çardakut dhe trarët dekorativë përbënin pjesë të rëndësishme të shprehjes arkitektonike të kullës.[220]

Para rrënimit, ndërtesa përdorej si depo dhe ahur. Mungesa e mirëmbajtjes dhe e ndërhyrjeve konservuese kishte sjellë degradim të rëndë, që, sipas pronarëve, paraqiste rrezik për familjarët. Humbja e saj zhduku një shembull të cilësuar nga QRTK-ja si të rrallë për çardakun prej druri në tërë ballinën. Rilevimi i vitit 2004 dhe dokumentacioni arkivor mbeten dëshmi për studimin e kësaj tipologjie dhe të organizimit të banimit të përbashkët familjar.[221]




Figura 114 Gjendja e kullës në vitin 2012 (QRTK- Prizren)



Figura 113 Kulla sot e rrënuar tërësisht (QRTK- Prizren)

[218] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren, Kulla e Ismail Hodaj Pogaj, Krajk (02.09.2015)
[219] Po aty
[220] Po aty
[221] Po aty



Kulla e Ahmet Asllanit, Devë



Figura 115 Pamje e kullës në gjendjen e saj të shkatërruar (burimi: QRTK- Gjakovë)

Mbi një kodër të lagjes Asllanaj në fshatin Devë, mbetjet e kullës së rindërtuar nga Ahmet Asllani ruajnë gjurmët e një ndërtese me rëndësi për historinë dhe jetën shoqërore të zonës. Historia e saj përfshin dy djegie, pas të cilave Ahmet Asllani e ngriti përsëri gjatë shekullit XIX. Me kullën lidhen rrëfime për strehimin e Bajram Currit, Azem Bejtës dhe Qorr Iljazit, që e vendosin atë në kujtesën e qëndresës së armatosur të krahinës.[222]

Ndërtesa kishte planimetri drejtkëndëshe me përmasa të mëdha dhe zhvillohej në përdhesë e kat. Muret ishin prej guri, ndërsa konstruksioni i kulmit prej druri. Pozita në kodër dhe hapësira e lirë përreth e bënin kullën të dallueshme në peizazhin e fshatit; në anën jugore, rreth njëzet metra larg, familjarët ndërtuan më vonë një shtëpi të re.[223]

Nga vëllimi i dikurshëm kanë mbetur vetëm dy pjesë muresh, me çarje të thella dhe deformime të mëdha. Kulmi është rrëzuar, dyert dhe dritaret mungojnë, ndërsa lagështia dhe bimësia kanë prekur muraturën e mbetur. Kjo gjendje e ka bërë kullën të pashfrytëzueshme dhe e rrezikon me humbjen e mëtejshme të gjurmëve të saj materiale.[224]

Rëndësia e ruajtjes qëndron te lidhja e këtyre rrënojave me historinë e Devës, traditën ndërtimore dhe kujtesën e komunitetit. Dokumentimi dhe stabilizimi i mureve të mbetura do të ndihmonin që vendi të ruajë dëshmitë e tij, edhe pse ndërtesa ka humbur pjesën më të madhe të formës së dikurshme.



Figura 116 Pamje e kullës në gjendjen e saj të shkatërruar (burimi: QRTK- Gjakovë)

[222] Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë, material përshkrues dhe vlerësim i gjendjes së kullës në lagjen Asllanaj, Devë 2002-2024

[223] Po aty

[224] Po aty

6.3.7 Kulla e Lush Uk Isufajt, Junik

Në lagjen e Berishajve të Junikut, Kulla e Lush Uk Isufajt ishte pjesë e traditës së banimit familjar të fortifikuar. Drançolli e daton në shekullin XVIII dhe e përshkruan si ndërtesë trekatëshe, ku masa prej guri plotësohej nga galeria prej druri e katit të sipërm. Dokumentimi pas djegies ruan kujtesën e një objekti të cilit i kishin mbetur vetëm rrënojat e mureve konstruktive.[225]

Dyshekllëku prej druri shtrihej në fasadën ballore dhe vazhdonte në një pjesë të divanhanes anësore. Në katin më të lartë, oda e burrave dhe divanhanja shoqëroheshin me nyjën sanitare, e cila dilte jashtë në nivelin e dyshemesë. Kjo vendosje bashkonte hapësirën përfaqësuese të pritjes me qarkullimin dhe shërbimet e saj. Çatia katërujore ishte e mbuluar me qeramidhe tradicionale, ndërsa oxhaqet dhe baxha e kulmit ndërprisnin sipërfaqet e pjerrëta dhe plotësonin siluetën e kullës. [226] Autori ia atribuon ndërtimin ustallarëve dibranë dhe dekorimet mjeshtërve vendorë. Guri, druri dhe llaçi gëlqeror përbënin materialet kryesore, ndërsa teknika cilësohet rustike. Në këtë ndërthurje lexohet bashkëpunimi ndërmjet mjeshtërisë së ndërtimit dhe punës së enterierit, pa pasur në faqen e dorëzuar emra individualë të mjeshtërve.[227]


Sipas Drançollit, kulla ishte në gjendje të mirë para vitit 1998 dhe u dogj në prill 1999 nga forcat paramilitare, policore dhe ushtarake serbe-malaziase. Përshkrimi i mbetjeve dokumenton pasojën e luftës në kohën e regjistrimit. Humbja e galerisë dhe e hapësirave të brendshme nënkuptonte edhe humbjen e elementeve që e dallonin këtë variant të kullës.[228]

Kulla e Pepshve, Junik

Kulla e Pepshve lidhet me mënyrën se si banimi familjar formësonte lagjet e Junikut. Kulla ishte e vendosur në mëhallën e Pepshve, pranë kullave të tjera të së njëjtës familje, dhe daton në shekullin XIX. Objekti trekatësh përfaqësonte një kullë të fortifikuar, pjesë e një grupimi farefisnor dhe arkitektonik.[229]

Elementi dallues ishte dyshekllëku prej guri, i dalë nga muret perimetrale dhe i zhvilluar në kënd, në dy faqe të ndërtesës. Ky trajtim e theksonte nivelin e sipërm dhe e lidhte pamjen e kullës me variantet e tjera trekatëshe të Junikut. Çatia katërujore mbështetej mbi kurorën prej guri të kulmit. [230] Ndërtimi u atribuohet mjeshtërve dibranë, ndërsa punimi i tavaneve, rafteve dhe dollapëve shpjegohet në kontekstin e mjeshtërisë vendore të Junikut. Guri dhe druri, së bashku me llaçin gëlqeror, janë materialet kryesore që ishin përdorë në këtë kullë.[231] Gjendja e kullës para vitit 1998 ishte mjaft e mirë mirëpo pëson djegie nga forcat paramilitare, policore dhe ushtarake serbe-malaziase në pranverën e vitit 1999. [232]

225 Fejaz Drançolli, Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998/99), "Kulla e Lush Uk Isufajt, shek. XVIII"
226 Po aty
227 Po aty,
228 Po aty
229 Fejaz Drançolli, Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998/99 "Kulla e Pepshve, shek. XIX"
230Po aty,
231 Po aty
232 Po aty



Kulla e Arif Musës, Gjakovë



Figura 117 Pamje e kullës së Arif Musës para rrënimit (burimi: QRTK- Gjakovë)

Kulla e Hazir Sadikut, Nivokaz, Gjakovë



Figura 118Pamje e Kullës së rrënuar të Hazir Sadikut (Burimi: QRTK- Gjakovë)

Kulla e Haxhi Mustafës, Gjakovë



Figura 119 Pamje e kullës së Haxhi Mustafës (burimi: QRTK- Gjakovë)

9. Përfundime dhe rekomandime


Përfundime

Hulumtimi i kullave në rajonin e Gjakovës dhe Prizrenit nxjerr në pah një trashëgimi të larmishme, të formësuar nga kushtet e vendit, mundësitë e familjeve dhe mjeshtëria ndërtimore. Dallimet ndërmjet kullave qytetare dhe atyre rurale, si dhe ndërmjet ndërtesave me përpunim të pasur dhe varianteve më të thjeshta, e tregojnë aftësinë e kësaj arkitekture për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme. Rëndësia e tyre shtrihet edhe përtej lidhjes me figura apo ngjarje historike, çdo kullë ofron njohuri për mënyrën e banimit dhe marrëdhëniet që organizonin jetën e komunitetit.

Rastet e trajtuara tregojnë se vazhdimësia e kullave varet nga marrëdhënia ndërmjet ruajtjes dhe përdorimit. Përshtatja për banim, muze, veprimtari kulturore apo mikpritje mund të ndihmojë në mirëmbajtjen e tyre, por kërkon respektimin e organizimit hapësinor, materialeve dhe elementeve të trashëguara. Edhe një ndërtesë që mbetet në këmbë mund të humbasë një pjesë të rëndësishme të vlerës së saj kur ndryshohen brendësia, hapjet ose lidhja me oborrin dhe rrethinën.

Kullat e rrënuara dëshmojnë pasojat e humbjeve të pakthyeshme dhe kufijtë e dokumentimit si mjet ruajtjeje. Fotografitë, rilevimet dhe dëshmitë gojore mund të përcjellin njohuri për to, por nuk e zëvendësojnë ndërtesën dhe materialin e saj origjinal. Kjo e bën ndërhyrjen në kohë, mbështetjen e pronarëve dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme pjesë thelbësore të përgjegjësisë për kullat që kanë mbetur.

Ky hulumtim krijon një bazë për njohjen dhe krahasimin e një pjese të kësaj trashëgimie, e cila duhet të plotësohet me dokumentim të mëtejshëm dhe vlerësime në terren. E ardhmja e kullave kërkon bashkëpunim ndërmjet institucioneve, profesionistëve, pronarëve dhe komuniteteve, në mënyrë që ruajtja e tyre të lidhet me shfrytëzim të qëndrueshëm dhe me jetën e vendbanimeve ku ato bëjnë pjesë.



Rekomandime

Duke u mbështetur në rastet e trajtuara, rekomandohen këto drejtime veprimi për ruajtjen dhe përdorimin e kullave:

1. **Dokumentimi dhe vlerësimi i rregullt i gjendjes.** Të përditësohen të dhënat për kullat përmes rilevimeve, fotografive dhe vlerësimeve në terren, duke përfshirë edhe ndërtesat më pak të njohura. Dokumentimi duhet të evidentojë elementet origjinale, ndryshimet e mëvonshme dhe dëmtimet, për të orientuar ndërhyrjet sipas nevojave të secilit objekt.


2. **Ndërhyrjet me përparësi në kullat e rrezikuara.** Të identifikohen kullat që përballen me rrezik rrënimi dhe të sigurohen masa për stabilizimin e strukturës, mbrojtjen e kulmit dhe largimin e ujërave. Mirëmbajtja parandaluese duhet të shoqërojë restaurimin, me përgjegjësi dhe mjete të përcaktuara për kujdesin e mëtejshëm.

3. **Ruajtja e materialeve dhe e veçorive arkitektonike.** Projektet restauruese të mbështeten në dokumentim dhe analizë profesionale, duke i dhënë përparësi riparimit të pjesëve origjinale. Kujdes i veçantë t'u kushtohet odave, dyshekllëkëve, çardakëve, tavaneve, oxhaqeve dhe punimeve të gurit e drurit, si dhe marrëdhënies së kullës me oborrin dhe ndërtesat përcjellëse.

4. **Mbështetja e pronarëve.** Institucionet të ofrojnë këshillim teknik dhe mundësi bashkëfinancimi për mirëmbajtjen e kullave private. Përfshirja e pronarëve në vendimmarrje dhe sqarimi i ndërhyrjeve të përshtatshme mund të ndihmojnë në shmangien e ndryshimeve që cenojnë karakterin e kullës.

5. **Riadaptime të përshtatshme dhe të qëndrueshme.** Vazhdimi i banimit ose përshtatja kapacitetin dhe vlerat e secilës kullë. Çdo funksion i ri duhet të shoqërohet me një plan të realizueshëm menaxhimi dhe mirëmbajtjeje, të dakorduar me pronarët dhe institucionet përgjegjëse.

6. **Ruajtja e dëshmive për kullat e rrënuara.** Të mblidhen dhe të digjitalizohen fotografitë, vizatimet, dokumentet dhe rrëfimet e familjeve. Mbetjet me vlerë të dokumentohen e të mbrohen, ndërsa propozimet për rindërtim të shqyrtohen vetëm mbi bazën e dëshmive të mjaftueshme, duke dalluar qartë materialin e ruajtur nga pjesët e reja.



7. **Edukimi dhe përcjellja e mjeshtërive tradicionale.** Të nxitet bashkëpunimi me shkollat, universitetet dhe mjeshtrit për vizita mësimore, punëtori dhe praktikë në teknikat tradicionale të ndërtimit. Promovimi i kullave të përfshijë historinë e jetës së përditshme dhe punën e mjeshtërve, duke e bërë këtë trashëgimi më të kuptueshme për komunitetin dhe brezat e rinj.



Bibliografia dhe burimet

Libra dhe studime

- Backer, Berit. *Behind Stone Walls: Changing Household Organization among the Albanians of Kosova*. Redaktuar nga Robert Elsie dhe Antonia Young; hyrja dhe fotografitë nga Ann Christine Eek. Pejë: Dukagjini Balkan Books, 2003.
- Dauti, Daut. *Britain, the Albanian Question and the Demise of the Ottoman Empire 1876-1914*. Disertacion doktoral, University of Leeds, 2018
- . https://etheses.whiterose.ac.uk/id/eprint/20950/
- Doli, Flamur. *Vernacular Architecture of Kosova*. Prishtinë, 2022.
- Drançolli, Fejaz. *Kulla shqiptare*. Prishtinë, 2001.
- Drançolli, Fejaz. *Rrënimi i kullës shqiptare*. Prishtinë, 2004.
- Drançolli, Fejaz, *Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998/99*
- Jaeger-Klein, Caroline. "The Traditional Tower Houses of Kosovo and Albania-Origin, Development and Influences." *UBT International Conference*, 2018, punimi 27. https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/2018/all-events/27
- Jerliu, Florina, dhe Kaltrina Thaçi. "Building Typology of Albanian Kulla Stone Houses in the Balkans." *Built Heritage* 8, artikulli 5, 2024. https://doi.org/10.1186/s43238-024-00113-8
- Kadriu, Lumnije, dhe Tahir Latifi. "Kullat në Rrafshin e Dukagjinit - hambar kujtese dhe identiteti kulturor." *Gjurmime albanologjike: Folklor dhe etnologji* 51, 2021.
- Krasniqi, Artan. *Monument*. Vëllimi V. 2018.
- Krasniqi, Mark. *Mikpritja në traditën shqiptare*.
- Muharremi, Ilir, Albana Krasniqi dhe Jon Gashi. "Architectural, Artistic, and Interior Design Characteristics of Albanian Towers in the Dukagjini Plain: A Structural, Cultural, and Aesthetic Analysis." *Architecture Image Studies* 6, nr. 1, 2025.
- Rassam, Sahar. *Kulla: A Traditional Albanian House Type in Kosovo*.
- Thaçi, Kaltrina, dhe Florina Jerliu. "Assessing the Socio-Cultural Values of Kulla Stone House in the Cross-Border Region of Kosovo, Albania and Montenegro." *Architecture and Urban Planning*. https://doi.org/10.2478/aup-2023-0011

Dokumentacion institucional dhe arkivor

- Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren. *Formularë inventarizimi, përshkrime historike dhe arkitektonike, rilevime dhe dokumentacion fotografik për kullat dhe shtëpitë e gurit në rajonin e Prizrenit*. Arkivi i QRTK-së, dokumente të viteve të ndryshme.
- Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Gjakovë. *Formularë inventarizimi për kullat në Gjakovë, Junik dhe vendbanimet përreth*. Dokumentacioni 2002-2024 dhe formularët e përditësuar deri më 2025.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. *Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës*. Përshkrime dhe dokumentacion fotografik për asetet e trajtuara në hulumtim

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. *Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme 2025-2026*.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Njoftim për ndërhyrjet restauruese dhe konservuese në Kullën e Jonuz Hasan Tafollit, Çadrak, Suharekë, 2022.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. "Shpëtohet nga rrënimi kulla e Ymer Pogës në Rogovë, Gjakovë." Njoftim institucional.
- Ministria e Kulturës dhe Turizmit. Material fotografik për restaurimin e Kullës së Xheladin/Astrit Kryeziut, nëntor 2025.

Raporte, plane dhe publikime të organizatave

- EC Ma Ndryshe. *Bukur dhe gjelbër*. Nëntor 2018
- Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij - CHwB Kosova. *Gjendja e trashëgimisë kulturore në Kosovë 2021*.
- CHwB Kosova dhe EC Ma Ndryshe. *Trashëgimia në rrezik*.
- CHwB Kosova. Material për Kullën e Mahmud Pashës në Opterushë, gjendjen e saj dhe diskutimet për restaurim e ripërdorim. më 11 tetor 2012
- CHwB Kosova. Dokumentacion dhe materiale fotografike për restaurimin e Kullës së Hysen Hajdarit në Nivokaz.
- Kultus. *Kullë'Tech: Raporti për shtegun turistik të integruar Junik-Gjakovë-Rahovec*.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. "Shpëtohet nga rrënimi Kulla e Pjetër Prenkpalaj në Zym të Hasit, Prizren." 7 tetor 2026.

Burime mediatike dhe audiovizuale

- Radio Evropa e Lirë. "Kullat, shënjestra të luftës që mbijetuan." 4 maj 2017.
- TËVË 1. "'Kulla e Ramë Bllaca ka qenë qendër bashkimi për ideal kombëtar' - një ditë në familjen e Ramë Bllaca." Rubrika *Një ditë me mua*, maj 2026. Intervistë me Afrim Bllacën.
- Muzeu i Historisë Gjakovë. Informacion mbi Kullën e Abdullah Pashë Drenit dhe historikun e muzeut. https://www.facebook.com/100050441383737/posts/111506850603637/
- Muzeu i Historisë Gjakovë. Informacion për ekspozitat dhe përdorimin e hapësirave të muzeut. Faqja zyrtare në Facebook. https://www.facebook.com/p/Muzeu-i-Historis%C3%AB-Gjakov%C3%AB-100050441383737
- TV Syri Vision. "Kulla e Currit, një monument i gjallë i historisë kombëtare." Mars 2025.
- Klan Kosova. "Kulla 200 vjeçare në Zylfaj të Gjakovës kërkon dorën e shtetit." Prill 2021.
- TV Syri Vision. "Kulla e Ethem Godenit në fshatin Rogovë do të renovohet këtë vit nga MKRS." Janar 2022.
- Klan Kosova. "Kulla e Drane Bojaxhiu - gruaja që lindi Nënë Terezën, Novosellë e Epërme - Gjakovë." Reportazh, janar 2026.
- TV Syri Vision. "Kulla e Zeqë Ramë Sadrisë e vetmja në fshatin Brovinë." Reportazh, shkurt 2023.

Për EC:

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse. Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar. Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-it synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

Deklarata e vizionit

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

Deklarata e misionit

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.

EC
MA NDRYSHE

www.ecmandryshe.org

